



RAPORT

**PËR KONTROLLIN E USHTRUAR NË
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE
TË TRANSPORTIT RRUGOR**

Prill, 2010





±

Në zbatim të Programit të Kontrollit nr. 511/1, datë 02.11.2009, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u ushtua kontrolli në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, përfaqësuar nga z. Kreshnik Bozho, me detyrë drejtor, me objekt kontrolli "Për Vlerësimin e veprimtarisë Ekonomike dhe Financiare". Kontrolli u krye nga data 02.11.2009 deri në datën 18.12.2009, sipas drejtimeve të përcaktuara në këtë program e kontrolli, për periudhën e veprimtarisë së ushtuar nga subjekti i kontrolluar nga data 01.01.2008 deri në 31.09.2009, nga grupi i kontrollit i përbërë nga përfaqësuesit e autorizuar të KLSH-së, Andrea Kristo, Yllka Dede, Rasim Hoxha dhe Sadri Dushku. Kontrolli u krye duke verifikuar sipas rastit dokumentacionin e plotë dhe me zgjedhje. Përveç kontrollit të dokumentacionit jemi bazuar edhe në këshillimin dhe ballafaqimet me stafin drejtues e atë administrativ të subjektit të kontrollit.

Në përfundim të kontrollit me personat përkatës përgjegjës në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor u mbajtën akt-verifikime apo proces-verbale dhe pasi u shqyrtuan vërejtjet dhe shpjegimet e këtyre punonjësve, janë marrë në konsideratë ato që kishin argumentim e mbështetje ligjore, u përgatit dhe u paraqit Projektraporti i Kontrollit me shkresën nr.511/3, datë 21.01.2010. Për këtë Projektraport, subjekti i kontrollit më datën 23.02.2010, ka dërguar vërejtjet përkatëse, të cilat pasi u shqyrtuan nga grupi i kontrollit, janë bërë rregullimet e sqarimet përkatëse, dhe u përgatit ky Raport Përfundimtar Kontrolli.

Gjatë kontrollit të kryer për "Vlerësimin e veprimtarisë Ekonomike dhe Financiare", duke verifikuar sipas rastit dokumentacionin e plotë dhe me zgjedhje periudhash që ju vu në dispozicion grupit të kontrollit u konstatuan disa të meta dhe mangësi në respektimin e dispozitave ligjore në realizimin e të ardhurave dhe në procedurat e prokurimit publik, për të cilat me personat përkatës u mbajtën aktverifikime, apo procesverbale, kopjet e të cilave ju lanë në vend këtyre personave ose u dorëzuan nëpërmjet zyrës së protokollit të subjektit objekt kontrolli. Në përfundim, pasi u shqyrtuan vërejtjet dhe shpjegimet e punonjësve përgjegjës, janë marrë në konsideratë ato që kishin argumentim e mbështetje ligjore, ju paraqitet ky Raport Kontrolli.

1. Kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna në kontrollin e mëparshëm.

a. Programet e hartuara nga subjekti për zbatimin e detyrave të lëna.

Gjatë vitit 2008 dhe 2009, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, është kontrolluar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Drejtoria e Auditimit të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit për kontrollin e ushtuar në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të



Shërbimeve të Transportit Rrugor me shkresën nr. 9/12, datë 04.09.2008, ka rekomanduar zbatimin e dy detyrave, e konkretisht:

1. DPSHTRR, në bashkëpunim me Drejtorinë e Qarkullimit Rrugor të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të evidentojë mjetet që kanë dalë jashtë qarkullimit, duke i detyruar të dorëzojnë targat ose të paguajnë detyrimet që rrjedhin nga taksat.

Për këtë, DPSHTRR për realizimin e kësaj detyre ka hartuar program pune dhe ka marrë masa për të sensibilizuar opinionin publik nëpërmjet posterave të ndryshëm, njoftimeve në mediat vizive e mediat e shkruara me tirazh të madh dhe nëpërmjet spoteve publicitare në 2 TV kombëtare. Si rrjedhojë e masave të mara nga 145.298 mjete që kanë detyrime të prapambetura, janë paraqitur dhe kanë paguar detyrimet vetëm 7.224 mjete, si dhe janë paraqitur dhe ç'regjistruar 10.776 mjete, gjithsej 18.000 mjete ose 12,4 % e tyre. Ky proces vazhdon të kryhet edhe për periudhën në vazhdim.

2. DPSHTRR, të evidentojë të gjitha mjetet motorike në përdorim të institucioneve buxhetore dhe detyrimin e tyre për kontrollin teknik periodik dhe dokumentimin e mjeteve jashtë qarkullimit.

Për këtë, DPSHTRR, ka hartuar program pune duke njoftuar gjithë institucionet buxhetore në zbatim të ligjit nr. 9986, datë 11.09.2008 dhe VKM nr.1398, datë 17.10.2008 "Për faljen e detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve e të taksës së regjistrimit të përvitshëm të tyre".

Aktiviteti Ekonomiko-Financiar i DPSHTRR është kontrolluar nga Drejtoria e Auditimit të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për periudhën 01.04.2008- 31.03.2009. Raporti Final dhe konkluzionet e auditimit janë dërguar me shkresën nr. 1847/5, datë 06.07.2009, në të cilën janë rekomanduar 16 detyra, kryesisht të karakterit organizativ, që kanë të bëjnë me sistemimin e disa llogarive, bashkëpunimin e drejtorive rajonale me degët e tatim taksave, me Drejtoritë Rajonale të Policisë për arkëtimin e taksave vjetore të regjistrimit dhe qarkullimit për mjetet që nuk janë paraqitur për kolaudimin periodik të radhës dhe të rregullores së funksionimit të drejtorisë.

2. Kontrolli mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

- Zbatimi i kriterëve dhe procedurat e hartimi të buxhetit për vitet 2008 dhe 2009. Mbi zbatimin e kriterëve në çeljen e fondeve dhe detajimin e planit fillestar, zbatimin e buxhetit gjatë vitit, nivelet e realizimit të planit përfundimtar.

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor është krijuar me VKM nr. 343, datë 21.07.1999 "Për Krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor".



Në mbështetje të këtij vendimi është hartuar statuti i DPSHTRr, i cili është miratuar nga ministri me shkresën nr. 4703, datë 22/11/2002, në nenin 1 të tij theksohet se: "Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, është institucion shtetëror, me status Person Juridik Publik dhe me vetëfinancim.

Veprimtaria e DPSHTRr, rregullohet me ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për Transportin Rrugor", ligjin nr. 8435, datë 28.12.1998 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 8581, datë 17.02.2000 ndryshuar me ligjin nr. 8840, datë 11.12.2001, ligjin nr. 7572, datë 13.07.1992 "Për Ndërmarrjet Shtetërore", V.K.M. nr. 153, datë 07.04.2000 "Për miratimin e Rregullores së Kodit Rrugor" dhe VKM nr. 343, datë 21.07.1999.

Programi ekonomik financiar për vitin 2008 është miratuar nga Këshilli Drejtues me Vendimin nr. 39, datë 21.12.2007, ndërsa M.P.P.T.T. me shkresën nr. 9635/1, datë 24.01.2008, ka rritur rezultatin financiar nga 325.600 mijë lekë të paraqitur nga DPSHTRr-ja në vlerën 366 300 lekë ose më tepër 40.700 mijë lekë. Treguesit financiarë të programuar për vitin 2008 paraqiten në tabelën e më poshtme:

Treguesit	Në 000 lekë			
	Realizim i vitit 2007	Program i vitit 2008	Realizimi vitit 2008	% Realizimit
Të ardhurat	1 444 388	1 542 643	1 652 565	107.1%
Shpenzimet	964 847	1 135 643	1 066 768	94%
Rezultati (bruto)	479 541	407 000	585 798	144

Nga tabela e mësipërme rezulton se, programimi i të ardhurave për vitin 2008 në raport me realizimin e vitit 2007 është hartuar me rritje 6.8%, dhe për shpenzimet është programuar rritje në masën 11.8%, duke ulur rezultatin financiar në masën 15.1%. Realizimi i treguesve financiarë për vitin 2008 në raport treguesit e vitit 2007 paraqiten me rritje, e konkretisht, të ardhurat janë rritur me 14.4 %, ndërsa shpenzimet janë rritur me 10.6 % dhe rezultati financiar është rritur me 22.1%.

Për vitin 2009 programi ekonomik financiar është miratuar nga Këshilli Drejtues me Vendimin nr. 81, datë 09.01.2009 dhe nga M.P.P.T.T. me shkresën nr. 164/1, datë 21.01.2009, paraqitet si vijon:

- Të ardhurat gjithsej 1 673 910 mijë lekë.
- Shpenzimet gjithsej 1 200 438 mijë lekë.
- Fitimi bruto 473 472 mijë lekë.
- Fitimi neto 426 125 mijë lekë.
- Investime nga fondet e veta 147 580 mijë lekë.

Miratimi nga ministri është bërë pa ndryshime. Në shkresën e miratimit ministri ka vendosur që shpërblymi mbi pagë, për vështirësi në punë, të bëhet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, të përcaktuara në nenin 8-të, pika 3. a, të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare" (jo ato vendore).



Në tabelën më poshtë paraqitet dinamika e programimit të treguesve kryesor financiar për tri vitet e fundit:

Në 000 lekë

Treguesit	Realizim i vitit 2007	Program i vitit 2008	Realizimi i vitit 2008	Programi i vitit 2009
Të ardhurat	1 444 338	1 542 643	1 652 565	1 673 910
Shpenzimet	964 847	1 135 643	1 066 768	1 200 438
Rezultati (bruto)	479 541	407 000	585 798	473 472

Në hartimin e programit të vitit 2009 nuk është vlerësuar numri i mjeteve të regjistruara në inventarin e DPSITFR, të cilat duhet të paguajnë taksat sipas ligjit, që përbën edhe kapacitetin fiskal që duhet të përlllogariten e programohen si të ardhura; kjo për shkak të amnistisë fiskale të parashikuar në ligjin nr. 9986, datë 11.09.2008 "Për faljen e detyrimeve doganore dhe tatimore, detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve dhe të taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve, si dhe të gjobave dhe kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore" dhe në VKM nr. 1398, datë 17.10.2008 "Për faljen e detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve dhe taksës së regjistrimit të përvitshëm të tyre", në të cilin është parashikuar falja e detyrimeve të prapambetura dhe mundësia e çregjistrimit të mjeteve nga subjektet që i zotërojnë ato.

Zbatimi i ligjit dhe vendimit të mësipërm ka sjellë si pasojë që, planifikimi i të ardhurave për vitin 2009 të ketë rritje 1.3%, shpenzimet e planifikuara të rriten me 12.5 %, ndërsa rezultati financiar është programuar me rreth 20 % më pak se realizimi i vitit 2008. Për periudhën Janar-Shtator 2009, realizimi i treguesve paraqitet në tabelën më poshtme:

Në 000 lekë

Treguesit	Realizim i 9/m 2008	Program i 9/m 2009	Realizimi 9/m 2009	Realizimi në %
Të ardhurat	1 195 700	1 260 751	1 209 662	95.9 %
Shpenzimet	694 898	896 646	822 431	91.7 %
Rezultati (bruto)	500 802	364 105	387 231	106.3 %

Nga të dhënat e tabelës së më sipërme rezulton se treguesit e të ardhurave paraqiten me mosrealizim në masën 4.1%, shpenzimet janë me mosrealizim për 8.3 %, ndërsa rezultati financiar është me tejkalim për 6.3%.

- Mbi zbatimin e kriterëve për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit me destinacion fondet për investime.

Sipas programit financiar për vitin 2008, fondi për investime është programuar në vlerën 151 400 mijë lekë, i ndarë respektivisht; 94 650 mijë lekë për ndërtime, 30 000 mijë lekë inventar ekonomik, 23 750 mijë lekë për makineri e pajisje dhe 3 000 mijë lekë për pajisje informatike. Me shkresën e ministrit nr. 7138/1, datë 15.10.2008 është ndryshuar programi i investimeve nga 151 400 mijë lekë në 86 400 mijë lekë. Pakësim janë bërë në zërin e investimeve për ndërtim.



Janë pakësuar fondet për Drejtoritë rajonale Berat e Shkodër dhe në Drejtorinë e Përgjithshme Tiranë. Konkretisht në Berat, ndërtim godinë administrative në vlerën 20 000 mijë lekë investim i pa realizuar pasi nuk është zgjidhur problemi për gjetjen e truallit për ndërtim dhe për mungesë të planit rregullues të qytetit nuk lejohet të bëhet ndërtim në godinën ekzistuese; në Shkodër ndërtim godinë administrative në vlerën 20 000 mijë lekë investim i pa realizuar pasi nuk është zgjidhur problemi për truall për ndërtim; në Drejtorinë e Përgjithshme rikonstruksion i godinës në vlerën 25 000 mijë lekë dhe investime të tjera që janë rikonstruksione apo riparime të ndryshme. Edhe ky investim është i pa realizuar pasi godina ekzistuese nuk ka certifikatë pronësie për DPSHTRr-në, e si rrjedhim nuk mund të merret leje ndërtimi në Bashkinë Tiranë.

Për vitin 2008 plani i investimeve të ndërtimeve nga 94 650 mijë lekë u bë 42 150 mijë lekë. Programi i investimeve të ndërtimit të DPSHTRr-së për vitin 2008 është realizuar rreth 70.3 % ose 29.629 mijë lekë. Gjithashtu janë programuar 30.000 mijë lekë për inventar ekonomik. Me ndryshimet në programin e investimeve për inventarin ekonomik investimet u bënë 17.500 mijë lekë, i cili është realizuar rreth 74 % ose 12.977 mijë lekë. Për makineri e pajisje ishin programuar 23.750 mijë lekë i cili nuk është realizuar. Investimet për pajisje informatike ishin programuar 3.000 mijë lekë dhe janë realizuar rreth 85.5 % ose 2.564 mijë lekë. Në total investimet janë realizuar rreth 52.3 % ose 45.170 mijë lekë nga 86.400 mijë lekë të programuara.

Për vitin 2009 programi i investimeve ka të njëjtin prioritet atë të ndërtimit të godinave administrative dhe rikonstruksionit të tyre. Në programin e vitit 2009 janë programuar 81 580 mijë lekë ndërtime, 29 000 mijë lekë inventar ekonomik dhe 37 000 mijë lekë pajisje informatike. Me shkresën nr. 2788/1, datë 05.05.2009 "Për miratimin e ndryshimeve të Programit Ekonomik të vitit 2009", të kërkuara me shkresën nr. 2641, datë 27.04.2009 të DPSHTRr-së, ministri ka miratuar ndryshimin e programit të investimeve dhe të numrit të punonjësve. Ndërtimet nga 81 580 mijë lekë bëhen 93 600 mijë lekë, inventari ekonomik nga 29 000 mijë lekë bëhet 67 000 mijë lekë dhe në total nga 147 580 mijë lekë në 197 600 mijë lekë. Numri i punonjësve nga 745 punonjës ulet në 700 punonjës. Edhe gjatë këtij viti për Drejtoritë Rajonale Berat dhe Shkodër, janë programuar respektivisht nga 30 000 mijë lekë për secilën drejtori dhe për Drejtorinë e Përgjithshme 3 500 mijë lekë të cilat nuk janë realizuar për mungesë shesh ndërtimi.

Për vitin 2009 programi i investimeve të ndërtimeve nga 93 600 mijë lekë është realizuar 30 100 mijë lekë ose rreth 32.2 %. Shpenzimet për inventar ekonomik nga 67 000 mijë lekë janë realizuar 38 133 mijë lekë ose rreth 57 %. Investimet për pajisje informatike nga 37 000 mijë lekë janë realizuar 33 224 mijë lekë ose rreth 80 %. Në total investimet nga 197 600 mijë lekë janë realizuar 101 457 mijë lekë ose rreth 51.3 %.

Realizimi i investimeve është në nivelin e rreth 50 % si për vitin 2008 ashtu edhe për vitin 2009. Në realizimin e investimeve ka ndikuar ndjeshëm mos



realizimi i investimeve në Berat, Shkodër dhe në Drejtorinë e Përgjithshme që ka ardhur për mos zgjidhje të problemit të pronësisë mbi truallin për ndërtimet.

3.Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë pagat dhe shpërblimet.

- *Respektimi i strukturave organike të miratuara krahasimi me faktin, për tremujorin e IV të vitit 2008 dhe katër mujorin e III-të për vitin 2009.*

Nga kontrolli i ushtuar për periudhën e caktuar në program të kontrollit rezultoi se:

Për 3-mujorin e katërt të vitit 2008 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, ka punuar me strukturën dhe organikën e përcaktuar në shkresën e ministrit të MPPTT-së nr. 5541/, datë 29.10.2004, në të cilën është përcaktuar numri i punonjësve 57 punonjës. Me këtë organikë është punuar deri në nxjerrjen e shkresës nr. 4836/1, datë 09.07.2008 në të cilën është miratuar numri i punonjësve gjithsej 64. Me shkresën nr. 641/1, datë 09.02.2009 të ministrit numri i punonjësve bëhet 72. Me këto struktura ka punuar DPSHTRr Tiranë për vitet 2008 dhe 2009.

Nga kontrolli i listë pagesave për periudhën e përcaktuar në programin e kontrollit rezultoi se janë zbatuar strukturat konform dispozitave ligjore në fuqi. Në programet e miratuara për vitin 2008 dhe 2009 numri i punonjësve për DPSHTRr dhe drejtoritë rajonale rezulton si më poshtë:

Për vitin 2008 numri i punonjësve për gjithë institucionin është programuar të jetë 625 punonjës. Me shkresën nr. 7138/1 të ministrit të MPPTT-së, numri është rritur 35 punonjës duke u bërë 660 punonjës. Nga kontrolli i bilancit rezulton se numri fizik i punonjësve në fund të vitit ka qenë 660 punonjës. Për vitin 2009 numri i punonjësve për të gjithë institucionin është programuar të jetë 718 punonjës, ose më tepër 58 punonjës se viti 2009.

Llogaritja e pagave është bërë në mbështetje të ligjit nr. 8487, datë 13.05.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", i ndryshuar, ligjit nr. 7582, datë 13.07.92 "Për ndërmarrjet shtetërore", të VKM nr. 317, datë 08.09.1999, "Për shpërblimin e punës së punonjësve", të Statutit të DPSHTRr-së të miratuar me shkresën e ministrit të MPPTT-së nr. 4703, datë 22.11.2002, i ndryshuar me urdhrin e ministrit nr. 80, datë 29.05.2008. Në mbështetje të legjislacionit të mësipërm nga Drejtoria dhe Këshilli Drejtues kanë dale vendime të veçanta për nivelin e pagave sipas vendeve të punës. Përcaktimi i pagave sipas kategorive është mbështetur në Vendimin nr. 76, datë 12.12.2008 "Për pagat e punonjësve të DPSHTRr-së".

Nga kontrolli i listë pagesave të viteve 2008 dhe 2009 për periudhat e përcaktuara në programin e kontrollit rezultoi se janë zbatuar dispozitat ligjore në fuqi të cituar më sipër.



2.2.2. Punësimi dhe pagat e punonjësve

-Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve dhe kuadraturat përkatëse për 4/mujorin e parë të vitit 2008 e 2009.

Nga kontrolli i kryer për listë pagesat për periudhat e përcaktuara në programin e kontrollit rezultoi se pagat janë regjistruar dhe kontabilizuar konform ligjit sipas VKM-ve të cituara më sipër.

- Shtesa për vjetërsi për çdo punonjës është llogaritur nga Drejtoria e Personelit, i cili në fillim të çdo viti ka përcaktuar vjetërsinë e çdo punonjësi për vitet 2008 dhe 2009. Nga kontrolli rezultoi se, vjetërsia e punonjësve është bazuar në librezën e punës të secilit punonjës.

Është mbajtur libri i pagave dhe është plotësuar për të gjithë punonjësit në marrëdhënie pune duke pasqyruar të gjitha të dhënat e kërkuara.

- Tatimi mbi pagë është llogaritur konform ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar me ligjin nr. 9458, datë 21.12.2005 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998" "Për tatimin mbi të ardhurat", si dhe me ligjin nr. 9766, datë 09.07.2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar".

Kontributi i sigurimeve shoqërore është llogaritur sipas VKM nr. 346, datë 07.06.2002 "Për disa ndryshime në VKM nr. 402, datë 1.06.2001" në zbatim të ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" me ndryshimet përkatëse; VKM nr. 424, datë 02.07.2004 "Për disa ndryshime në VKM nr. 402, datë 1.06.2001"; VKM nr. 385, datë 31.05.2005 "Për disa ndryshime në VKM nr. 402, datë 1.06.2001" dhe VKM nr. 444, datë 21.06.2006 "Për disa ndryshime në VKM nr. 167, datë 29.03.2006", ndryshuar me VKM nr. 557, datë 16.08.2006 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

-Respektimi i kufijve të fondeve të planifikuara me destinacion shpenzimet e pagave të punonjësve.

Në tabelën e më poshtme paraqiten të dhënat për planifikimin dhe realizimin e fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondin e veçantë për periudhën e kontrolluara në aparatin e DPSHTRr-së:

Në 000 lekë

Nr	Viti	Pagat				Sig. shoqërore dhe shëndetësore			
		Plan	Fakt	%	Diferenca	Plan	Fakt	%	Diferenca
1	2008	97 501	90 273	92.6	-7228	21 157	18 134	85.7	-3023
2	2009	48 630	48 698	100.1	68	10 553	8 217	77.9	-2336

Nga të dhënat e tabelës rezulton se për vitin 2008 edhe fondi i pagave dhe sigurimet shoqërore janë me mos realizim, ndërsa për 9 mujorin 2009 pagat janë realizuar 100 %, ndërsa sigurimet shoqërore janë me mos realizim të ndjeshëm.



- Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore etj.

Fondi i veçantë është krijuar sipas dispozitave ligjore dhe statutit të DPSHTRR, miratuar nga ministri në datën 22.11.2002, kapitulli IV "Kontabiliteti, Gjendja Financiare, Përdorimi i Fitimit", neni 16 germa d "Për krijimin e rezervës për shpërblimin suplementar të punonjësve". Mbështetur në dispozitat ligjore Drejtori i Përgjithshëm i DPSHTRR-së ka nxjerrë urdhrat për krijimin e grupeve për përcaktimin e shpërblimeve për çdo drejtori rajonale dhe për çdo punonjës të DPSHTRR-së. Me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 486, datë 01.09.2008 është ngritur grupi për përcaktimin e masës së shpërblimit nga të ardhurat si agent tatimor, të cilët kanë dhënë dy variante. Njeri variant 2.14 paga mujore dhe tjetri 1.99 paga mujore. Këshilli Drejtues me Vendimin nr. 69, datë 17.09.2008 ka vendosur që për disa drejtori rajonale të jetë masa e shpërblimit 2.2 paga mujore dhe për disa drejtori të jetë 2.1 paga mujore. Me urdhrin nr. 753, datë 18.12.2008 është ngritur grupi i punës i cili ka përcaktuar masën e shpërblimit 1.56 paga mujore shpërblim nga të ardhurat si agent tatimor. Me vendimin nr. 80, datë 23.12.2008 të Këshillit Drejtues është përcaktuar që në mbështetje të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare" masa e shpërblimit të jetë deri në 20 % të pagës, ndërsa në mbështetje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore masa e shpërblimit të jetë deri në 10 % të pagës. Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 81, datë 23.12.2008 është vendosur që shpërblimi të jetë 1.6, 1.5, 1.4 dhe 1.3 paga mujore për çdo punonjës i ndryshëm në drejtoritë rajonale. Me urdhrin nr. 529, datë 21.07.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm është krijuar grupi i punës i cili ka llogaritur shpërblimin 1.2 paga mujore. Me vendimin e këshillit mbikëqyrës nr. 13, datë 25.07.2009 është vendosur që shpërblimi të jetë 1.2 paga mujore. Edhe ky shpërblim është bërë nga të ardhurat si agent tatimor. Nga kontrolli i listë pagesave rezultoi se shpërblimi është bërë i rregullt sipas vendimeve të mësipërme.

Mbi kontrollin e ushtruar në disa Drejtori Rajonale.

Në Drejtorinë Rajonale Shkodër.

Nga kontrolli i ushtruar për periudhën e përcaktuar në programin e kontrollit rezultoi se:

Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Shkodër miratimi i programit financiar të vitit 2008 është bërë me shkresën e DPSHTRR-së nr. 659, datë 29.1.2008, në të cilën është miratuar organika me 29 punonjës. Për vitin 2009 me shkresën nr. 450, datë 26.01.2009 është miratuar organika me 36 punonjës ose 7 punonjës më tepër. Nga kontrolli i listë pagesave për periudhën e përcaktuar në programin e kontrollit rezultoi se janë zbatuar strukturat konform dispozitave ligjore në fuqi.



Llogaritja e pagave është bërë në mbështetje të ligjit nr. 8487, datë 13.05.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", i ndryshuar, të ligjit nr. 7582, datë 13.07.92 "Për ndërmarrjet shtetërore", të VKM nr. 317, datë 08.09.1999, "Për shpërblimin e punës së punonjësve", të Statutit të DPSHTRr-së të miratuar me shkresën nr. 4703, datë 22.11.2002 të ministrit të MPPTT-së, i ndryshuar me urdhrin e ministrit nr. 80, datë 29.05.2008. Në mbështetje dispozitave ligjore, Drejtoria dhe Këshilli Drejtues kanë nxjerrë vendime të veçanta për nivelin e pagave sipas vendeve të punës. Përcaktimi i pagave sipas kategorive është mbështetur në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 76, datë 12.12.2008 "Për pagat e Punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor". Nga kontrolli i listë pagesave të viteve 2008 dhe 2009 për periudhat e përcaktuara në programin e kontrollit rezultoi se, janë zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

-Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve dhe kuadraturat përkatëse për 4/mujorin e parë të vitit 2008 e 2009.

Nga kontrolli i kryer në listë pagesat sipas periudhave të përcaktuara në programin e kontrollit rezultoi se, pagat janë regjistruar dhe kontabilizuar konform dispozitave ligjore.

Shtesa për vjetërsi për çdo punonjës është llogaritur nga Drejtoria e Personelit, i cili në fillim të çdo viti ka përcaktuar vjetërsinë e çdo punonjësi për vitet 2008 dhe 2009. Nga kontrolli rezultoi se, vjetërsia e punonjësve është bazuar në librezën e punës të secilit punonjës. Libri i pagave është plotësuar për të gjithë punonjësit në marrëdhënie pune duke pasqyruar të gjitha të dhënat e kërkuara.

-Respektimi i kufijve të fondeve të planifikuara me destinacion shpenzimet e pagave të punonjësve.

Në tabelën e më poshtme paraqiten të dhënat për planifikimin dhe realizimin e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për periudhën e kontrolluara në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër:

Në 000 lekë

Nr	Periudha	Pagat				Sig.shoqërore e shëndetësore			
		Plan	Fakt	%	Diferenca	Plan	Fakt	%	Diferenca
1	2008	17 769	17 274	97.2	- 495	3 856	3 695	95.8	- 161
2	9/muj 2009	17 883	17 685	98.9	- 198	3 880	3 401	87.6	- 479

Nga të dhënat e tabelës së më sipërme rezulton se, për vitin 2008 zërat janë realizuar më pak se 100 %. Edhe për 9 mujorin e vitit 2009 zërat janë me mosrealizim të programit. Të dhënat e paraqitura në tabelën e më sipërme janë të rakorduara me ditarët e kontabilitetit.

- Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore etj.



Drejtoria Rajonale të DPSHTRr- së nuk llogarisin fond të veçantë dhe nga ky fond nuk jepet shpërblim. Shpërblimi jepet nga të ardhurat si agjentë tatimor të caktuara nga DPSHTRr Tiranë.

Drejtoria Rajonale Fier.

- Respektimi i strukturave organike të miratuara krahasimi me faktin, për tremujorin e IV të vitit 2008 dhe katërmujorin e III-të për vitin 2009.

Nga kontrolli i ushtuar për periudhën e caktuar në program të kontrollit rezultoi se:

Drejtoria Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Fier në miratimin e programit financiar të vitit 2008 me shkresën e DPSHTRr- së nr. 659, datë 29.1.2008 i është miratuar organika me 44 punonjës. Me shkresën nr. 4639, datë 30.06.2008 struktura është miratuar për 51 punonjës, me shkresën nr. 7522, datë 29.10.2008 struktura është miratuar për 53 punonjës dhe me shkresën nr. 8407, datë 15.12.2008 struktura është miratuar për 53 punonjës. Për vitin 2009 me shkresën nr. 450, datë 26.01.2009 i është miratuar numri mesatar i punonjësve, 53 punonjës. Me shkresën nr. 973, datë 13.02.2009 struktura është miratuar për 54 punonjës, me shkresën nr. 4102, datë 11.06.2009 struktura është miratuar për 57 punonjës dhe me shkresën nr. 5116/1, datë 31.07.2009 struktura është miratuar për 59 punonjës. Nga kontrolli i listë pagesave për periudhën e përcaktuar në programin e kontrollit rezultoi se, janë zbatuar strukturat konform dispozitave ligjore në fuqi.

Llogaritja e pagave është bërë në mbështetje të ligjit nr. 8487, datë 13.05.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", i ndryshuar, të ligjit nr. 7582, datë 13.07.92 "Për ndërmarrjet shtetërore", të VKM nr. 317, datë 08.09.1999, "Për shpërblimin e punës së punonjësve", të Statutit të DPSHTRr-së të miratuar me shkresën nr. 4703, datë 22.11.2002 të ministrit të MPPTT-së, i ndryshuar me urdhrin e ministrit nr. 80, datë 29.05.2008. Në mbështetje të legjislacionit të më sipërm nga Drejtoria dhe Këshilli Drejtues kanë dalë vendime të veçanta për nivelin e pagave sipas vendeve të punës.

Përcaktimi i pagave sipas kategorive është mbështetur në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 76, datë 12.12.2008 "Për pagat e punonjësve të DPSHTRr-së Tiranë. Nga kontrolli i listë pagesave të viteve 2008 dhe 2009 për periudhat e përcaktuara në programin e kontrollit rezultoi se janë zbatuar dispozitat ligjore.

-Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve dhe kuadraturat përkatëse për 4/mujorin e parë të vitit 2008 e 2009.

Nga kontrolli i kryer për listë pagesat për periudhat e përcaktuar në programin e kontrollit rezultoi se pagat janë regjistruar dhe kontabilizuar konform dispozitave ligjore.

- Shtesa për vjetërsi për çdo punonjës është llogaritur nga Drejtoria e Personelit, i cili në fillim të çdo viti ka përcaktuar vjetërsinë e çdo punonjësi për



vitet 2008 dhe 2009. Nga kontrolli rezultoi se, vjetërsia e punonjësve është bazuar në librezën e punës të secilit punonjës.

Është mbajtur libri i pagave dhe është plotësuar për të gjithë punonjësit në marrëdhënie pune duke pasqyruar të gjitha të dhënat e kërkuara.

-Respektimi i kufijve të fondeve të planifikuara me destinacion shpenzimet e pagave të punonjësve.

Në tabelën e më poshtme paraqiten të dhënat për planifikimin dhe realizimin e fondit të pagave, sigurimeve shoqërore për periudhën e kontrolluar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Fier:

Në 000 lekë

Nr	Periudha	Paga				Sig.shoqërore dhe shëndetësore			
		Plan	Fakt	%	Diferenca	Plan	Fakt	%	Diferenca
1	2008	8 458	8 449	99.9	- 9	1835	1807	98.5	- 28
2	9/muj 2009	10 053	7 468	74.3	- 2 585	2 181	1 401	64.2	- 780

Nga të dhënat e tabelës së më sipërme rezulton se për vitin 2008 zërat janë realizuar më pak se 100 %. Për 9 mujorin e vitit 2009 zërat si pagat dhe sigurimet shoqërore janë me mosrealizim të ndjeshëm të programit.

Nga kontrolli rezultoi se të dhënat e paraqitura në tabelën e më sipërme janë të rakorduara me ditarët e kontabilitetit.

- Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore etj.

Drejtoritë Rajonale të DPSHTRr- së nuk llogarisin fond të veçantë dhe nga ky fond nuk jepet shpërblim. Shpërblimi jepet nga të ardhurat si agjentë tatimor të caktuara nga DPSHTRr-ja Tiranë.

Drejtoria Rajonale Dibër.

- Respektimi i strukturave organike të miratuara krahasimi me faktin, për tremujorin e IV të vitit 2008 dhe katër mujorin e III-të për vitin 2009.

Nga kontrolli i ushtruar për periudhën e caktuar në program të kontrollit rezultoi se:

Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Dibër në miratimin e programit financiar të vitit 2008 me shkresën e DPSHTRr-së nr. 659, datë 29.1.2008 i është miratuar organika me 16 punonjës. Për vitin 2009 me shkresën nr. 450, datë 26.01.2009 i është miratuar organika me 20 punonjës. Nga kontrolli i listë pagesave për periudhën e përcaktuar në programin e kontrollit rezultoi se janë zbatuar strukturat konform dispozitave ligjore në fuqi.

Llogaritja e pagave është bërë në mbështetje të ligjit nr. 8487, datë 13.05.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", i ndryshuar, të ligjit nr. 7582, datë 13.07.92 "Për ndërmarrjet shtetërore", të VKM nr. 317, datë 08.09.1999, "Për shpërblimin e punës së punonjësve", të Statutit të DPSHTRr-së



të miratuar me shkresën nr. 4703, datë 22.11.2002 të ministrit të MPPTT-së, i ndryshuar me urdhrin e ministrit nr. 80, datë 29.05.2008. Në mbështetje të legjislacionit të mësipërm nga Drejtoria dhe Këshilli Drejtues kanë dale vendime të veçanta për nivelin e pagave sipas vendeve të punës.

Përcaktimi i pagave sipas kategorive është mbështetur në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 76, datë 12.12. 2008 "Për pagat e punonjësve të DPSHTRr-së". Nga kontrolli i listë pagesave të viteve 2008 dhe 2009 për periudhat e përcaktuara në programin e kontrollit rezultoi se janë zbatuar dispozitat ligjore në fuqi të cituar më sipër.

-Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve dhe kuadraturat përkatëse për 4/mujorin e parë të vitit 2008 e 2009.

Nga kontrolli i kryer për listë pagesat për periudhat e përcaktuara në programin e kontrollit rezultoi se pagat janë regjistruar dhe kontabilizuar konform ligjit sipas VKM-ve të cituara më sipër.

- Shtesa për vjetërsi për çdo punonjës është llogaritur nga Drejtoria e Personelit, i cili në fillim të çdo viti ka përcaktuar vjetërsinë e çdo punonjësi për vitet 2008 dhe 2009. Nga kontrolli rezultoi se, vjetërsia e punonjësve është bazuar në librezën e punës të secilit punonjës.

Është mbajtur libri i pagave dhe është plotësuar për të gjithë punonjësit në marrëdhënie pune duke pasqyruar të gjitha të dhënat e kërkuara.

-Respektimi i kufijve të fondeve të planifikuara me destinacion shpenzimet e pagave të punonjësve.

Në tabelën e më poshtme paraqiten të dhënat për planifikimin dhe realizimin e fondit të pagave, sigurimeve shoqërore për periudhën e kontrolluar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Dibër:

në 000 lekë

Nr	Periudha	Paga				Sig.shoqërore dhe shëndetësore			
		Plan	Fakt	%	Diferenca	Plan	Fakt	%	Diferenca
1	2008	8 458	8 449	99.9	- 9	1835	1807	98.5	- 28
2	9/muj 2009	10 053	7 468	74.3	- 2 585	2 181	1 401	64.2	- 780

Nga të dhënat e tabelës së më sipërme rezulton se për vitin 2008 zërat janë realizuar më pak se 100 %. Për 9 mujorin e vitit 2009 zërat si pagat dhe sigurimet shoqërore janë me mosrealizim të ndjeshëm të programit.

Nga kontrolli rezultoi se të dhënat e paraqitura në tabelën e më sipërme janë të rakorduara me ditarët e kontabilitetit.

- Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore etj.

Drejtoritë Rajonale të DPSHTRr- së nuk llogarisin fond të veçantë dhe nga ky fond nuk jepet shpërblim. Shpërblimi jepet nga të ardhurat si agjentë tatimor të caktuara nga DPSHTRr Tiranë.



4. Mbi administrimin e pronës shtetërore. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

a. Ligjshmëria dhe saktësia e pagesave të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës në lekë dhe në valutë, për periudhën objekt kontrolli.

- Mbi veprimtarinë e arkës në lekë.

Nga kontrolli i ushtruar në veprimet e arkës, rezultoi se veprimet e arkës ishin kryer konform dispozitave ligjore, kontabilizimi i veprimeve është kryer konform planit kontabël.

Spektori i financës, në mënyrë sistematike ka kryer kontroll në arkat e vartësisë për saktësimin e veprimeve të arkës dhe gjendjen e likuiditeteve. Llogaria e arkës në lekë paraqitet e kundruar me bilancin kontabël.

- Mbi veprimtarinë e bankës.

Nga kontrolli i ushtruar në veprimet e bankës, rezultoi se veprimet janë kryer konform planit kontabël. Veprimtaria financiare e DPSHTRr ushtrohet nëpërmjet 6 bankave, llogaritë e gjendjes fizike të mjeteve monetare në bankë në fund të viti ushtrimor janë të kuadruara me bilancin kontabël.

Nga kontrolli i pagesave nëpërmjet veprimeve të bankës u konstatuan këto mangësi:

1. Me urdhërpagesën nr. 30, datë 26.05.2008 është xhiruar në favor të subjektit projektues "Al-tek" shpk vlera prej 374.138 lekë, i shpallur fitues në tenderin për "Hartimin e projektit dhe preventivit të ngrohjes DRSHTTR Fier me vlerën prej 5.474.659 lekë.

Nga kontrolli për mënyrën e llogaritjes së shpërblimit të projektuesit rezultoi se, veprimet janë kryer mbi vlerën totale të preventivit prej 5.474.659 X 10.2 % X 67 % = 374.138 lekë, pa zbritur vlerën e makinerive dhe pajisjeve të blera, në kundërshtim me VKM nr. 444, datë 05.09.1994, me ndryshimet.

Vlera e makineri pajisjeve të blera dhe të përfshira në preventiv, me të cilin është llogaritur pagesa është 722.954 lekë. Puna për montimin e pajisjeve është 180.276 lekë. Vlera e makineri pajisjeve pa punën e montimit është 542.678 lekë (722.954 - 180.276). Sipas VKM nr. 444, datë 05.09.1994, germa "A" shpërblimi i subjektit sipërmarrës duhej të llogaritej mbi vlerën 4.823.444 lekë të preventivit minus vlerën e makineri pajisjeve $\{(4.562.215 - 542.678 = 4.019.537 \times 20\% = 4.823.444)\}$. Shpërblimi që i takon subjektit sipërmarrës për hartimin e projektit dhe preventivit do të jetë në vlerën 329.634 lekë $(4.823.444 \times 10,2\% = 491.991 \times 67\%)$.

Për sa më lart pagesa ndaj subjektit është kryer për vlerën 374.138 lekë dhe jo për vlerën 329.634 lekë. Si njëdhjetë e llogaritjeve të gabuara subjekti "Al-Tek" ka përfutuar më tepër vlerën **44.504 lekë**. $(374.138 - 329.634)$.



2. Me urdhër pagesën nr. 1, datë 04.08.2008 është xhiruar në favor të subjektit projektues "Al-tek" shpk vlera prej 236.202 lekë i shpallur fitues respektivisht për hartimin e projektit dhe preventivit të DRSHTRR Diber në vlerën 127.602 lekë dhe DPSHTRR Kukës në vlerën 108.600 lekë.

Nga kontrolli u konstatuan llogaritje të gabuara, pasi në vlerën totale të preventivit janë përfshirë makineri pajisjet në vlerën 416.126 lekë. Puna për montimin e pajisjeve është në vlerën 100.472 lekë. Vlera e makineri pajisjeve pa punën e montimit është 315.654 lekë ($416.126 - 100.472$)

Për sa më lart llogaritjet duhej të kryheshin për vlerën e preventivit 1.064.025 në të cilën nuk është përfshirë vlera e makineri-pajisjeve të blera: $1.202.342 - 315.654 = 886.688 \times 20 \%$.

Sipas VKM nr. 444, datë 05.09.1994, germa "A" Pagesa e subjektit duhej të llogaritej në vlerën prej 94.102 lekë ($1.064.025 \times 13.2 \% = 140.451 \times 67\%$). Si rrjedhojë e këtij veprimi subjekti ka përfituar më tepër vlerën prej 33.500 lekë ($127.602 - 94.102$).

3. Për hartimin e projektit dhe preventivit të DRSHTRR Kukës, shpërblimi është llogaritur në vlerën 108.600 lekë. Llogaritjet për këtë pagesë janë kryer me vlerën totale të preventivit pa zbritur vlerën e makineri pajisjeve 416.126 lekë. Puna për montimin e pajisjeve është 100.472 lekë. Vlera e makineri pajisjeve pa punën e montimit është 315.654 lekë ($416.126 - 100.472$)

Për sa më lart llogaritjet duhej të kryheshin me vlerën e preventivit prej 1.064.025 (nuk është përfshirë vlera e makineri-pajisjeve të blera $1.202.342 - 315.654 = 886.688 \times 20 \%$).

Sipas VKM nr. 444, datë 05.09.1994, germa "A" Pagesa e subjektit duhej të llogaritej në vlerën prej 94.102 lekë ($1.064.025 \times 13.2 \% = 140.451 \times 67\%$). Si rrjedhojë e këtij veprimi subjekti ka përfituar më tepër vlerën prej 33.500 lekë ($127.602 - 94.102$).

Përfundimisht; për tre projektet e hartuara, subjekti "Al-tek" ka përfituar më tepër vlerën 111.504 lekë ($44.504 + 33.500 + 33.500$).

4. Për periudhën objekt kontrolli DPSHTRR, ka dëmshpërblyer pagat e 46 punonjësve në vlerën 28.583.650 lekë, të cilët kanë fituar gjyqin ndaj institucionit për pushim pa të drejtë nga puna. Pagesat janë kryer me urdhër bllokimi nga zyra e Përmbartimit Gjyqësor Tiranë si rrjedhojë e mosekzekutimit vullnetar, duke paguar shpenzimet e zyrës së përmbartimit në masën 7 % në vlerën 1.806.756 lekë, veprim i cili ka rritur padrejtësisht shpenzimet e DPSHTRR.

Me urdhër bllokimin nr. 5, datë 13.07.2009 Zyra e Përmbartimit Tiranë sipas vendimit të Gjykatës Apelit Tiranë, ka arkëtuar në llogarinë e saj likuiduese vlerën prej 604.534 lekë, për pagim page në favor të ish punonjësit Mark Lleshi. Sipas titulli ekzekutiv të zyrës së përmbartimit, DPSHTRR detyrohet të dëmshpërblejë paditësin me pagën e 6 muajve, respektivisht dy muaj me pagën 47.850 lekë dhe 4 muaj me pagën 50.400 lekë dhe taksën 7 %, gjithsej në vlerën 562.217 lekë.



Nga kontrolli i dokumentacionit bashkëlidhur urdhër bllokimit të Zyrës së Përmbarimit Tiranë rezulton se, detyrimet për 6 muaj të llogaritura respektivisht 2 muaj me pagën 47.850 lekë dhe 4 muaj me pagën 50.400 lekë së bashku me taksën 7 %, janë të barabarta me vlerën 318.111 lekë $\{(2 \times 47.850 + 4 \times 50.400) \times 7 \%\}$. Pra, sipas kësaj llogaritje, DPSHTRr duhej të paguante detyrimin ndaj z. Mark Lleshi në vlerën prej 318.111 lekë dhe jo 562.217 lekë. Si rrjedhojë e këtij veprimi z. Mark Lleshi ka përfituar më tepër vlerën prej **244.106 lekë** (562.217-318.111).

5. Nga kontrolli i ushtruar në pagesat e bankës për likuidimin e faturës për zbatimin e kontratës për blerje të autovecurës për tenderin e zhvilluar, u konstatuan këto mangësi:

Në tenderin e zhvilluar për blerje autovecurë është shpallur fituese shoqëria "Noti", më të cilën është lidhur kontrata nr. 7630 Prot, datë 04.11.2008, për blerjen e 1 autovecurë me vlerë 4 632 000 lekë me TVSH. Afati kësaj kontrate është 30 ditë nga momenti i lidhjes së kontratës. Sipas kërkesës së DPSHTRR për transaksion të drejtuar BKT, rezulton se në datën 03.12.2008, është xhiruar në favor të shoqërisë "Noti" shpk shuma prej 4 632 000 lekë, në llogarinë numër 409083390.

Nga verikimi i dokumentacionit bashkëlidhur urdhër pagesës, rezulton se, dorëzimi i mallit nuk është shoqëruar me:

- Certifikatën e origjinës, në vend të saj në dosje janë disa printime të cilat nuk përfaqësojnë për mall në porosi të shoqërisë "Noti" si dhe nuk ka kontratë porosie midis shoqërisë "Noti" dhe kompanisë Volkswagen Gjermani;

- Nuk ka librezë të garancisë nga vetë firma prodhuese, por autoriteti kontraktor është mjaftuar me një dokument të lëshuar nga shoqëria "Noti" në lidhje me garancinë e automjetit;

- Nuk ka katalogë për mjetin e furnizuar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 4 të kontratës "Kushtet e lëvrimit" ku cilësohet se, kontraktuesi duhet ta shoqërojë mallin me: Katalog, faturë tatimore, certifikatë të origjinës, librezë të garancisë dhe dokumentet e targimit, për të cilat mbajnë përgjegjësi komisioni i përbërë nga Lekë Gjoni, Genci Stergu dhe Ilir Gjelishti, komision i ngritur me urdhrin nr. 670, datë 04.11.2008 për monitorimin dhe realizimin e kontratës.

Sipas "Deklaratës doganore" bashkëlidhur urdhër pagesës, rezulton se prodhuesi "VW AG Gjermani" ja ka shitur automjetin tip VW Touareg blerësit (importuesit) "Classic" dhe jo shoqërisë "Noti" e cila është shpallur fituese në këtë tender.

b. Prodhimi, furnizimi, dokumentimi dhe kontabilizimi i pullave të taksës nëpërmjet veprimeve të arkës.

Pullat e taksës janë prodhuar për çdo vit me procedurë prokurimi "tender i hapur" dhe janë kontabilizuar në llogarinë 5321 "Pulla tatimore dhe postare", dhe



shpërndarja e tyre në njësitë vartëse është bare në llogarinë “marrëdhënie me njësitë vartëse”.

c. Evidentimi i mallrave dhe materialeve në magazinë, kontabilizimi i tyre, mbajtja e kartelave dyfishe dhe rakordimi me zyrën e financës.

Kontabilizimi i mallrave në magazinë është bërë konform planit kontabël, daljet nga magazinë janë shoqëruar me urdhra dorëzimi.

d. Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave.

Inventarizimi i pronës shtetërore është kryer për çdo vit, me urdhër të titullarit konform ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”. Për vitin 2008 është kryer me urdhrin nr. 747, datë 15.12.2008 për Aktivet e qëndrueshme, vlerat materiale në magazinë dhe inventarin në përdorim nga punonjësit. Në përfundim të inventarëve nuk kanë rezultuar diferenca.

e. Gjendja e mallrave stok e me qarkullim të ngadalshëm, shkaqet e krijimit dhe masat e mara për evadimin e tyre.

Nga kontrolli i kryer në inventarin e magazinës u konstatua se, në magazinë nuk ka mallra dhe materiale stok apo me qarkullim të ngadalshëm, pasi blerjet janë kryer sipas nevojave dhe programit për periudhën objekt kontrolli.

5. Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit.

- Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit sipas planit unik kontabël për institucionet. Kontroll i veprimeve kontabël të regjistruar në ditarët e shpenzimeve të konstatuara.

Kontabiliteti në Drejtorinë e përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor mbahet i kompjuterizuar sipas programit ALPHA. Regjistrimet në ditarët e veprimtarisë ekonomike janë kryer konform planit unik kontabël për ndërmarrjet. Kontabilizimi është bazuar në të dhënat e dokumentave bazë si urdhërpagesa, fletë hyrje, fletë dalje dhe dokumenta të tjera ligjore.

- Nxjerrja e pasqyrave financiare në afat, plotësimi i formularë të bilancit dhe i anekseve përkatës sipas udhëzimeve të lëshuara nga Ministria e Financave për këtë qëllim.

Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, është e organizuar në 13 njësi vartëse, nga të cilat 12 janë ndërmarrje shërbimi dhe një është ndërmarrje prodhimi. Të gjitha njësitë vartëse janë të organizuara me bilanc dhe rezultat ekonomiko-financiare të veçantë. Në fund të çdo viti ushtrimor një kopje të bilancit e paraqesin në Degën e tatim taksave të rrethit përkatës dhe një kopje e paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme e cila harton bilancin përmbledhës të veprimtarisë së përgjithshme.

Bilancet kontabël të viteve 2007 dhe 2008 kanë dalë brenda afatit të përcaktuar dispozitat ligjore për ndërmarrjet shtetërore. Sipas ligjit 7582, datë 11.07.1992 me ndryshimet “Për ndërmarrjet shtetërore” është kryer auditimi i llogarive dhe i saktësisë së bilanceve kontabël nga ekspertët kontabël të autorizuar



ANEXI 2 Pasqyrat financiare të vitit 2008 të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor

miratuar nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, të cilët kanë dhënë opinion se: *"Pasqyrat financiare të vitit 2008, sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe paraqesin me vërtetësi të dhënat e nevojshme për vendimmarrje, transaksionet dhe ngjarjet janë trajtuar në përputhje me metodat kontabël"*.

Fitimi para tatimit, për aktivitetin ekonomiko-financiar të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor është llogaritur drejt. Në llogaritjen e fitimit para tatimit nuk janë njohur shpenzimet në vlerën prej 22.867 mijë lekë konform ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar dhe Udhëzimin e ministrit të financave nr. 3, datë 11.02.2002 "Për tatimin mbi të ardhurat", pika 3.6.

Mbi llogaritjen e fitimit

Të ardhurat e vitit 2008	1.652.565 mijë lekë
Shpenzimet	1.066.767 mijë lekë
Fitimi para tatimit	585.797 mijë lekë
Shpenzime të pa zbritëshme	22.867 mijë lekë
Tatim fitimi i llogaritur për t'u derdhur	60.866 mijë lekë

Shpenzimet e pazbritëshme janë evidentuar dhe llogaritur për tatimin mbi fitimin që duhet të derdhet në buxhet.

Nga kontrolli i ushtruar për saktësinë e të dhënave të llogarive sintetike dhe analitike u konstatua se, ditarët e veprimtarisë financiare kanë pasqyruar kronologjikisht dhe në mënyrë të saktë të dhënat sipas dokumentave bazë të regjistrimit. Llogaritë sintetike të bilancit kontabël përfaqësojnë realisht mbetjet e llogarive sipas librit të madh. Llogaritë sintetike janë të kuadruara me ato analitike.

Llogaritë e bilancit kontabël përmbledhës pasqyrojnë në mënyrë të saktë llogaritë respektive të bilanceve të njëjësive vartëse. Nga kontrolli me zgjedhje i kryer për llogaritë e mjeteve monetare, debitorëve dhe kreditorëve nuk u konstatuan diferenca në bilancin përmbledhës me ato të pasqyruara nga njësitë vartëse. Sipas bilancit kontabël të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor në përfundim të vitit ushtrimor të vitit 2008 të ardhurat në total janë realizuar në masën 1.653.565 mijë lekë, shpenzimet janë realizuar në masën 1.066.767 mijë lekë, fitimi bruto para tatimit është realizuar 585.797 mijë lekë.

Pozitiv është fakti se shpenzimet nga 1.135.643 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në masën 1.066.767 mijë lekë, ose 94 % të shpenzimeve të planifikuara.

Gjatë vitit 2008, Këshilli Drejtues me vendimin nr. 55, datë 29.05.2008 ka miratuar bilancin kontabël dhe pasqyrat financiare të veprimtarisë ekonomiko-financiare të vitit 2007. Fitimi neto i realizuar në vitin 2007 është ndarë respektivisht sipas neneve 10, 11, 12 dhe 13 të ligjit nr. 7582, datë 13.07.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", e konkretisht rezervë ligjore në masën 5 %, rezervë për zhvillim në masën 75 %, rezervë për shpërblime suplementare 15 % dhe rezerva të tjera për ndihma dhe shpenzime sociale në masën 5 %.



Evadimi, dokumentimi dhe kuadrimi i debi- kredive.

Debi kreditë janë të pasqyruara saktë në evidencën kontabël. Ato janë të kuadruara me treguesit e paraqitur në bilancin e vitit 2008 dhe me partitarët përkatës.

7. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave që krijon institucioni.

a. *Parashikimi, i të ardhurave që krijohen sipas ligjit nr. 8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nga dhe njësitë vartës:*

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor është krijuar me VKM nr. 343, datë 21.07.1999, e cila ka status juridik "Ndërmarrje Shtetërore me vetëfinancim" dhe ka për objekt:

- Regjistrimi i mjeteve, pajisja e tyre me leje qarkullimi, targa, regjistrimi i pronarëve dhe pajisja me certifikata pronësie;
- Kualifikimi dhe pajisja e drejtuesve të mjeteve me leje drejtimi;
- Kontrolli teknik i detyrueshëm i mjeteve ruge;
- Krijimi i regjistrit kombëtar të mjeteve dhe drejtuesve të tyre;
- Organizimi për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit bazë për transportin rrugor;
- Kryerja e veprimtarisë së "agjentit tatimor", sipas përcaktimeve ligjore;
- Dhënia e lejeve të veprimtarisë së autoshkollave; etj.

Sipas të dhënave që disponon Drejtoria Ekonomike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, për periudhën nga viti 1995 deri më 30.09.2009, DPSHTRR ka regjistruar gjithsej 391.725 mjete. Për periudhën objekt kontrolli 01.01.2008 deri në datën 31.09.2009, paraqitja e mjeteve të regjistruara dhe që paguajnë detyrimet paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Drejtoria Rajonale	Viti 2008			Viti 2009			
		Mjete në inventar	Mjete që kanë paguar taksat	Mjete që nuk kanë paguar taksat	Mjete në inventar 30.09.09	Mjete që kanë paguar taksat	Mjete që nuk kanë paguar taksat	% ndaj totalit të mjeteve
1	Tiranë	135 799	91 122	44 677	141711	71060	70.651	49
2	Korçë	20 761	12 671	8 090	21336	10037	11.299	53
3	Elbasan	23 974	14 547	9 427	24119	11245	12.874	53
4	Luç	14 741	8 150	6 591	15123	6166	8.957	59
5	Gjirokastrë	19 055	11 523	7 532	19296	9035	10.261	53
6	Berat	15 450	9 486	5 964	16011	7452	8.559	53
7	Fier	36 624	23 651	12 973	37424	18431	18.993	50
8	Shkodër	29 927	16 738	13 189	30674	12956	17.718	57
9	Durrës	48 449	27 391	21 058	49698	21081	28.617	57
10	Dibër	6 786	3 368	3 418	7035	2667	4.368	62
11	Kukës	4 255	2 224	2 031	4425	1784	2.641	59
12	Vlorë	22 869	12 429	10 440	24873	9756	15.117	60
	Totali	378 060	233 300	144 760	391 725	181670	210 055	53



Nga tabela e mësipërme rezulton se, për vitin 2008 nuk janë paraqitur dhe nuk paguajnë detyrimet fiskale 144.760 mjete ose 38 përqind e totalit të mjeteve të regjistruara. Për vitin 2009, nuk janë paraqitur për kontrollin periodik të radhës 210.055 mjete ose më tepër se viti i kaluar 65.295 mjete.(53 % më tepër).

Sipas tabelës, gjatë vitit 2008, nga 378.060 mjete të regjistruara (në inventar), janë paraqitur në kontrollin periodik dhe kanë paguar detyrimet që rrjedhin nga taksat vetëm 233.300 automjete, nga të cilat është arkëtuar dhe derdhur në buxhet vlera prej 3.886.478 mijë lekë, nuk janë paraqitur në kontrollin periodik, të radhës gjithsej 144.760 mjete ose 38, 2 % e mjeteve të regjistruara dhe që janë në inventarin e Drejtorisë së Përgjithshme.

Si rrjedhojë e mosparaqitjes për kontrollin periodik të mjeteve, buxhetit të shtetit i është shkaktuar evazion fiskal dhe të ardhura të munguara në vlerën prej rreth **2 111 694 840 lekë** $\{(3.886.478 \text{ mijë lekë} : 233.300 \text{ numri i mjeteve që paguajnë taksën} * 144.760 \text{ numri i mjeteve që nuk paguajnë taksën} - 126 760 \text{ mjete pas faljes së detyrimeve})$.

Po kështu, edhe për të ardhurat që rrjedhin nga kalimi i mjeteve në favor të buxhetit të njësisë të qeverisjes vendore, rezulton se për vitin 2008, janë shkaktuar të ardhura të munguara në vlerën prej **367 730 760 lekë** $(676 867 \text{ mijë lekë, vlera e arkëtuar nga taksa e regjistrimit /pjesëtuar me numrin e mjeteve që paguajnë taksën} * \text{me numrin e mjeteve që nuk paguajnë taksa})$.

Për 9/mujorin e vitit 2009, si rrjedhojë e mosparaqitjes për kontrollin periodik të mjeteve, buxhetit të shtetit i është shkaktuar evazion fiskal dhe të ardhura të munguara në vlerën prej rreth **3 342 605 mijë lekë** $\{(2 890 928 \text{ mijë lekë} : 181 670 \text{ numri i mjeteve që paguajnë taksën} * 210 055 \text{ mjete numri i mjeteve që nuk paguajnë taksën})$.

Po kështu edhe për të ardhurat që rrjedhin nga kalimi i mjeteve në favor të buxhetit të njësisë të qeverisjes vendore, rezulton se për periudhën 9 mujore të vitit 2009, janë shkaktuar të ardhura të munguara në vlerën prej **610 629 885 lekë** $(528 098 \text{ mijë lekë, vlera e arkëtuar nga taksa e regjistrimit /pjesëtuar me numrin e mjeteve që paguajnë taksën} * \text{me numrin e mjeteve që nuk paguajnë taksa})$.

Në bazë të të dhënave të arkivës së DPSHTRR, rezulton se mjete të regjistruara në arkiv, mjete që kanë kryer dhe nuk kanë kryer kontrollet teknike vjetore dhe periodike për vitin 2008 dhe 9/mujorin e vitit 2009, janë sipas tabelës së mëposhtme :

Emërtimi	Viti 2008			Periudha 9 mujore e vitit 2009		
	Mjete në inventar (31.12.2008)	Mjete që kanë kryer KTV dhe KTP deri më 31.12.2008	Mjete që nuk kanë kryer KTV dhe KTP deri më 31.12.2008	Mjete në inventar 30.09.2009	Mjete që kanë kryer KTV dhe KTP deri më 30.09.2009	Mjete që nuk kanë kryer KTV
DPSHTRR	378 060	200 421	177 639	391 725	158 129	233 596



Nga tabela c mësipërme rezulton se për vitin 2008 janë paraqitur dhe kanë kryer kontrollin teknik 200.421 mjete nga arkëtimi i tarifës për kontrollin teknik janë realizuar të ardhura në vlerën prej 290 491 mije leke.

Sipas evidencës së kontrollit teknik për vitin 2008 nuk janë paraqitur për kontrollin teknik të radhës 177.639 mjete, e për rrjedhojë nuk janë arkëtuar të ardhura nga ky shërbim në vlerën **257.398.911 lekë** (290.491 vlera e arkëtuar nga kontrolli teknik : 200.421 mjete që kanë kryer kontroll * 177 639 mjete që nuk kanë kryer kontroll teknik). Mos paraqitja dhe mos kontrolli periodik vjetor nga njëra anë jo vetëm që sjell të ardhura të munguara për Drejtorinë e Përgjithshme por edhe mungesë koordinimi të punës midis Drejtorisë së Përgjithshme me Policinë Rrugore pasi përbën burim edhe për aksidente

Për periudhën 9 mujore të vitit 2009, sipas evidencës rezulton se nuk janë paraqitur për kontrollin teknik periodik të radhës gjithsej 233.596 mjete, ose krahasuar me vitin e mëparshëm mjetet që nuk paraqiten për kontroll janë 31 % më tepër. Si rrjedhojë e mosparaqitjes së mjeteve për kontrollin periodik të radhës, nga ky shërbim nuk janë arkëtuar të ardhura në vlerën **314 420 216 lekë** (212 807 mije vlera e arkëtuar nga kontrolli teknik : 158 129 mjete që kanë kryer kontroll * 233 596 mjete që nuk kanë kryer kontrollin teknik periodik)

Si konkluzion, ndër disa shkaqe të mosparaqitjes së mjeteve për kryerjen e kontrollit periodik të radhës, përmendim:

-Mjetet e dala jashtë përdorimit dhe të grumbulluara në qendrat e grumbullimit të automjeteve (varreza);

-Mjetet që qarkullojnë në zonat rurale të vendit dhe nuk paraqiten në drejtoritë rajonale të DPSHTRR për të kryer shërbime apo kontrole vjetore teknike;

-Mjete të cilat kanë dalë përkohësisht jashtë qarkullimit (në përdorim nga personat emigrantë).

DPSHTRR në zbatim të ligjit nr.9986, datë 11.09.2008 "Për faljen e detyrimeve doganore dhe tatimore, të detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve e të taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve si dhe të gjobave e kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore" ka çelur regjistrin pasiv të mjeteve në të cilin janë evidentuar **126 760 mjete**, e barabartë kjo me rreth 45,6% të regjistrit aktiv të mjeteve. Zbatimi i ligjit nr.9986, datë 11.09.2008 dhe VKM nr.1398, datë 17.10.2008 "Për faljen e detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve e të taksës së regjistrimit të përvitshëm të tyre" nuk ka dhënë rezultatin e parashikuar pasi:

-Shumë pronarë të mjeteve subjekteve private dhe shtetërore nuk kanë pasur dijeni për afatin e zbatimit të VKM nr.1398, datë 17.10.2008 "Për faljen e detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve e të taksës së regjistrimit të përvitshëm të tyre".



- Një numër i madh mjeteve të cilat nuk kanë shlyer detyrimet për taksën e qarkullimit dhe të regjistrimit, janë në pronësi të emigrantëve shqiptarë për të cilët periudha e përcaktuar në ligj ka qene e papërshtatshme nga 07.11.2008 deri më 07.04.2009, pra nuk ka lidhje me periudhën kur emigrantët vijnë në Shqipëri për pushime.

- Një numër i madh mjeteve nuk janë ç'regjistruar, pasi janë të denoncuar në prokurori dhe prokuroria nuk është prononcuar prej vitesh për ecurinë e këtyre mjeteve. Po kështu prej shumë kohësh ka mjete të bllokuara nga zyra e përmbarimit dhe nga Ministria e Rendit, për të cilat nuk është informuar Drejtoria e Përgjithshme.

DPSHTRR ka zbatuar ligjin nr.9986, datë 11.09.2008 dhe VKM nr.1398, datë 17.10.2008 për të minimizuar sa më shumë arkivën pasive të mjeteve rrugore, pronarët e të cilëve kishin vite pa paguar taksat. Si rrjedhojë e zbatimit të ligjit dhe VKM së mësipërme, numri i mjeteve të ç'regjistruara (të dala jashtë përdorimit) deri më datën 07.04.2009 është 10 776, pra kanë përfituar nga amnistia fiskale subjektet që disponojnë 54 074 mjete të cilat kapin vlerën 1 780 480 938 lekë.

Numri i mjeteve të cilat kanë paguar taksat e dy viteve të fundit dhe janë përsëri në regjistrin aktiv deri më datë 07.04.2009 është 7 224, pra kanë përfituar nga amnistia subjektet që zotërojnë 18 446 mjete në vlerën totale prej 532.131.310 lekë.

Mbi planifikimin e të ardhurave që krijohen nga DPSHTRr.

Drejtoria e Përgjithshme për vitin 2008 ka programuar të ardhurat sipas zërave të veçantë dhe konkretisht:

- Të ardhura nga regjistrimi i mjeteve	371 300 mijë lekë.
- Të ardhura nga lejet e drejtimit	525 300 " "
- Të ardhura nga kontrolli teknik (pa gjoba)	259 500 " "
- Të ardhura nga taksat gjithsej	318 543 " "
- Të ardhura nga biletat	4 000 " "
- Të ardhura të tjera	64 000 " "
Totali gjithsej	1 542 643 " "

Gjithashtu të ardhurat janë të programuara edhe për çdo drejtori rajonale dhe kërkohet realizimi i tyre periodik. Të ardhurat për vitin 2008 janë realizuar **1 647 996 mijë lekë** ose 106.83 %. Pesha specifike e të ardhurave sipas sektorëve të aktivitetit paraqitet si më poshtë:

- Regjistrimi i mjeteve	24.33 %
- Lejet e drejtimit	35.07 %
- Kontrolli teknik	17.63 %
- Taksat	18.00 %
- Bileta e të tjera	4.97 %

Për vitin 2009 të ardhurat janë programuar si më poshtë:

- Të ardhura nga regjistrimi i mjeteve	406 100 mijë lekë.
- Të ardhura nga lejet e drejtimit	626 700 " "



- Të ardhura nga kontrolli teknik (pa gjoba)	266 000	"	"
- Të ardhura nga taksat gjithsej	307 310	"	"
- Të ardhura të tjera	67 800	"	"
Totali gjithsej	1 673 910	"	"

Gjithashtu të ardhurat janë të programuara edhe për çdo drejtori rajonale dhe kërkohet realizimi i tyre periodik. Të ardhurat për periudhën 9 mujore të vitit 2009 janë programuar në vlerën **1 260 751 mijë lekë** dhe janë realizuar në vlerën **1 209 662 mijë lekë** ose 95.9 %. Pesha specifike e të ardhurave sipas sektorëve të aktivitetit paraqitet si më poshtë:

- Regjistrimi i mjeteve	26.87 %
- Lejet e drejtimit	33.57 %
- Kontrolli teknik	17.59 %
- Taksat	17.73 %
- Të tjera	4.24 %

Mbi kontrollin e kryer në disa Drejtori Rajonale

Drejtoria Rajonale Shkodër.

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër, është institucion shtetëror, me statusin e personit juridik publik, me vetëfinancim dhe kryen funksionin e saj mbështetur në legjislacionin ligjor që funksionon DPSHTRr-ja Tiranë.

Për vitin 2008 programi ekonomik financiar është miratuar me shkresën e DPSHTRr Tiranë nr. 659, datë 29.01.2008. Për vitin 2008 realizmi i treguesve financiar të programuar paraqitet në tabelën e më poshtme:

Në 000 lekë

Treguesit	Program i Vitit 2008	Realizimi i vitit 2008	% Realizim
Të ardhurat	89 390	103 615	115.9 %
Shpenzimet	53 521	52 692	98.5 %
Rezultati (bruto)	35 869	50 923	142 %

Nga të dhënat e tabelës rezulton se programimi i treguesve financiar për vitin 2008 se të ardhurat janë tejkaluar me 15.9 %, shpenzimet janë realizuar më pak me 1.5 % e si rrjedhim rezultati është realizuar me tejkalim me 42 %. Për vitin 2009 programi ekonomik financiar është miratuar me shkresën e DPSHTRr Tiranë nr. 450, datë 26.01.2009. Për 9 mujorin e vitit 2009 realizmi i treguesve financiar të programuar paraqitet në tabelën e më poshtme:

Në 000 lekë

Treguesit	Program i 9/m i vitit 2009	Realizimi 9/m i vitit 2009	% Realizim
Të ardhurat	78 420	73 600	93.85 %
Shpenzimet	47 808	43 130	90.22 %
Rezultati (bruto)	30 612	30 470	99.54 %



Nga të dhënat e më sipërme rezulton se treguesit e programuar nuk janë realizuar.

Në tabelën më poshtë paraqitet dinamika e programimit të treguesve kryesor financiar për dy vitet e fundit:

Në 000 lekë

Treguesit	Program i vitit 2008	Realizimi i vitit 2008	Programi i Vitit 2009
Të ardhurat	89 390	103 615	104 540
Shpenzimet	53 521	52 692	64 005
Rezultati (bruto)	35 869	50 923	40 535

Në hartimin e programit të vitit 2009 nuk është vlerësuar numri i mjeteve të regjistruara në inventarin e DPSHTRr, që duhet të paguajnë taksat sipas ligjit, dhe që përbëjnë edhe kapacitetin fiskal në përlllogariten e programimin e të ardhurave, kjo për shkak të amnistisë fiskale të parashikuar në ligjin nr. 9986, datë 11.09.2008 “Për faljen e detyrimeve doganore dhe tatimore, detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve dhe të taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve, si dhe të gjobave dhe kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore” dhe në VKM nr. 1398, datë 17.10.2008 “Për faljen e detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve dhe taksës së regjistrimit të përvitshëm të tyre”, në të cilin është parashikuar falja e detyrimeve të prapambetura dhe mundësia e ç’regjistrimit të mjeteve nga subjektet që i zotërojnë ato.

Zbatimi i ligjit dhe vendimit të cituar më sipër ka bërë që planifikimi i të ardhurave për vitin 2009 të ketë një rritje të vogël prej rreth 1 %. Shpenzimet e planifikuara janë rritur me 21.5 %, ndërsa rezultati financiar është programuar me rreth 20 % më pak se realizimi i vitit 2008.

Për periudhën janar – shtator 2008 dhe për të njëjtën periudhë të vitit 2009 dinamika e programimit të treguesve kryesorë paraqitet në tabelën më poshtëme:

Në 000 lekë

Treguesit	Realizim i 9/m 2008	Program i 9/m 2009	Realizimi 9/m 2009	% e rritjes të treguesve në programin
Të ardhurat	67 043	78 420	73 600	117 %
Shpenzimet	40 143	47 808	43 130	119 %
Rezultati (bruto)	26 900	30 612	30 470	114 %

Në të dhënat e tabelës së më sipërme rezulton se dinamika e programuar e treguesve është me rritje të ndjeshme e krahasuar me realizimin e të njëjtës periudhë të vitit 2008.

- Mbi zbatimin e kriterëve për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit me destinacion fondet për investime.



Programi i investimeve për vitin 2008 ishte 20 000 mijë lekë për ndërtimin e godinës dhe për vitin 2009 programi ishte 30 000 mijë lekë për të njëjtin qëllim. Nuk janë realizuar mbasi nuk është gjetur trualli i ndërtimit.

Mbi planifikimin e të ardhurave që krijon.

Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Shkodër për vitin 2008 ka programuar të ardhurat sipas zërave të veçantë dhe konkretisht:

- Të ardhura nga regjistrimi i mjeteve	23 000	mijë lekë.
- Të ardhura nga lejet e drejtimit	28 000	" "
- Të ardhura nga kontrolli teknik (pa gjoba)	18 000	" "
- Të ardhura nga taksat gjithsej	20 230	" "
- Të ardhura të tjera	160	" "
Totali gjithsej	89 390	" "

Të ardhurat për vitin 2008 janë realizuar **103 615 mijë lekë** ose 115.9 %. Pesha specifike e të ardhurave sipas sektorëve të aktivitetit paraqitet si më poshtë:

- Regjistrimi i mjeteve	26.81 %
- Lejet e drejtimit	36.09 %
- Kontrolli teknik	18.87 %
- Taksat	17.68 %
- Të tjera	0.55 %

Për vitin 2009 të ardhurat janë programuar si më poshtë:

- Të ardhura nga regjistrimi i mjeteve	27 500	mijë lekë.
- Të ardhura nga lejet e drejtimit	38 600	" "
- Të ardhura nga kontrolli teknik (pa gjoba)	18 100	" "
- Të ardhura nga taksat gjithsej	18 640	" "
- Të ardhura të tjera	800	" "
Totali gjithsej	104 540	" "

Të ardhurat për 9 mujorin e vitit 2009 janë programuar **78 420 mijë lekë** dhe janë realizuar **73 600 mijë lekë** ose 93.85 %. Pesha specifike e të ardhurave sipas sektorëve të aktivitetit paraqitet si më poshtë:

- Regjistrimi i mjeteve	25.93 %
- Lejet e drejtimit	34.14 %
- Kontrolli teknik	20.46 %
- Taksat	18.13 %
- Të tjera	1.34 %

Nga këto të dhëna rezulton se peshën më të madhe e zënë dy zërat e parë me mbi 60 %.

Drejtoria Rajonale Fier.

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Fier, është institucion shtetëror, me statusin e personit juridik publik, me vetëfinansim dhe kryen funksionin e saj mbështetur në legjislacionin ligjor që funksionon DPSHTRr-ja Tiranë. Për vitin 2008 programi ekonomik financiar është miratuar me shkresën e DPSHTRr-së Tiranë nr. 659, datë 29.01.2008.



Për vitin 2008 realizimi i treguesve financiar të programuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000 lekë

Treguesit	Programi i vitit 2008	Realizimi i vitit 2008	% e Realizimit
Të ardhurat	139 454	142 470	102.2 %
Shpenzimet	80 647	72 362	89.7 %
Rezultati (bruto)	58 807	70 108	119.2

Nga të dhënat e tabelës rezulton se realizimi i treguesve financiar për vitin 2008 është : të ardhurat janë realizuar me tejkalim për 2.2 %, shpenzimet janë realizuar më pak se plani e konkretisht 10.3 % e si rrjedhim rezultati financiar (fitimi) është realizuar me tejkalim me 19.2 %. Për vitin 2009 programi ekonomik financiar është miratuar me shkresën e DPSHTRr Tiranë nr. 450, datë 26.01.2009. Për 9 mujorin e vitit 2009 realizimi i treguesve financiar të programuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000 lekë

Treguesit	Program i 9/m 2009	Realizimi i 9/m 2009	% e Realizimit
Të ardhurat	110 358	104 827	95 %
Shpenzimet	66 413	61 282	92.3 %
Rezultati (bruto)	43 945	43 545	99.1 %

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se treguesit e programuar nuk janë realizuar. Në tabelën më poshtë paraqitet dinamika e programimit të treguesve kryesor financiar për dy vitet e fundit:

Në 000 lekë

Treguesit	Program i vitit 2008	Realizimi i vitit 2008	Programi i vitit 2009
Të ardhurat	139 454	142 470	145 750
Shpenzimet	80 647	72 362	88 440
Rezultati (bruto)	58 807	70 108	57 310

Në hartimin e programit të vitit 2009 nuk është vlerësuar numri i mjeteve të regjistruara në inventarin e DPSHTRr, të cilat duhet të paguajnë taksat sipas ligjit, që përbën edhe kapacitetin fiskal që duhet të përlllogariten e programohen si të ardhura; kjo për shkak të amnistisë fiskale të parashikuar në Ligjin nr. 9986, datë 11.09.2008 “Për faljen e detyrimeve doganore dhe tatimore, detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve dhe të taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve, si dhe të gjobave dhe kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore” dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1398, datë 17.10.2008 “ Për faljen e detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve dhe taksës së regjistrimit të përvitshëm të tyre”, në të cilin është parashikuar falja e detyrimeve të prapambetura dhe mundësia e çregjistrimit të mjeteve nga subjektet që i zotërojnë ato.

Zbatimi i ligjit dhe vendimit të cituar më sipër ka bërë që planifikimi i të ardhurave për vitin 2009 të jetë me një rritje të vogël prej rreth 2.3 %. Shpenzimet



RAPORTI I DËRHATËVE MBI ZBATIMIN E PROGRAMIT

c planifikuara janë rritur me 22.2 %, ndërsa rezultati financiar është programuar me 18.25 % më pak se realizimi i vitit 2008. Për periudhën Janar – Shtator 2008 e 2009 dinamika e programimit të treguesve kryesor paraqitet në tabelën më poshtë:

Në 000 lekë

Treguesit	Realizimi i 9/m 2008	Programi i 9/m 2009	Realizimi 9/m 2009	% e rritjes të treguesve në programin
Të ardhurat	102 273	110 358	104 827	107.9 %
Shpenzimet	49 325	66 413	61 282	134.6 %
Rezultati (bruto)	52 945	43 945	43 545	83 %

Në të dhënat e tabelës së më sipërme rezulton se dinamika e programuar e treguesve të ardhurave është rritur me 7.9 % ndërsa shpenzimet janë rritur me 34.6 % rritje e cila ka sjellë planifikimin e rezultatit financiar me humbje ose 17 % më pak se realizimi i të njëjtës periudhë të vitit 2008.

- Mbi zbatimin e kriterëve për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit me destinacion fondet për investime.

Programi i investimeve për vitin 2008 ishte 1 800 mijë lekë për sistemin e ngrohjes së godinës dhe për vitin 2009 programi ishte 1 000 mijë lekë për murr mbajtës të ndërtesës. Të dy investimet janë realizuar.

Mbi planifikimin e të ardhurave që krijon.

Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Fier për vitin 2008 ka programuar të ardhurat sipas zërave të veçantë dhe konkretisht:

- Të ardhura nga regjistrimi i mjeteve	31 000	mijë lekë.
- Të ardhura nga lejet e drejtimit	39 500	“ “
- Të ardhura nga kontrolli teknik (pa gjoba)	31 000	“ “
- Të ardhura nga taksat gjithsej	35 954	“ “
- Të ardhura të tjera	2 000	“ “
Totali gjithsej	139 454	“ “

Të ardhurat për vitin 2008 janë realizuar **142 470 mijë lekë** ose 102.2%.

Pesha specifike e të ardhurave sipas sektorëve të aktivitetit paraqitet si më poshtë:

- Regjistrimi i mjeteve	22.87 %
- Lejet e drejtimit	33.24 %
- Kontrolli teknik	18.50 %
- Taksat	22.17 %
- Gjoba	2.36 %
- Të tjera	0.86 %

Për vitin 2009 të ardhurat janë programuar si më poshtë:

- Të ardhura nga regjistrimi i mjeteve	33 000	mijë lekë.
--	--------	------------



- Të ardhura nga lejet e drejtimit	47 000	"	"
- Të ardhura nga kontrolli teknik (pa gjoba)	28 000	"	"
- Të ardhura nga taksat gjithsej	33 350	"	"
- Të ardhura të tjera	4 400	"	"
Totali gjithsej	145 750	"	"

Të ardhurat për 9 mujorin e vitit 2009 janë programuar **110 358 mijë lekë** dhe janë realizuar **104 827 mijë lekë** ose **95 %**.

Pesha specifike e të ardhurave të realizuara sipas sektorëve të aktivitetit paraqitet si më poshtë:

- Regjistrimi i mjeteve	23.58 %
- Lejet e drejtimit	31.51 %
- Kontrolli teknik	21.18 %
- Taksat	22.28 %
- Të tjera	1.45 %

Nga këto të dhëna rezulton se peshën më të madhe e zënë dy zërat e parë me mbi rreth 65 %.

Mbi parashikimin e të ardhurave.

Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria Rajonale Shërbimit Transportit Rrugor Fier, rezulton se për vitet objekt kontrolli 2008 – 9/mujori i vitit 2009 janë regjistruar 37 442 mjete, nga të cilat kanë kaluar kontrollin teknik dhe kanë paguar detyrimet për taksat 24 921 mjete dhe nuk kanë paguar detyrimet 12 521 mjete.

Për sa lart e shprehur më konkretisht po i referohemi tabelës së mëposhtme:

Nr	Drejtoria Rajonale	Mjete në inventar (31.12.08)	Mjete që paguajnë taksa deri më 31.12.08	Mjete që s'paguajnë taksa (31.12.08)	Mjete në inventar 30.09.09	Mjete që paguajnë taksa (30.09.09)	Mjete që s'paguajnë taksa (30.09.09)
	Fier	36 624	23 651	12 973	37 442	24 921	12 521

Referuar vlerës prej 349 934 mijë lekë të taksës së Qarkullimit, të kaluar në favor të buxhetit të shtetit, vlerës prej 54 782 mijë lekë të taksës së regjistrimit të mjeteve të kaluar në favor të buxhetit të njërive të qeverisjes vendore për 9/mujorin 2009, për 24 921 mjete që kanë paguar taksa, rezulton se, nga mosarkëtimi i detyrimeve për taksën vjetore të qarkullimit të automjeteve që Drejtoria Rajonale Fier ka në inventar, buxhetit të shtetit i janë shkaktuar të ardhura të munguara përafërsisht në vlerën 175 816 627 lekë (vlera e arkëtuar nga taksa e qarkullimit / numrin e mjeteve që paguajnë taksën) * me numrin e mjeteve që nuk paguajnë taksën prej 12 521 mjete dhe buxhetit të qeverisjes vendore një efekt i përlogaritur prej 27 524 038 lekë (vlera e arkëtuar nga taksa e regjistrimit prej 54 782 000 lekë/pjesëtuar me numrin e mjeteve shumëzuar me numrin e mjeteve që nuk paguajnë).



Në bazë të të dhënave të arkivës së Drejtorisë Rajonale Fier, rezulton se, mjete të regjistruara në arkiv, mjete që kanë kryer dhe nuk kanë kryer kontrollet teknike vjetore dhe periodike për vitin 2008 dhe 9/mujorin e vitit 2009, paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Drejtoria Rajonale	Mjete në inventar (31.12.2008)	Mjete që kanë kryer KTV dhe KTP deri më 31.12.2008	Mjete që nuk kanë kryer KTV dhe KTP deri më 31.12.2008	Mjete në inventar 30.09.2009	Mjete që kanë kryer KTV dhe KTP deri më 30.09.2009	Mjete që nuk kanë kryer KTV dhe KTP deri më 30.09.2009
	Fier	36 624	29 205	7 419	37 442	17 565	19 877

Referuar vlerës prej 22 199 mije leke të pagesës së kontrolleve teknike vjetore dhe periodike të mjeteve për 9/mujorin 2009, për 17 565 mjete që kanë kryer kontrollet, rezulton mosarkëtimi i detyrimeve, i përlllogaritur afërsisht në vlerën 25 120 950 lekë (vlera e arkëtuar nga kontrolli teknik / numrin e mjeteve që kanë kryer kontroll) * me numrin e mjeteve që nuk kanë kryer kontroll prej 19 877 mjete.

Kontroll në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Shkodër.

Parashikimi i prokurimeve dhe realizimi i tyre për vitet 2008 – 2009.

Për vitin 2008: Me shkresën nr.1277, datë 21.02.2008, DPSHTRR, ka dërguar regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike, në Agjencinë e Prokurimit Publik. Sipas këtij regjistri drejtoria ka parashikuar kryerjen e 4 procedurave të prokurimit nga drejtoria Rajonale Shkodër, ku midis të tjerave “Blerje kancelari”, “Karburant”, “Ruajtja me roje private” dhe “Blerje materiale” me një fond të planifikuar prej 8 616 mijë lekë, ku ka përzgjedhur një procedurë të hapur dhe 3 procedura “Kërkesë për propozim”.

Sipas shkresës nr.74, datë 09.02.2009, DRSHTRR Shkodër ka bërë përcjelljen e regjistrit të Prokurimeve Publike pranë DPSHTRR.

Me shkresën nr.22, datë 10.01.2009, DPSHTRR ka dërguar në APP regjistrin e realizimit të prokurimeve publike, ku nga 7 procedura prokurimi të planifikuara, në këtë regjister janë realizuar 4 procedura.

Me shkresën nr.1091, datë 18.02.2009, DPSHTRR, ka dërguar regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike, në Agjencinë e Prokurimit Publik. Sipas këtij regjistri drejtoria ka parashikuar kryerjen e 3 procedurave të prokurimit nga drejtoria Rajonale Shkodër, ku midis të tjerave “Karburant”, “Ruajtja me roje private” dhe “Qira objekti” me një fond të planifikuar prej 6 600 mijë lekë, ku ka përzgjedhur një procedurë të hapur dhe 2 procedura “Kërkesë për propozim”.

Për periudhën objekt kontrolli 2008 – 9/mujori 2009, rezulton se nga DRSHTRR Shkodër, është mbajtur rregullisht regjistri i parashikimeve dhe realizimit të prokurimeve publike dhe është dërguar në DPSHTRR, konform dispozitave ligjore për prokurimin publik.



Mbi parashikimin e të ardhurave.

Nga dokumentacioni pranë DRSHTRR Shkodër rezulton se është punuar në zbatim të ligjit nr. 7726, datë 29.06.1993 "Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij si dhe nenit 220 të Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë".

Në bazë të të dhënave të arkivës së Drejtorisë Rajonale Shkodër rezulton se mjete të regjistruara në arkiv, mjete që paguajnë taksa dhe mjete që s'paguajnë taksa për vitin 2008 dhe 9/mujorin e vitit 2009, janë sipas tabelës së mëposhtme:


Nr	Drejtoria Rajonale	Mjete në inventar (31.12.08)	Mjete që kanë paguar taksa 31.12.08	Mjete që s'paguajnë taksa 31.12.08	Mjete në inventar 30.09.09	Mjete që paguajnë taksa 30.09.09	Mjete që s'paguajnë taksa 30.09.09
	Shkodër	29.297	16.738	12.559	30.764	12.793	17.971

Në zbatim të Ligjit nr.9986, datë 11.09.2008 "Për faljen e detyrimeve doganore dhe tatimore, të detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve e të taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve si dhe të gjobave e kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore" si dhe VKM nr.1398, datë 17.10.2008 "Për faljen e detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve e të taksës së regjistrimit të përvitshëm të tyre" nga mjetet e regjistruara në Drejtorinë Rajonale Shkodër, kanë përfituar gjithsej 966 mjete nga të cilat janë çregjistruar në mënyrë përfundimtare 540 dhe kanë përfituar duke u rivënë në qarkullim 426 mjete.

Nga verifikimi i dokumentacionit të marrë nga Drejtoria Rajonale Shkodër, regjistrimi i mjeteve deri më 30.09.2009 rezulton në shumën **30.764** mjete, 12.793 mjete që kanë kryer shërbime dhe 17 971 mjete nuk kryejnë shërbime pranë kësaj drejtorie Rajonale, pra nuk paguajnë taksa dhe nuk kalojnë në kontrollin teknik.

Referuar vlerës prej 243.173 mije leke, për taksën e Qarkullimit, për vitin 2008 dhe 182.536 mije leke për periudhën Janar – Shtator 2009, të kaluar në favor të buxhetit të shtetit, rezulton se nga mosarkëtimi i detyrimeve për taksën vjetore të qarkullimit të automjeteve që DR Shkodër ka në inventar, buxhetit të shtetit i është shkaktuar një efekt i përlogaritur afërsisht në vlerën **182 459 664 lekë për vitin 2008** (vlera e arkëtuar nga taksa e qarkullimit / numrin e mjeteve që paguajnë taksën* shumëzuar me numrin e mjeteve që nuk paguajnë taksën) dhe **256.417.956 lekë për 9/mujorin 2009**.

Referuar vlerës prej 43.985 mije lekë të taksës së regjistrimit të mjeteve të kaluar në favor të buxhetit të njërive të qeverisjes vendore për vitin 2008 dhe vlerës prej 33.645 mije leke për periudhën Janar – Shtator 2009, rezulton se buxhetit të qeverisjes vendore i është shkaktuar një efekt i përlogaritur prej **58.620.983 lekë për vitin 2008**(vlera e arkëtuar nga taksa e regjistrimit/pjesëtuar me numrin e mjeteve që kanë paguar taksën * me numrin e mjeteve që nuk paguajnë) dhe **47 263 011 lekë për 9/mujorin e vitit 2009**.



Në bazë të të dhënave të arkivës së drejtorisë rajonale Shkodër rezultojnë se mjete të regjistruara në arkiv, mjete që kanë kryer dhe nuk kanë kryer kontrollet teknike vjetore dhe periodike për vitin 2008 dhe 9/mujorin e vitit 2009, janë sipas tabelës së mëposhtme :

Nr	Drejtoria Rajonale	Mjete në inventar (31.12.2008)	Mjete që kanë kryer KTV dhe KTP deri më 31.12.2008	Mjete që nuk kanë kryer KTV dhe KTP deri më 31.12.2008	Mjete në inventar 30.09.2009	Mjete që kanë kryer KTV dhe KTP deri më 30.09.2009	Mjete që nuk kanë kryer KTV dhe KTP deri më 30.09.2009
	Shkodër	29.297	15.835	13.442	30.764	12.037	18.727

Referuar vlerës prej 16.329 mije lekë të pagesës së kontrolleve teknike vjetore dhe periodike të mjeteve për vitin 2008 dhe 12.406 mije leke për 9/mujorin 2009, rezultojnë mosarkëtimi i detyrimeve, i përlogaritur afërsisht në vlerën **13.843.916 lekë** për vitin 2008 (vlera e arkëtuar nga kontrolli teknik / numrin e mjeteve që kanë kryer kontroll * me numrin e mjeteve që nuk kanë kryer kontroll) dhe **19.301.170 lekë** për 9/mujorin e vitit 2009.

Drejtoria Rajonale Dibër.

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Dibër, është institucion shtetëror, me statusin e personit juridik publik, me vetëfinancim dhe kryen funksionin e saj mbështetur në legjislacionin ligjor që funksionon DPSHTRr Tiranë. Për vitin 2008 programi ekonomik financiar është miratuar me shkresën e DPSHTRr Tiranë nr. 659, datë 29.01.2008.

Për vitin 2008 realizimi i treguesve financiar të programuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000 lekë			
Treguesit	Program i vitit 2008	Realizimi i vitit 2008	% Realizimit
Të ardhurat	27 278	31 586	115.8 %
Shpenzimet	25 481	25 826	101.3 %
Rezultati (bruto)	1 797	5 760	320.5 %

Nga të dhënat e tabelës rezultojnë se realizimi i treguesve financiar për vitin 2008 është: të ardhurat janë realizuar me tejkalim për 15.8 %, shpenzimet janë realizuar me tejkalim për 1.3 % e si rrjedhim rezultati financiar (fitimi) është realizuar me tejkalim me 320.5 %. Për vitin 2009 programi ekonomik financiar është miratuar me shkresën e DPSHTRr Tiranë nr. 450, datë 26.01.2009.

Për 9 mujorin e vitit 2009 realizimi i treguesve financiar të programuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000 lekë			
Treguesit	Programi i 9/m 2009	Realizimi 9/m 2009	% Realizim
Të ardhurat	23 319	24 600	105.5 %
Shpenzimet	25 264	19 700	78 %
Rezultati (bruto)	- 1 945	4 900	684.5 %



Nga të dhënat e më sipërme rezulton se treguesit e programuar nuk janë realizuar. Në tabelën më poshtë paraqitet dinamika e programimit të treguesve kryesor financiar për dy vitet e fundit:

Në 000 lekë

Treguesit	Program i vitit 2008	Realizimi viti 2008	Programi i vitit 2009
Të ardhurat	27 278	31 586	31 090
Shpenzimet	25 481	25 826	33 876
Rezultati (bruto)	1797	5760	- 2 786

Në hartimin e programit të vitit 2009 nuk është vlerësuar numri i mjeteve të regjistruara në inventarin e DPSHTRr, të cilat duhet të paguajnë taksat sipas ligjit, që përbën edhe kapacitetin fiskal që duhet të përlllogariten e programohen si të ardhura; kjo për shkak të amnistisë fiskale të parashikuar në ligjin nr. 9986, datë 11.09.2008 "Për faljen e detyrimeve doganore dhe tatimore, detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve dhe të taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve, si dhe të gjobave dhe kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore" dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1398, datë 17.10.2008 "Për faljen e detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve dhe taksës së regjistrimit të përvitshëm të tyre", në të cilin është parashikuar falja e detyrimeve të prapambetura dhe mundësia e rregjistrimit të mjeteve nga subjektet që i zotërojnë ato.

Zbatimi i ligjit dhe vendimit të cituar më sipër ka bërë që planifikimi i të ardhurave për vitin 2009 të jetë me një ulje të vogël prej rreth 1.6 %. Shpenzimet e planifikuara janë rritur me 31.2 %, ndërsa rezultati financiar është programuar me rreth 3 herë më pak se realizimi i vitit 2008. Për periudhën janar– shtator 2008 dhe të njëjtën periudhë të vitit 2009 dinamika e programimit të treguesve kryesor paraqitet në tabelën e më poshtëme:

Në 000 lekë

Treguesit	Realizim i 9/m 2008	Program i 9/m 2009	Realizimi 9/m 2009	% e rritjes të treguesve
Të ardhurat	20 458	23 319	24 600	114 %
Shpenzimet	19 112	25 264	19 700	132.2 %
Rezultati (bruto)	1 346	- 1 945	4 900	

Në të dhënat e tabelës së më sipërme rezulton se dinamika e programuar e treguesve të ardhurave është rritur me 14 % ndërsa shpenzimet janë rritur me 32.2%, duke planifikuar në këtë mënyrë rezultatin financiar me humbje.

- Mbi zbatimin e kriterëve për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit me destinacion fondet për investime.

Programi i investimeve për vitin 2008 ishte 1 800 mijë lekë për sistemin e ngrohjes së godinës dhe për vitin 2009 programi ishte 1 000 mijë lekë për mur mbajtës të ndërtesës. Të dy investimet janë realizuar.



Mbi planifikimin e të ardhurave që krijon.

Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Dibër për vitin 2008 ka programuar të ardhurat sipas zërave të veçantë dhe konkretisht:

- Të ardhura nga regjistrimi i mjeteve	4 500	mijë lekë.
- Të ardhura nga lejet e drejtimit	12 000	" "
- Të ardhura nga kontrolli teknik (pa gjoba)	4 500	" "
- Të ardhura nga taksat gjithsej	6 178	" "
- Të ardhura të tjera	100	" "
Totali gjithsej	27 278	" "

Të ardhurat për vitin 2008 janë realizuar **31.586 mijë lekë** ose 115.8 %. Peshat specifike e të ardhurave sipas sektorëve të aktivitetit paraqitet si më poshtë:

- Regjistrimi i mjeteve	20.08 %
- Lejet e drejtimit	43.65 %
- Kontrolli teknik	16.01 %
- Taksat	19.27 %
- Të tjera	0.99 %

Për vitin 2009 të ardhurat janë programuar si më poshtë:

- Të ardhura nga regjistrimi i mjeteve	6 100	mijë lekë.
- Të ardhura nga lejet e drejtimit	14 200	" "
- Të ardhura nga kontrolli teknik (pa gjoba)	4 200	" "
- Të ardhura nga taksat gjithsej	5 890	" "
- Të ardhura të tjera	700	" "
Totali gjithsej	31 090	" "

Të ardhurat për 9 mujorin e vitit 2009 janë programuar **23.319 mijë lekë** dhe janë realizuar **24.600 mijë lekë** ose 105.5 %. Peshat specifike e të ardhurave të realizuara sipas sektorëve të aktivitetit paraqitet si më poshtë:

- Regjistrimi i mjeteve	16.10 %
- Lejet e drejtimit	48.84 %
- Kontrolli teknik	15.76 %
- Taksat	17.66 %
- Të tjera	1.64 %

Nga këto të dhëna rezulton se peshën më të madhe specifike e kanë dy zërat e parë me mbi rreth 65 %.

8. Prokurimi i fondeve publike për mallra ndërtim dhe shërbime.

Krijimi i njësisë së prokurimit për vitet 2008-9/mujori 2009

Për vitin 2007 njësia e prokurimit është krijuar me urdhrin e drejtorit nr.61, datë 13.02.2007, e cila ka funksionuar edhe për vitet 2008 dhe 2009 në përbërje të së cilës janë Albana Gjuzi, Adela Dani dhe Albana Miftari.

Për sa lart, struktura e njësisë së prokurimit nuk është krijuar që në fillim të vitit 2007, pasi bazuar në Kreun V "Zhvillimi i procedurave" të VKM nr.1, datë



10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pika 1/c, cilësohet "...njësia e prokurimit është përgjegjëse për hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike", regjistër i cili dorëzohet jo më vonë se data 20 janar, e cilësuar kjo në pikën 3/dh të Kreut I "Organizimi i prokurimit publik". Gjithashtu autoritetet kontraktore, përgatisin dhe dërgojnë një përmbledhje të regjistrit të prokurimit publik në APP dhe MF, pas miratimit të buxhetit, bazuar në pikën 3/b të VKM nr.1, datë 10.01.2007.

Parashikimi i prokurimeve dhe realizimi i tyre për vitet 2008 - 2009

Për vitin 2008, DPSHTRR me shkresën nr.1277, datë 21.02.2008 ka dërguar regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike, në Agjencinë e Prokurimit Publik. Sipas këtij regjistri drejtoria ka parashikuar kryerjen e 14 procedurave të prokurimit, me fond të planifikuar në vlerën prej 315 936 mijë lekë, përfshirë dhe TVSH^{ne}.

Me shkresën nr.321 datë 19.01.2008, DPSHTRR ka dërguar në APP regjistrin e realizimit të prokurimeve publike, ku nga 14 procedura prokurimi të planifikuara, në këtë regjistër janë realizuar 9 procedura me fond limit 149 578 mijë lekë me TVSH, fond i cili pas prokurimit është realizuar në shumën 126 352 mijë lekë. Për këtë vit nuk janë realizuar 4 procedura, nga të cilat "Makineri dhe pajisje për shtypshkronjën e DTSH" me fond limit 12.400 mijë lekë, "Rikonstruksioni i gjithë godinës së DPSHTRR" me fond limit 23.640 mijë lekë, "Godinë administrative Shkodër" me fond limit 19.344 mijë lekë dhe "Godinë administrative Berat" me fond limit 19.344 mijë lekë.

Në kryerjen e procedurave të prokurimit për këtë vit, autoriteti kontraktor bazuar në rregullat e prokurimit publik ka përzgjedhur procedurat e prokurimit, paraqitur sa më poshtë :

000/lekë				
Nr.	Emërtimi i procedurës	Nr. Tenderave	Fondi limit	Realizimi
1	"Tender i Hapur"	4	104033	81015
2	"Negocim pa shpallje"	1	45545	45337
	Totali	5	149 578	126 352

Për periudhën 9 mujore të vitit 2009, me shkresën nr.1091, datë 18.02.2009, DPSHTRR, ka dërguar regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike, në Agjencinë e Prokurimit Publik. Sipas këtij regjistri drejtoria ka parashikuar kryerjen e 14 procedurave të prokurimit, me një fond të planifikuar prej 144.876 mijë lekë, përfshirë dhe TVSH^{ne}.

Për periudhën 9 mujore të këtij viti, janë realizuar 6 procedura prokurimi me fond limit në shumën 41.107 mijë lekë, fond i cili është realizuar në shumën 37.021 mijë lekë. Për kryerjen e procedurave të prokurimit, autoriteti kontraktor bazuar në rregullat e prokurimit publik ka përzgjedhur procedurat e prokurimit, paraqitur si më poshtë:



000/lekë

Nr.	Emërtimi i procedurës	Nr. Tenderave	Fondi limit	Realizimi
1	"Tender i Hapur"	4	20291	16619
2	"Negocim pa shpallje"	1	19874	19872
3.	"Kërkesë për propozim"	1	942	530
	Totali	6	41107	37021

Për sa më lart për periudhën objekt kontrolli 2008 – 30.09.2009, DPSHTRR ka mbajtur rregullisht regjistrin e parashikimeve dhe të realizimit të prokurimeve publike dhe e ka dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik, konform dispozitave ligjore për prokurimin publik.

Zbatimi i procedurave të prokurimit, lidhja dhe zbatimi i kontratave.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, për periudhën objekt kontrolli, **2008 dhe 9/mujori 2009**, janë realizuar 15 procedura prokurimi me fond limit 190.685 mijë lekë, si dhe janë lidhur 15 kontrata me vlerë 163.373 mijë lekë, e shprehur më konkretisht sipas tabelës :

000/lekë

Nr	Vitet	Tenderët e zhvilluar	Fondi limit	Nr. kontratave	Vlera e kontratave
1	2008	9	149 578	9	126 352
2	9/mujori 2009	6	41 107	6	37 021
	Totali	15	190 685	15	163 373

Bazuar në programin e kontrollit të miratuar nga kryetari i KLSH^{se}, grupi i kontrollit, në auditivin e prokurimeve, ka kontrolluar me zgjedhje 5 procedura prokurimi, pasi të gjitha procedurat ishin kontrolluar më parë nga Drejtoria e Auditivit të MPPT&T për periudhën 01.04.2008 -31.03.2009 dhe ishin trajtuar në konkluzionet dhe Raportin Final të ministrisë, dërguar subjektit të kontrolluar me shkresën nr.1847/5, datë 06.07.2009.

Kontrolli për prokurimet me fonde publike në këtë institucion u krye në mbështetje të: ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" me ndryshimet përkatëse, VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe Dokumentat Standarde të tenderave.

Nga kontrolli i dosjeve, rezultoi se procedurat e prokurimit: "Blerje autoveture", "Shtesë zyrash, për arshivë, asfaltim sheshi, suvatim lysterje për QKT Gjirokastër" dhe "Blerje targa prokat për automjete" për vitin 2008 dhe "Blerje karburant" dhe "Blerje prokat leje drejtimi" për 9/mujorin e vitit 2009, ishin kryer konform legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.



***Mbi kontrollin e procedurave të prokurimit në disa Drejtori Rajonale
Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Fier***

a. Për vitin 2008, bazuar në urdhrin e drejtorit nr.1213, datë 05.03.2008, është krijuar njësi e prokurimit, në përbërje të së cilës janë znj. Juliana Muskaj juriste, Ervin Fejzulla dhe Lavdimir Hoxhaj.

Për sa lart, për vitin 2008, struktura e njësisë së prokurimit në DRSHTRR Fier, nuk është krijuar qysh në fillim të vitit, në kundërshtim me Kreun V "Zhvillimi i procedurave" të VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pika 1/c, ku cilësohet "...njësia e prokurimit është përgjegjëse për hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike", regjistër i cili dorëzohet jo më vonë se data 20 janar, e cilësuar kjo edhe në pikën 3/dh të Kreut I "Organizimi i prokurimit publik". Gjithashtu autoritetet kontraktore, përgatisin dhe dërgojnë një përmbledhje të regjistrit të prokurimit publik në APP dhe MF, pas miratimit të buxhetit, bazuar në pikën 3/b të VKM nr.1, datë 10.01.2007.

b. Për vitin 2009, bazuar në urdhrin nr.149, datë 12.01.2009 të titullarit Drejtoria Rajonale Shërbimit Transportit Rrugor Fier, ka krijuar njësinë e prokurimit, në përbërje të së cilës është znj. Juliana Muskaj juriste, Ervin Fejzulla dhe Anita Merkaj.

Parashikimi i prokurimeve dhe realizimi i tyre.

Për vitin 2008, me shkresën nr.783/1, datë 12.02.2008, Drejtoria Rajonale Fier ka dërguar regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike, në DPSHTRR. Sipas këtij regjistri nga Drejtoria Rajonale Fier në rolin e autoritetit kontraktor, janë parashikuar të kryen 3 procedura prokurimi, "Shtesë anësore sistemim sheshi, sistem elektrik, sistem ngrohje", "Blerje Karburant" dhe "Ruajtja me roje private" me një fond të planifikuar prej 29.950 mijë lekë. Për kryerjen e procedurave të mësipërme autoriteti kontraktor ka përzgjedhur 2 procedura të hapur dhe një procedurë "Kërkesë për propozim".

Me shkresën nr.44/1, datë 09.01.2009, DR Fier ka dërguar në DPSHTRR dhe në APP regjistrin e realizimit të prokurimeve publike, ku nga autoriteti kontraktor, janë realizuar 4 procedura prokurimi nga 3 të planifikuara, në këtë regjistër "Blerje Karburant" dhe "Ruajtja me roje private", ndërkohë që është raportuar edhe "Blerje autovetura" dhe "Shtesë anësore sistemim sheshi, sistem elektrik, sistem ngrohje" të cilat janë kryer si procedura por nuk janë financuar.

Me shkresën nr.1091, datë 18.02.2009, DPSHTRR, ka dërguar regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike, në Agjencinë e Prokurimit Publik. Sipas këtij regjistri drejtoria ka parashikuar kryerjen e 4 procedurave të prokurimit nga Drejtoria Rajonale Fier, ku midis të tjerave "Blerje Karburanti", "Ruajtja me roje private", "Blerje kancelari" dhe "Ndërtim muri rrethues" me një fond të planifikuar prej 9.900 mijë lekë.



Për kryerjen e procedurave autoriteti kontraktor ka përzgjedhur një procedurë të hapur dhe 3 procedura "Kërkesë për propozim". Për këtë vit nga kjo drejtori janë realizuar 5 procedura prokurimi nga 4 të planifikuara, duke shtuar në këtë mënyrë 1 procedurë për mobilim zyrash, në shumën 12 470 mijë lekë.

Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

1. Në tenderin e zhvilluar me objekt "Blerje autoveture", me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Kom. i vlerësimit të ofertave	Njësia HDT
U.Prok. nr.4545, datë 29.08.2008 F.Limit 7 528 mijë lekë pa TVSH Pr.Prok. "T.Hapur" Data e zhvillimit tenderit 09.10.2008 Firma fituese "Noti" shpk Data e lidhjes kontratës 15.12.2008 Vlera e kontratës 7 902 mijë lekë me TVSH	Kamber Vrapi Kryetar Dritan Guda Anëtar Shqiponja Hyskaj Anëtar Luan Muca Anëtar Matilda Cobo Anëtar	Juliana Muskaj Juriste Ervin Fejzulla Anëtar Lavdimir Hoxhaj Anëtar

Kontrata me shoqërinë "Noti" është lidhur më datë 15.12.2008, me vlerë 7 902 000 leke me TVSH, për 3 autovetura. Afati kësaj kontrate sipas nenit 4 "Kushtet e lëvrimit", është 30 ditë nga momenti i lidhjes së kontratës. Të gjitha shpenzimet për taksën doganore, transportin, sigurimin ngarkimin shkarkimin targimin do të jenë në ngarkim të kontraktuesit. Ngjyra e automjeteve është gri e erret. Nga kontrolli i dokumentacionit të bankës rezultoi, se në Alfa Bank më datë 10.04.2009 është xhiruar në favor të shoqërisë "Noti" shpk, vlera prej 7.902.000 lekë për blerjen e autoveturave me faturat tatimore nr. 8, 9 dhe 10 datë 06.03.2009 respektivisht për vlerat 2 634 000 lekë secila.

Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur urdhër pagesës rezulton se:

- Dorëzimi i mallit nuk është shoqëruar me Certifikatën e origjinës, por në dosje janë disa printime të cilat nuk përfaqësojnë për mall në porosi të shoqërisë "Noti" si dhe nuk ka kontratë porosie midis shoqërisë "Noti" dhe Volkswagen Gjermani.

- Nuk ka librezë të garancisë nga vetë firma prodhuese, por autoriteti kontraktor është mjaftuar me një dokument të lëshuar nga shoqëria "Noti" në lidhje me garancinë e automjetit

- Nuk ka katalogë që të shoqërojnë automjetin e furnizuar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 4 të kontratës "Kushtet e lëvrimit", ku cilësohet se kontraktuesi duhet ta shoqërojë mallin me: Katalog, faturë tatimore, certifikatë të origjinës, librezë të garancisë, dokumentet e targimit.

Nga dokumentacioni bashkëlidhur bankës "Deklarata doganore" rezulton se eksportuesi "VW AG Gjermani" ka eksportuar mallin në emër të "Classic"



(importuesi) pra jo në emër të shoqërisë "Noti" e cila nga dokumentacioni nuk rezulton të ketë porositur mall në Gjermani.

U shqyrtuan sqarimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i kontrolluar, të cilat u muarrën në konsideratë.

9. Vlerësimi i funksionimit të Auditimit të Brendshëm

Vlerësimi i veprimtarisë së auditivit të brendshëm u krye sipas këtyre drejtimeve:

- Mbi organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm publik në DPSHTRr, është e organizuar në nivel drejtoric, si strukturë në varësi Drejtorit të Përgjithshëm dhe Këshillit Drejtues, konform kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe VKM Nr. 345, datë 01.06.2004 "Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm", Kapitulli II/4.

Me shkresën e MPPTT nr. 4836/1 datë 09.07.2008, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, funksionin sipas organikës së përbërë nga 3 punonjës, nga të cilët; një Drejtor Drejtoric dhe 2 specialistë. Struktura sipas arsimit përbëhet, nga 2 punonjës me profesion ekonomist financë dhe 1 ekonomist industriale, të tre audituesit janë të certifikuar. Sipas kriterit të vjetërsisë së punës në strukturat e kontrollit dhe të auditimit, punonjësit grupohen; 1 punonjës deri në 5 vjet pune, 1 punonjës 5 - 10 vjet dhe 1 punonjës mbi 10 vjet.

- Hartimi i planeve të Auditimit të Brendshëm. Përgatitja dhe hartimi i programeve të auditimit, llojet e auditimit.

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm ka në vartësi gjithsej 14 subjekte, nga të cilat 12 Drejtori Rajonale.

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për vitin 2008 ka hartuar planin vjetor, i cili është miratuar nga Titullari me prot. nr. 7, datë 07.01.08 dhe nr. 7903 dt. 17.11.08, për ushtrimin e veprimtarisë audituese, në mbështetje të kërkesave të përcaktuara në zbatim të Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe VKM Nr. 345, datë 01.06.2004 "Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm", Kapitulli II/4.

Bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe VKM nr. 345, datë 01.06.2004 "Për miratimin



e manualit të procedurave të auditimit". Për periudhën objekt kontrolli fushat prioritare të auditimit dhe veprimtaria audituese është përqendruar kryesisht në:

- Programimin dhe kryerjen e auditimeve në bazë të planit të miratuar, duke ruajtur frekuencën e auditimit, vlerësimin e riskut dhe nivelin e materialitetit.
- Vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e tij.
- Auditimi në vazhdimësi i rekomandime të dhëna bazuar në planin për ndjekjen e tyre.

Prioritetet e drejtorisë së auditimit, në zbatim të kërkesave të ligjit për auditimin, kanë qenë auditimet e plota në subjekte, si auditime me efektivitet si dhe auditimet tematike me probleme që paraqiten në drejtimet:

- Auditimi i fondeve të miratuara, shpenzimet dhe të ardhurat e realizuara;
- Auditimi i realizimit të investimeve dhe realizimi i kontratave;
- Zbatimi i procedurave të prokurimit publik;
- Deklaratat financiare dhe bilanci kontabël;
- Administrimi i vlerave materiale e monetare;
- Zbatimi i tarifave dhe afateve të shërbimit, taksave të regjistrimit, qarkullimit dhe të lejeve të drejtimit, si dhe shërbimet e tjera që ofron DPSHTRr;
- Zbatimi i ligjeve, udhëzimeve e shkresave të nxjerra nga MPPTT apo DP në sektorët e shërbimit në drejtoritë rajonale.

Për vitin 2008 në planin e auditimit janë parashikuar 9 auditime të plota dhe 2 auditime tematike.

Frekuenca e auditimit është parashikuar konform VKM nr. 345, datë 01.06.2004 "Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm, kodit etik dhe të kartës së auditimit të brendshëm publik", sipas të cilit të gjitha objektet janë parashikuar për t'u kontrolluar dy herë në tre vjet.

Programet e auditimit janë hartuar në mënyrë të veçantë për çdo auditim dhe sipas veçorive të çdo objekti që i nënshtrohet auditimit.

Në programet e kontrollit është parashikuar;

- Auditimi i aktivitetit ekonomiko-financiar;
- Auditimi i Performancës;
- Auditimi i pajtueshmërisë, në të cilën janë parashikuar për t'u audituar investimet e kryera me fondet e ndërmarrjes, blerjet e mallrave, shërbimet dhe procedurat e prokurimit, auditimi i pasqyrave financiare, auditimi i llogarive dhe i bilancit kontabël.

Kryerja e auditimeve është zhvilluar në bazë të planit, duke u bazuar në vlerësimin e riskut, nivelin e materialitetit, flukset e punës, objektivat e institucionit dhe ecurinë e tyre etj.

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", VKM nr.345, datë 01.6.2004 "Për miratimin e



manualit të procedurave të auditimit të brendshëm”, seksioni II, pika 9 “frekuenca e auditimeve”, për t’u dhënë prioritet në fillim të vitit, auditimit të subjekteve që plotësojnë frekuencën gjatë vitit 2008-9 dhe në varësi të burimeve të auditimit, është synuar që subjektet t’i nënshtrohen auditimit ç’do vit, qoftë dhe për probleme të veçanta.

- Zbatimi i planeve të auditimit të brendshëm. Hartimi dhe mbajtja e dokumentacionit të auditimit.

Gjatë vitit 2009 janë realizuar 12 misione auditimi, prej të cilave 10 auditime të plota, 4 tematike. Për vitin 2008, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në DP, sipas programit do të kryente auditim të plotë për 9 subjekte dhe 2 auditime tematike. Në fakt janë kryer auditime të plota në 10 subjekte dhe 4 auditime tematike.

Dokumentacioni i auditimit është plotësuar konform dispozitave ligjore, kështu, para fillimit të auditimit janë plotësuar deklaratat përkatëse nëse audituesi ka konflikt interesi me subjektin e kontrollit. Në përfundim të kontrollit janë mbajtur procesverbale apo aktverifikime dhe më pas është hartuar Projekt Raporti i kontrollit, i cili është lënë në dispozicion të subjektit të kontrollit sipas afateve të përcaktuara në ligjin për auditimin në sektorin publik. Janë shqyrtuar me korrektësi sqarimet apo observacionet e subjektit të kontrolluar dhe mbi bazën e këtyre ndryshimeve është hartuar memorandum i për Raportin Final, me të cilin është informuar titullari dhe këshilli administrativ. Në përfundim të shqyrtimit nga këshilli drejtues, janë hartuar konkluzionet përfundimtare dhe është dërguar Raporti Final subjektit të audituar.

Në përfundim të çdo auditimi, është llogaritur kosto e auditimit, në të cilën janë përfshirë pagat e punës, dietat, si dhe shpenzime të ndryshme. Në fund të çdo viti kalendarik është llogaritur edhe kosto totale e shpenzimeve të kryera gjatë vitit ushtrimor.

- Hartimi i Raportit final të auditimit dhe sigurimi i cilësisë. Baza ligjore për detyrat e lëna dhe rekomandimi i masave për përmirësimin e gjendjes.

Raporti final është hartuar konform ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, VKM nr. 345, datë 01.6.2004 “Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm”.

Për çdo auditim të përfunduar në drejtoritë rajonale Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka hartuar kapitull të veçantë për:

1. Vlerësimin e riskut.

Një vend të rëndësishëm në programet e auditimit ka qenë edhe vlerësimi i riskut dhe matja e mundësisë së ekzistencës së tij në fushat ku krijohen të ardhurat



e Institucionit. Në raportet dhe konkluzionet përfundimtare vëmendje e veçantë i është kushtuar auditimit të aktivitetit ku krijohen të ardhurat si në kontrollin teknik periodik dhe në respektimin e dispozitave ligjore për taksat që paguajnë drejtuesit e mjeteve.

2. Vlerësimin e drejtimit

Në programet e kontrollit dhe në auditimet e kryera, është parashikuar vlerësimi i drejtimit të çdo drejtorie rajonale. Në përfundim të kontrollit është konstatuar se nga drejtoritë rajonale në hartimin e programit ekonomik e financiar për vitet 2007 dhe 2008 nuk janë parashikuar dhe përcaktuar mënyrat dhe rrugët për arritjen e objektivave në drejtim të arkëtimit të detyrimeve të prapambetura nga drejtuesit e mjeteve që nuk paraqiten për pagimin e detyrimeve sipas ligjit, pasi këto detyrime përbëjnë rezerva potenciale të konsiderueshme në të ardhurat e institucionit. Gjithashtu drejtoritë rajonale nuk kanë përcaktuar mënyrat e zgjidhjes për arkëtimin e tyre.

Një ndër mangësitë kryesore në sistemin e drejtimit të drejtorive rajonale që Drejtoria e Auditimit ka konstatuar, është mosmarrja e masave të plota në drejtim të arkëtimit të taksës së regjistrimit të mjeteve, me pasojë evazion fiskal në disa drejtori rajonale e konkretisht; në DR Vlorë 536,200 lekë, në DR Fier 432,800 leke, në DR Shkodër 219.200 lekë, në DR Elbasan 82.400 lekë dhe në DR Kukës 39800 lekë.

3. Auditimin e deklaratave financiare.

Gjatë auditimeve një vend të rëndësishëm ka zënë auditimi i veprimeve për arkëtimin e taksave dhe derdhja e tyre në afat në buxhetin e shtetit. Në këtë drejtim vëmendje e veçantë i është kushtuar kontrollit të njëpasnjëshëm të veprimeve të arkës, mbylljen e rezultatit në fund të ditës dhe derdhjen e tyre në bankë në favor të Buxhetit të Shtetit. Në disa raporte auditimi janë evidentuar se, disa drejtori rajonale në fund të muajit mbajnë gjendje e lartë e mjeteve monetare mbi kufirin e lejuar, për këtë grupit i auditimit ka marrë masa të menjëhershme për derdhjen e mjeteve monetare në bankë.

Në auditimet e kryera një vend të rëndësishme ka zënë rakordimi i të ardhurave nga TVSH dhe derdhja e saj në Drejtoritë Rajonale të Tatim Taksave e konkretisht; në DR Tirane nuk është bërë mbyllja e artikujve të magazinës për tvsh e zbritshme për muajin korrik 2008 me llogarinë 445.3 (tvsh për t'u paguar). Nuk është mbyllur tvsh-ja e mbledhshme e muajit Qershor me llogarinë 445.3 (tvsh për t'u paguar), ndërsa artikulli kontabël i aktivitetit të kontrollit teknik për muajin korrik 2008 nuk përputhet me flete kontabilizimi dhe centralizatorin. Nga auditimi i kryer në këtë drejtim janë evidentuar gjithsej 55 raste me evazion fiskal në vlerën 1.549 mijë lekë, për të cilat është rekomanduar sistemimi i veprimit dhe dërdhja në degët e tatim taksave ku është konstatuar evazoni fiskal.



4. Auditimi mbi respektimin e organikës, strukturën dhe pagat.

Nga auditimet e kryera është konstatuar se në përgjithësi Drejtoritë Rajonale kanë respektuar organikat dhe tabelat e pagave të miratuara nga Bordi Drejtues. Megjithatë gjatë auditimeve të kryera gjatë periudhës objekt kontrolli është konstatuar se në disa drejtori rajonale janë bërë emërime të punonjësve pa marrë miratim nga Drejtori i Përgjithshëm, për këtë ndaj shkaktarëve janë marrë masa disiplinore dhe administrative.

5. Auditimin e bilancit kontabël.

Në programet e auditimit dhe në raportet finale një vend me rëndësi ka zënë edhe auditimi i bilancit kontabël të periudhës ushtrimore. Nga auditimet ka rezultuar se, sektorët e financës kanë zbatuar drejt ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshimet, e për rrjedhojë në pasqyrat financiare janë paraqitur në mënyrë korrekte jo vetëm pasuria e ndërmarrjes por edhe të ardhurat, shpenzimet dhe rezultati përfundimtar.

6. Mbi auditimin në sektorin e regjistrimit të mjeteve.

Nga auditimet e kryera është konstatuar se, në disa Drejtori Rajonale nuk nënshkruhen konfirmimet doganore për regjistrimin e mjeteve nga drejtuesi i njësisë, ndërkohë që Drejtoria e Përgjithshme ka udhëzuar drejtoritë rajonale për regjistrimin e mjeteve nga arkiva e vjetër. Në përpunimin e këtij informacioni kryesisht për ato mjete të cilat nuk kanë kryer rinovimin e lejes së qarkullimit janë vërejtur mangësi në përcaktimin dhe hedhjen e të dhënave, kështu përmendim, arkivën Shkodër, e cila nuk ka kryer këtë regjistrim. Në DR Fier, DR Vlorë, dhe Shkodër në transferimin e dosjeve të mjeteve dhe të lejeve të drejtimit, nuk zbatohen afatet e përcaktuara me ligj, të cilat variojnë respektivisht nga 1-45 ditë dhe 1-15 ditë.

Nga kontrollet e ushtruara është konstatuar se në këto drejtori, targat e vjetra nuk dorëzohen çdo ditë në magazine në kundërshtim me udhëzimin përkatës të DP, veprim i cili ka sjellë si pasojë që të mos evidentohen në kohë regjistrimet e mjeteve të dala nga qarkullimi, duke rritur në mënyrë artificiale detyrimet e papaguara.

7. Auditimin në sektorin e kontrollit teknik.

Nga kontrolli i ushtruar në disa drejtori konstatohet se në Drejtoritë Rajonale; Fier, Gjirokastrë dhe Shkodër kontrolli teknik kryhet vizual apo me metoda tradicionale për mungese të pajisjeve, veprime këto që lënë shteg për subjektivizëm dhe abuzim me kryerjen e detyrës.

8. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm



Nga auditimet e kryera ka rezultuar se, drejtoritë rajonale kanë hartuar dhe miratuar nga titullarët planet e kontrollit të brendshëm. Ndërsa zbatimi i tyre ka qene i pjesshëm dhe nuk është shtrirë në të gjithë sektorët e shërbimit, veçanërisht nga DR Laç, DR Gjirokastrë dhe DR Tiranë.

Nga auditimet e kryera në drejtori rajonale është konstatuar se, në partitarin analitik të kreditorëve mbahen në analiza të veçanta subjekte për shërbime të arkëtuara por të pakryera. Në këtë llogari vlerë të konsiderueshme zënë taksat e paguara nga subjektet fizike e juridike, shtetërore të cilët kanë kryer pagesën por nuk janë paraqitur për të kryer shërbimin e kërkuar, po kështu dhe në sektorin e lejeve të drejtimit. Kjo menyrë veprimi pakëson padrejtësisht detyrimet e papaguara të pasqyruara në bilanc.

Kështu, përmendim DR Tiranë, gjendja e kreditorit e paraqitur në bilancin kontabël të vitit 2008 është e konsiderueshme por nuk mbahet e analizuar në partitarin analitik.

Spektori i taksave si aktivitet me risk të lartë, ka funksionuar mire duke arkëtuar me përgjegjësi taksat në vazhdim si dhe ato të viteve paraardhëse. Si tregues kryesor për arkëtimin e taksave të mjeteve shërben rakordimi me numrin e kontrolleve teknik të mjeteve.

Nga rakordimi i kryer midis numrit të kontrolleve teknike me taksat e arkëtuara rezulton se, në të gjitha Drejtoritë Rajonale numri i taksave të arkëtuara ka qene rreth 12-15% me i larte se numri i kontrolleve teknike vjetore, pasi pagimi i taksave nuk përkon me afatin kontrollit teknik periodik të mjeteve. Taksat e arkëtuara janë derdhur rregullisht në buxhet pas rakordimeve me drejtoritë rajonale të tatim-taksave dhe thesarit në rrethe.

Me gjithë punën e mire janë konstatuar dhe mangësi në arkëtimin e tyre e konkretisht; në DR Elbasan ka mangësi në dokumentacionin e përcaktimit të sakte të llojit të mjeteve në kundërshtim me Udhëzimin "Mbi klasifikimin e mjeteve për efekt takse"; në DR Gjirokastrë konstatohet se, janë kryer kontrolle teknike pa arkëtuar me pare taksat; në DR Tiranë janë kryer shërbime mjeteve, megjithëse kanë detyrime për taksa të papaguara në afat, etj.

Në të gjitha këto raste grupi i auditimit ka llogaritur detyrimet e paarkëtuara sipas targave të mjeteve, i ka klasifikuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 1.803 mijë leke. Për këtë, Drejtoria e Auditimit ka dërguar informacion periodik Drejtorive Rajonale të Tatim Taksave, Organeve të Qarkullimit Rrugor dhe Prefekturave për mjetet me detyrime të pashlyera. Evazioni fiskal i konstatuar në drejtoritë e mësipërme është rekomanduar për arkëtim në shërbimin më të pare të paraqitjes së këtyre mjeteve pranë Drejtorive Rajonale, duke nxjerrë edhe përgjegjësinë ndaj shkaktarëve deri në largim nga detyra.



Në auditimet e kryera për blerjet me vlera të vogla, Drejtoria Auditimit ka konstatuar se, në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e UKM nr.1, datë 20.03.2007 megjithatë në disa Drejtori Rajonale janë konstatuar tejkalime të limitit të blerjeve me vlera të vogla për të njëjtin artikull apo grup artikujsh, si p.sh. në Drejtoria Rajonale Elbasan, Drejtoria Rajonale Elbasan Tiranë, Drejtoria Rajonale Elbasan Fier dhe Drejtoria Rajonale Elbasan Vlorë, ndaj personave përgjegjës janë marrë masa disiplinore.

Nga kontrollet e kryera në procedurat e Prokurimit Publik, rezulton se është hartuar regjistri i parashikimeve dhe realizimit të prokurimeve publike, të cilat janë dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik, konform ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" duke respektuar kufijtë monetare në përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, llogaritjen e vlerës, hartimi dhe miratimi i dokumentacionit të tenderit kërkesat, afatet dhe kushtet për njoftimin e kontratës, njoftimin e fituesit, njoftimin e lidhjes së kontratës dhe publikimit të tyre në buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik etj.

Krahas zbatimit me korrektësi të dispozitave ligjore, janë konstatuar mangësi në zbatimin e procedurave të prokurimit publik si p.sh. në DRShTRr Gjirokastrë është vepruar në kundërshtim me nenet; 12 dhe 47, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin nr. 9800, datë 10.09.2007 "Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006", e konkretisht:

- Dosjet e procedurave të prokurimit janë të pasistemuara, painventarizuara dhe padorëzuara në arkiv.

- Nuk mbahet procesverbal nga njësia e prokurimit për përcaktimin e fondit limit, dokumentacionit standard të tenderit, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, kapaciteti financiar, garancia, sigurimi i kontratës, kriteret e përzgjedhjes etj.

- Mungojnë dokumentat standarde të tenderit.

- Formularët e deklarimit nëse ka konflikt interesi të njësisë së prokurimit janë pa datë dhe të panënshkruar.

- Nuk ka procesverbal për përcaktimin e ofertave anomalisht të ulëta.

- Kërkesë për dhënie shpjegimi mbi origjinën e mallrave dhe ofrimin e mostrave" dhe kohe e pamjaftueshme për njoftimin me postë të operatoreve ekonomikë pjesëmarrës dhe paraqitjen e shpjegimeve me shkrim apo verbale nga personi i autorizuar i operatorit ekonomik së bashku me mostrat përkatëse.

Në disa Drejtori Rajonale kontrolli kryhet me metodën tradicionale (vizuale) pasi nuk janë vënë në funksionim të gjitha pajisjet e kontrollit teknik si në Drejtoria Rajonale Elbasan Laç, Gjirokastrë, Berat, gjë që tregon për shpenzime pa efektivitet dhe ngurtësim të fondeve buxhetore, duke sjellë si pasojë formalizëm në kontrollin periodik teknik të mjeteve.

Nga kontrollet e kryera është nxjerrë konkluzion se sektori i kontrollit rrugor në të gjitha Drejtoritë Rajonale është aktivitet me humbje. Pasi gjërat e vendosura



nga inspektorët rrugorë janë arkëtuar në masën 50 %, gjobat e vendosura në disa drejtori nuk arkëtohen madje edhe kur mjetet paraqiten për kontrollit teknik periodik. Në të gjitha këto raste drejtoria e auditimit i ka klasifikuar dëm ekonomik dhe ka rekomanduar arkëtimin e tyre, duke nxjerrë përgjegjësinë ndaj punonjësve që kanë kryer shërbimin pa arkëtuar më parë detyrimin që rrjedh nga gjobat e papaguara.

- Evidenca e zbulimeve nga auditimet e kryera.

Për vitin 2008 u kontrollua saktësia e evidencës së zbulimeve të auditimeve dhe rezultoi se në evidencë janë evidentuar në mënyrë korrekte të dhënat e zbulimeve sipas natyrës, duke i ndarë në sasi dhe në vlerë sipas periudhës së zbulimit dhe për çdo auditim të kryer.

Kështu sipas evidencës së zbulimeve, nga 10 auditimet e plota janë evidentuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në vlerën 8.404 mijë lekë, konkretisht në Drejtorinë Rajonale Tiranë 6.238 mijë lekë, në Drejtorinë Rajonale Fier 913 mijë lekë, në Drejtorinë Rajonale Vlorë 640 mijë lekë, Drejtorinë Rajonale Shkodër 345 mijë lekë dhe Drejtorinë Rajonale Kukës 260 mijë lekë. Sipas evidencës, Drejtoria e Auditimit ka rekomanduar zhdëmtimin e dëmit të konstatuar në masën 100 %.

Janë rekomanduar masa disiplinore në total ndaj 45 punonjësve, nga të cilat 42 punonjës me "Vërejtje" dhe "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna" dhe 3 punonjës "Largim nga detyra".

- Mbi verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna dhe masat e marra nga subjektet e kontrolluara.

Drejtoria e Auditimit ka programuar dhe ka ushtruar kontrolle të vazhdueshme për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. Nga verifikimi për zbatimin e rekomandimeve është konstatuar se, subjektet e audituara në përgjithësi kanë marrë në konsideratë rekomandimet e Drejtorisë së Përgjithshme, kanë programuar zbatimin e tyre, si dhe kanë kryer veprimet kontabile për kontabilizimin e shkeljeve të disiplinës financiare me dëm ekonomik në ngarkim të subjekteve debitoare.

Ndërsa Drejtori Rajonale; Laç, Gjirokastrë dhe Tiranë, rekomandimet për arkëtimin e detyrimeve nga personat përgjegjës të cilët nuk janë në marrëdhënie pune, apo arkëtimin e taksave për mjetet që nuk paraqiten për shërbimin e kontrollit periodik të radhës, i kanë pranuar pjesërisht.

- Evadimi i materialeve të auditimit, ruajtja dhe arkivimi i tyre.

Nga kontrolli rezultoi, se dosjet e auditimit të cilat konsiderohen të përfunduara janë arkivuar konform ligjit për arkivat, së bashku me inventarin e dosjes.

- Mbi auditimin e kryer nga organi epror.

Auditimi nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit është kryer i plotë për periudhën 01.04.2008 deri në datën



31.03.2009, sipas drejtimeve të përcaktuara në programin nr. 1847/1, datë 27.03.2009, e konkretisht mbi: Vlerësimin e Auditimit të brendshëm dhe sistemin e kontrollit, vlerësimin e riskut, sistemin e informimit dhe komunikimit, auditimin e performancës, auditimin e pajtueshmërisë, auditimin e sistemit të pagave dhe auditimin e deklaratave financiare.

Nga kontrolli i ushtruar në treguesit ekonomikë të realizuar nga DPSHTRR për vitin 2008 sipas raportit përfundimtar të kontrollit rezulton se nuk rakordojnë të dhënat për të ardhurat dhe shpenzimet e paraqitura në total si drejtoi dhe të ardhurat dhe shpenzimet analitike për çdo drejtori rajonale kështu:

Të ardhurat në total për drejtorinë e përgjithshme janë në vlerën 1.652.565,2 mijë lekë, ndërsa në mënyrë analitike sipas drejtorive rajonale paraqiten në vlerën 1.647.996 mijë lekë ose 4.569.000 lekë më pak se sa bilanci i DPSHTRR dhe rezultati bruto është 585.797,6 mijë lekë fitim i deklaruar në bilancin kontabël.

Shpenzimet në total për DPSHTRR janë në vlerën 1.066.767,6 mijë lekë, ndërsa në mënyrë analitike sipas drejtorive rajonale janë në vlerën 1.079.627 lekë, ose më tepër në vlerën 12.860.000 lekë, ndërsa rezultati bruto është në vlerën 568.369 mijë lekë. Për këto ndryshime midis të ardhurave dhe shpenzimeve dhe rezultati përfundimtar në pasqyrën përmbljedhëse të drejtorive rajonale më pak për vlerën 17.428 mijë lekë, nga ana e audituesve nuk është nxjerrë asnjë konkluzion.

Në Raportin Final mbi kontrollin e ushtruar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit është konstatuar se në bilancin kontabël të vitit 2008 nuk është pasqyruar vlera e tokës, trojeve dhe shesheve në kundërshtim me nenin 7 dhe 10 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ndërsa në konkluzionet dërguar subjektit të kontrolluar nuk është lënë detyrë vlerësimi dhe kontabilizimi i tokës, trojeve dhe shesheve pronë e Drejtorisë së Përgjithshme.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

Nga kontrolli i ushtruar u konstatua se, DPSHTRR me autorizim të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit sipas nenit 9 të ligjit nr. 7582, datë 11.07.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore" i ndryshuar, ka lidhur kontratë me dy ekspertë kontabël për verifikimin e llogarive dhe saktësinë e bilanceve kontabël të viteve 2007 dhe 2008, të cilët kanë përfutur vlerën 1,9 milionë lekë. Po kështu u konstatua se, me kërkesë të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe me miratim të Këshillit Drejtues të ndërmarrjes në vitin 2008 është xhiruar në buxhet tepërca e fitimit në vlerën 1.2 miliardë lekë e akumuluar ndër vite. Ky veprim është kryer sipas nenit 16 të "statutit të ndërmarrjes", ndërkohë që ligji nr. 7582, datë 11.07.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore" i ndryshuar, nuk ka përcaktuar si duhet të vepohet me



fiskale, veprim i cili do të sjellë arkëtime fiskale të konsiderueshme nga mjetet që deri më sot nuk janë paraqitur.

Menjëherë

2. Nga kontrolli i ushtruar në Raportin Final të Auditimit të kryer nga Drejtoria e Auditimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, është konstatuar se, në bilancin kontabël të vitit 2008, nuk është pasqyruar, vlera e tokës, trojeve dhe shesheve pronë e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, në kundërshtim me nenin 7 dhe 10 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Në konkluzionet dërguar subjektit të kontrolluar nuk është lënë detyrë vlerësimi dhe kontabilizimi i tokës, trojeve dhe shesheve pronë e Drejtorisë së Përgjithshme.

Për këtë rekomandojmë që: Në zbatim të nenit 7 dhe 10 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar dhe ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të merren masa për të vlerësuar sipërfaqen e trojeve dhe shesheve pronë c DPSHTRR dhe vlera e tyre të pasqyrohet në rubrikën e AQT-ve, në llogarinë "Toka, Troje, Terrene".

Menjëherë

C. MASA ZHDËMTIMI

Të ndiqet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit, për rastet në vijim:

1. Të merren masa dhe të ndiqen procedurat në rrugë ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **111.504 lekë**, nga subjekti "AL-Tek", për sa përfituar padrejtësisht për hartimin e projekteve dhe preventivave të ngrohjes së Drejtorive Rajonale Fier, Dibër dhe Kukës, trajtuar hollësisht në faqet nr. 13 dhe 14, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Brenda datës 31.05.2010

2. Të merren masa dhe të ndiqen procedurat në rrugë ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **244.106 lekë**, për sa llogaritur gabim paga e përfituar me vendim gjykatë nga z. Mark Lleshi, trajtuar hollësisht në faqen nr. 15, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Brenda datës 31.05.2010

"Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Kontrollit".

KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Nr.	Shërbimi
1	Regjistrim mjete, motomjeti
2	Regjistrim ciklomotori
3	Pajisje me certifikatë pronësie e mjetit rrugor
4	Pajisje me leje qarkullimi ndërkombëtare
5	Çregjistrim i përheshëm i mjetit rrugor
6	Çregjistrim i përkohshëm i mjetit rrugor
7	Ndërrim targë të mjetit rrugor në rast humbje, vjedhje apo dëmtimi
8	Ndërrim leje qarkullimi mjete rrugor (humbje, vjedhje apo dëmtimi)
9	Pajisje me leje qarkullimi provizore të mjetit rrugor
10	Ndërrim pronësie i mjetit rrugor
11	Lëshim targë prove
12	Transferim dosje
13	Ndërshim konstruktiv i mjetit rrugor
14	Ristampim i numrit të identifikimit të mjetit rrugor (VIN)
15	Vërtetime të ndryshme për mjetet rrugore
16	Pagesa e Taksës Vjetore të Mjeteve të Përdorura (TVMP)
17	Kalibrim tahografi analog
18	Kalibrim fillestar i tahografit dixhital
19	Heqje e pajisjes së regjistrimit të tahografit dixhital
20	Inspektimi 2 vjeçar i tahografit analog
21	Inspektimi 6 vjeçar i tahografit analog
22	Lëshimi i kartës dixhitale të tahografit për drejtues mjete
23	Lëshimi i kartës dixhitale të tahografit për shoqërinë
24	Lëshimi i kartës dixhitale të tahografit për kontroll në grup
25	Lëshimi i kartës dixhitale të tahografit për ofiqinat e tahografit
26	Pajisje me certifikatë për Transport Ndërkombëtar Mallrash për të Tretë dhe me Qira
27	Lëshimi i licencës për Transport të Mallrave me Mjete jashtë Norme
28	Pajisje me certifikatë për Transport Ndërkombëtar Mallrash për Llogari të Veç
29	Pajisje me certifikatë për Transport Mallrash të Rreziqshme Brenda Vendlit
30	Pajisje me certifikatë për Transport Ndërkombëtar Mallrash të Rreziqshme
31	Vlerësim i kushteve të komoditetit
32	Pajisja me certifikatë të Kontrollit Teknik të Sigurisë për Mjetet Motorike, Rimorkiot ose Gjysërimorkiot, ndërmjet dy ose më shumë anëtare CEMT

33	Pajisje me Certifikatë Trainimi ADR
34	Rinovim i Certifikatës së Trainimit ADR
35	Rinovim i Dëshmisë së Aftësisë Profesionale DAP për përdoruesit e makinave të rënda Automakinsit
36	Pajisje me Dëshmi të Aftësisë Profesionale DAP për përdoruesit e makinave të rënda Eskavatorist Me Zinxhir
37	Rinovim i Dëshmisë së Aftësisë Profesionale DAP për përdoruesit e makinave të rënda Eskavatorist Me Zinxhir
38	Pajisje me Dëshmi të Aftësisë Profesionale DAP për përdoruesit e makinave të rënda Eskavatorist Me Gome
39	Rinovim i Dëshmisë së Aftësisë Profesionale DAP për përdoruesit e makinave të rënda Eskavatorist Me Gome
40	Pajisje me Dëshmi të Aftësisë Profesionale DAP për përdoruesit e makinave të rënda Bulldozerist
41	Rinovim i Dëshmisë së Aftësisë Profesionale DAP për përdoruesit e makinave të rënda Bulldozerist
42	Pajisje me Dëshmi të Aftësisë Profesionale DAP për Mesues Teorie
43	Rinovim i Dëshmisë së Aftësisë Profesionale DAP për Mesues Teorie
44	Pajisje me Dëshmi të Aftësisë Profesionale DAP për Instruktor Praktike në autoskolla
45	Rinovim i Dëshmisë së Aftësisë Profesionale DAP për Instruktor Praktike në autoskolla
46	Pajisje me Certifikatë të Kompetencës Profesionale ÇKP
47	Rinovim i Certifikatës së Kompetencës Profesionale ÇKP
48	Pajisja me Dëshmi Taksisti
49	Pajisje me Certifikatën e Aftësisë Profesionale ÇAP
50	Pajisje me leje drejtimi (për herë të parë dhe shtrirje kategorie)
51	Rinovim i lejedrejtimit (Humbje, vjedhje, dëmtim, tejkalim i afatit të vlefshmërisë)
52	Trasferim i dosjes së lejedrejtimit.
53	Pajisja me lejedrejtimi Ndërkombëtare
54	Pajisja me lejedrejtimi të përkohëshme
55	Njehsimi i lejeve të drejtimit të lëshuara nga shtetet e huaja në shoqiptare
56	Pajisje me autorizim për ushtrimin e aktivitetit për përgatitjen e kandidatëve për drejtues mjeti
57	Vlerësim teknik për mjedin autoskollë
58	Pajisja me Leje Drejtimi të Posaçme
59	Vërtetime të ndryshme për lejet e drejtimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
 DIREKTORIA E BUREVE NUKLEARE DHE SHERBIMEVE

Nr. 4463 prot

Tiranë më 24 9 12003

Lënda: Miratohet Struktura dhe Rregullorja u Brendeshme e Drejtorisë
 së Përgjithshme të Sherbimit të Transportit Rrugor


DREJTORISE SE PERGJITHSHEME TE SHERBIMIT TE
TRANSPORTIT RRUGOR

TIRANE



Bashkëlidhur ju dergojme te miratuar Rreguloren e Brendeshme dhe
 Strukturen Organizative te drejtorise tuaj.

ORGANIGRAMA
E DREJTORISE SE PERGJITHSHEME TE SHERBIMIT TE TRANSPORTIT RRUGOR



**MIRATOHET
MINISTRI
Spartak POÇI**

R R E G U L L O R E E brendshme e DPSHTRR - se

Hyrje

Ne mbështetje të ligjit nr 7961 date 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" dhe të VKM nr 103 date 04.02.1998 "Për rregullat e Përgjithshme të Punës në Administratën Shtetërore" Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor krijuar me VKM nr 343 date 21.07.1999, me status të miratuar nga Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit përkatësisht me shkresën nr 4703 prot dt 22.11.2002 funksionon sipas kësaj rregulloreje:

Neni 1

Objekti i veprimtarisë

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR) është krijuar me VKM nr 343 date 21.07.1999 me qëllim grupimin e përgjegjësive me karaktere ngjashëm në fushën e shërbimeve të transportit rrugor.

Ajo **vepron** mbështetur në ligjin nr 8378 date 22.07.1998 Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr 8306 date 18.03.1998 "Për Transportet Rrugore" në ligjin nr 7582 date 13.07.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore" si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

Detyra e kësaj drejtorie është shërbimi ndaj subjekteve shtetërore dhe private, në veprimtarinë e transportit rrugor, për regjistrimin e mjeteve, për ndermarrjen e pronësive së tyre, paisjen me targa, kontrollin teknik të mjeteve, për paisjen e drejtuesëve të mjeteve me leje drejtimi, për ngritjen dhe informatizimin e regjistrit kombëtar të mjeteve e të drejtuesëve të mjeteve dhe për transmetimin e menjëhershëm të të dhënave të kërkuara nga policia e

rendit si dhe dënimin e licensave.

DPSHTRR administron dhe organizon kontrollin administrativ dhe ekonomik financiar në drejtoritë dhe sektorët rajonale si dhe siguron asistencë teknike dhe kualifikuese të vazhdueshme për personelin e saj nëpërmjet qendres së trajnimit.

Neni 2

Drejtimi, administrimi dhe kontrolli i DPSHTRR –se.

Drejtimi, administrimi dhe kontrolli i DPSHTRR realizohet nga:

- a. Keshilli Drejtues
- b. Drejtoia e Përgjithshme sipas strukturas së miratuar nga Ministri.
- c. Drejtorite Rajonale sipas strukturas së miratuar nga Keshilli Drejtues.

Kur është e nevojshme Drejtori i Përgjithshëm krijon grupe pune dhe kontrolli nga struktura e Drejtorisë së Përgjithshme si dhe krijon organe konsultative me pjesëmarrje të specialistëve të jashtëm. Detyrat dhe përbërja e këtyre grupeve dhe organeve konsultative përcaktohen në aktet e krijimit.

Neni 3

Drejtori i Përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm është titullari i DPSHTRR, drejton punën administrative dhe kontrolluese në këtë institucion si dhe siguron zbatimin e legjislativës bazë, të gjithë aktet normative të tjera në zbatim, nëpërmjet të cilave ky institucion vepron.

Kompetencat e tij përcaktohen në statutin e DPSHTRR.

2. Drejtori i Përgjithshëm zbaton:

- Detyrat e përcaktuara në statut
- Detyrat e caktuara nga Keshilli Drejtues
- Detyrat e caktuara nga Ministri

Neni 4

Zv/Drejtori i Përgjithshëm teknik

Emërohet dhe lirohet nga detyra nga Ministri i Transportit dhe

Telekomunikacionit me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm. Kryen funksionin e tij në përputhje me aktet ligjore e nënligjore si dhe me detyrat e parashikuara në këtë rregullore si me poshtë:

1. Ndjek realizimin e detyrave teknike në përputhje me planet e punës të miratuara nga titullari për Drejtorinë dhe sektorin e varësise si dhe në të gjithë strukturat në qender dhe rrethe.
2. Organizon kordinon dhe kontrollon të gjithë veprimtarinë në funksion të realizimit të detyrave në Drejtorinë dhe sektorin përkatës në qender dhe bazë.
3. Raporton Drejtorit të Përgjithshëm për realizimin e detyrave të sektoreve që mbulon dhe merr masa për rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e standardeve të shërbimit të transportit rrugor.
4. Përgatit raportin e analizës vjetore dhe ja dërgon për miratim titullarit. Merr pjesë në analizat e Drejtorisë Rajonale dhe Drejtorit në qender sipas përkatësive dhe urdhrave të titullarit.
5. Organizon dhe harton metodikë, përgjithësimet si dhe trajnime për kualifikimin e specialistëve në qender dhe në bazë.
6. Në bashkëpunim me Drejtorinë përkatëse dhe sektorin juridik, merr masa për përgatitjen e akteve normative që lidhen me rritjen e rentabilitetit të shërbimeve.
7. Ben dhe ndjek programin e punës vjetore dhe analitikë për çdo muaj për drejtorinë dhe sektorin e varësise dhe kërkon realizimin e detyrave në përputhje me këtë program.
8. Në mungesë dhe me porosi të Drejtorit të Përgjithshëm kryen detyrat e ngarkuara prej tij.
9. Merr masa organizative që kontrolloi administrativ i drejtorisë dhe sektoreve të varësise në të gjitha drejtorinë rajonale të përfundojë brenda vitit kalendarrë.
10. Në bashkëpunim me Zv/Drejtorin e Përgjithshëm ekonomik, me Drejtorinë dhe Sektorin në DPShTR, përgatit raportin e analizës 3,6 muajore dhe vjetore, duke përcaktuar detyrat dhe masat për përmirësimin në vazhdim.
11. Drejton grupe pune dhe kontrollin me urdher të Drejtorit të Përgjithshëm dhe për shkeljet apo mangësitë që konstaton propozon masat disiplinore përkatëse për çdo punonjës.

Neni 5 Zv/Drejtori i Përgjithshëm ekonomik

Emërohet dhe lironet nga detyra nga Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm. Kryen funksionin e tij në përputhje me aktet ligjore si dhe me detyrat e parashikuara në këtë rregullore si me poshtë:

1. Merr masa dhe organizon ndjekjen dhe hartimin e projekt buxhetit në afat dhe ja dërgon për miratim organeve eprore.
2. Ndjek realizimin e të gjithë treguesve ekonomikë e financiar në qender dhe bazë, i analizon dhe ben prognozën e tyre për të ardhmen.
3. Ndjek realizimin e të ardhurave dhe përcakton prioritetet e D.P.Sh.T.R.R në tushen e investimeve.
4. Merr masa organizative me Drejtorinë përkatëse në qender, dhe Drejtorinë Rajonale për përfundimin e analizave të veprimtarisë ekonomike e financiare të D.P.Sh.T.R.R (bilançeve kontabel) brenda afateve ligjore. Analizon treguesit në mënyrë analitike dhe merr masa për shëndoshjen e tyre.
5. Në bashkëpunim me Drejtorinë ekonomike dhe sektorin juridik, merr masa për përgatitjen e akteve normative në funksion të rritjes së të ardhurave.
6. Raporton vazhdimisht Drejtorit të Përgjithshëm për realizimin e të gjitha treguesve dhe në vecanti ato të të ardhurave dhe shpenzimeve.
7. Ben dhe ndjek programin e punës vjetor dhe analitik për çdo muaj për drejtorinë dhe sektorin e varësise dhe kërkon realizimin e detyrave në përputhje me atë program.
8. Në mungesë dhe me porosi të Drejtorit të Përgjithshëm kryen detyrat e ngarkuara prej tij.
9. Njeh dhe zbaton legjislacionin për prokurimet publike dhe është përgjegjës për këto prokurime në DPShTRR. Organizon kontrole për zbatimin e këtyre procedurave nga drejtorinë rajonale.
10. Merr masa organizative që kontrolloi administrativ i drejtorisë dhe sektoreve të varësise në të gjitha drejtorinë rajonale të përfundojë brenda vitit kalendarrë.
11. Drejton grupe pune dhe kontrollin me urdher të Drejtorit të Përgjithshëm dhe për shkeljet apo mangësitë që konstaton

propozon masat disiplinore përkatëse për çdo punonjës.

Neni 6

Sekretarja e Drejtorit të Përgjithshëm

Emerohet, shkarkohet dhe varet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Ajo ka këto detyra:

1. Ndihmon në përgatitjen e materialeve për Drejtorin e Përgjithshëm (DP)
2. Evidenton dhe trasmeton porosinë e DP, ndjek zbatimin e tyre dhe e informon atë për realizimin e tyre
3. Merr korrespondencën e materialit të tjerë që vijnë në adresë të DP dhe kryen veprimet përkatëse.
4. Sistemon dhe kontrollon rregullisht materialet që do të kalojnë për firmë ose shqyrtim DP dhe raketon me zyrën e protokollit sipas shërbimeve të DP.
5. I komunikon DP emrat e personave që kërkojnë takim, pret dhe cakton radhën e takimit sipas porosive së marrë.
6. I paraqet çdo ditë DP axhenden e problemeve dhe detyrave ditore të përcaktuara me përparësi.
7. Regjistron dhe trasmeton urdherat, njoftimet dhe porosinë që vijnë në adresë të DP.
8. Daktilografohet materialet e DP dhe të Zv/Drejtorave të Përgjithshëm.
9. Kujdeset për pajisjet dhe orëditë e zyrës së DP.

Neni 7

DREJTORIA EKONOMIKE

Drejtoria Ekonomike është pjesë e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe varet nga Drejtori i Përgjithshëm. Ndjek dhe përputhon politikën e zhvillimit ekonomik financiar të DPShTRR.

7.1 Drejtori i Drejtorisë Ekonomike

Kryen funksionin e tij në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore dhe detyrat e parashikuara në këtë rregullore.

1. Organizon, drejton dhe kontrollon punën për zbatimin e aktëve

ligjore dhe nenligjore si dhe urdherave të Drejtorit të Përgjithshëm në fushën e zhvillimit ekonomik-financiar të ndërmarrjes. Informon dhe raporton përpara Drejtorit të përgjithshëm për problemet që dalin dhe masat që duhen marrë.

2. Organizon dhe drejton punën për hartimin e programit afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të DPShTRR, organizon punën për hartimin e tregësive ekonomiko-financiare për vitin si dhe pasqyron të gjitha tendencat e zhvillimit ekonomik-financiar. Ndjek nepermjet sektorëve përkatës realizimet e detyrave të programuara dhe që lidhen me përmirësimin ose përkëqesimin të gjendjes financiare.
3. Paraqet para Drejtorit të Përgjithshëm të gjitha tregësitë financiare të realizuar dhe akumuluar të vitit ushtrimor si dhe programin ekonomik-financiar të vitit të ardhshëm, si dhe kërkesën për t'iu miratuar ato në Këshillin Drejtues. Pjesë e kësaj paraqitje është kërkesa për ndarjen e fitimit, llogaritja dhe shpërndarja e shpërblyerit për punonjësit sipas kërkesave të Ligjit Nr 7582 datë 13.07.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore" dhe akte të tjera ligjore.
4. Përpunon bilancin përmbledhës të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, bashkëpunon me organet e specializuara për kryerjen e aktit ekspertizës për miratimin e tij, dorëzon bilancin e vitit ushtrimor me të gjithë tregësitë e tjera të pasqyruara në pasqyrat financiare në organet e përcaktuara me akte ligjore.
5. Ndjek nepermjet sektorëve përkatës realizimet e detyrave të programuara, programon masa konkrete për përmirësimin e gjendjes.
6. Organizon punën brenda drejtorisë, harton planin e punës dhe raportet përkatëse, kontrollon zbatimin e tij dhe organizon analizat e punës, muajore dhe vjetore.
7. Përgatit projekt ligje, vendime e urdhërzime për përmirësimin e aktëve ligjore e nenligjore në fushën ekonomiko-financiare.
8. Ben vlerësimet e punës muajore dhe vjetore për punonjësit që ka brenda drejtorisë si dhe i propozon Drejtorit të Përgjithshëm masa administrative të parashikuara në Kodin e Punës.
9. Bashkërendon punën me Drejtorin e tjerë të DPShTRR, Drejtorin Rajonal për hartimin e tregësive ekonomiko-financiare, je në mënyrë të vecantë për realizimin me efektivitet të investimeve

te miratuar.

10. Përcaktim madhësish kryesore të investimeve, kërkon përgatitjen e dokumentacionit ligjor për procedurat e tenderit dhe sigurim tëjet monetare për likuidimin e tyre.
11. Organizim punës për mirëadministrimin dhe mirëmbajtjen e bazës materiale dhe pajisjeve që ka në përdorim Drejtoria.

7.2 Sektori i Finances

Është pjesë e strukturës së Drejtorisë Ekonomike dhe varë nga Drejtoria e saj.

7.2.1 Përgjegjësi Sektori Financiar

Kryen funksionin e tij në zbatim të akteve ligjore dhe nenligjore si dhe detyrat e përcaktuara në këtë rregullorë.

1. Organizim dhe drejtim veprimtarive të Sektorit të Finances në zbatim të akteve ligjore dhe nenligjore. Përgatit informacione dhe jep mendime për të ndryshuar aktet ligjore dhe nenligjore dhe ia dërgon ato Drejtorisë Ekonomike.
2. Mban evidencën kontabël që kjo të pasqyrojë drejt dhe saktë të gjitha ndryshimet që vërehen në Bilancin Ekonomik të Drejtorisë së Përgjithshme.
3. Bën kontroll të rregullt të të gjitha dokumentave që kanë të bëjnë me pagesat në arke dhe në bankë duke u bërë barrë e veprimeve të kundërligjshme.
4. Kryen inventarizime të befasishme dhe ato të programuara që lidhen me rezultatit ushtrimit.
5. Përgatit Bilancin e aparatit të Drejtorisë së Përgjithshme.
6. Nxjerr të dhënat për shpenzimet të përshira në klasën gjasthe në total dhe sipas zerave.
7. Nxjerr të dhënat për të ardhurat e përshira në klasën shate në total dhe sipas aktivitetit.
8. Propozon masa administrative të parashikuara në Kodin e punës për punonjësit që ka në varësi ose që bëjnë shërbime administrative.
9. Kryen hedhjen e të gjithë artikujve kontabël që përfshihen nga dy specialistët e finances në ditarin klasik dhe në librin e madh.

10. Përfshihen të gjithë artikujt e ndryshëm të tjerë që kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomike të Drejtorisë së Përgjithshme dhe që janë të domosdoshëm për mbijlën e vllit ushtrimit sipas planit kontabël.

11. Kontrollon administrimin e aktivitetit të DPSHTR dhe Drejtorisë rajonale si agjent tatimor.
12. Në bashkërendim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve përgatit dhe u dërgon Drejtorisë Rajonale, sipas rrethave që mbulojnë, planin e vjeljes së taksave (takses së regjistrimit, të tonazhit për aks, të lejes së drejtimit dhe të kalimit të së drejtës së pronësive). Kordinon punën me Drejtorinë e Tatimeve dhe Pushtetin Vendor për Taksat.

7.3 Sektori i Programimit dhe Investimeve

Sektorin e programimit është pjesë përbërëse e Drejtorisë Ekonomike dhe ka për detyrë:

1. Hartimin e programeve ekonomike
2. Regjistrimin dhe përpunimin e tëqesve të ndryshëm statistikore
3. Studimin e Tarifave të shërbimeve për të gjithë llojet e shërbimeve
4. Programimin, Hartimin e dokumentacionit të nevojshëm për investimet ndërtimore dhe Ndjekjen e realizimit të këtyre investimeve.
5. Studimin dhe përcaktimin e nivelit të pagave të punonjësve.

7.3.1 Përgjegjësi sektori

Funksionin e tij kryen në zbatim të akteve ligjore dhe nenligjore dhe detyrat e përcaktuara në këtë rregullorë.

1. Organizim dhe drejtim veprimtarive të sektorit. Përgatit informacione materiale dhe projekte për ndryshime të akteve ligjore dhe nenligjore dhe ia dërgon Drejtorisë Ekonomike.
2. Përcaktim, drejtim dhe udhëheq metodologjive e planifikimit ekonomik – financiar vjetor, afatmesëm dhe afatgjatë të DPSHTR.
3. Përgatit formularet e programeve ekonomiko - financiare dhe udhëzohet plotësimin e tyre nga Drejtoria Rajonale.

4. Përgatit programin vjetor ekonomik - financiar dhe e paraqet për miratim.
5. Merr pjesë në përgatitjen e programeve atdhetare dhe atdhetare të zhvillimit të aktivitetit të DPShTRr.
6. Përgatit planin biznesin dhe e paraqet atë brenda afatit të caktuar pranë Degës së Talm Taksave.
7. Bazuar në të dhënat për të dhënat të bilanceve të Drejtorisë Rajonale përkatëse marzhin, e shprehur në përcentazh, si elementin bazë për kategorizimin e drejtorive për efektin e pagave.
8. Ben analiza dhe studime për rritjen e pagave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për ta bërë atë sa më fleksibel dhe sa më konkret për çdo vend pune. Përgatit tebelet e pagave dhe i paraqet ato për miratim.
9. Përpilon listat emërore të punonjësve, për ndryshimet që mund të behen në drejtoritë rajonale, si rezultat i përmirësimit të strukturas, organikës dhe pagave të punonjësve.
10. Ben analiza ekonomike analitike për çdo sektor të shërbimit dhe propozon argumenta për domosdoshmërinë e rritjes e tarifës aty ku rezultati është në nivelin e rentabilitetit të planifikuar, të cilin e dërgon për miratim organave kompetente.
11. Ndjek dhe udhëzon, në përputhje me legjislacionin në fuqi, vijën e takses së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve, të tonazhit për aks, të pajisjes me leje drejtimi dhe të kalimit të së drejtës së pronësisë.
12. Bazuar në nevojat e paraqitura nga Drejtoret e Sektoreve të DPShTRr si dhe Drejtoritë Rajonale për investime (ndërtim, inventar ekonomik, makineri e pajisje informatike) dhe propozon për miratim programin e investimeve.
13. Merr informacione mbi ecimin e realizimit të investimeve të çdo lloji natyre dhe në çdo kohë jep informacion për madhësinë e fondit të zhvillimit.
14. Propozon masa administrative sipas Kodit të Punës për punonjësit që ka në vartësi dhe organizon punën për mënmbajtjen dhe administrimin korrekt të materialeve dhe pajisjeve që ka në përdorim.

Mëni 8 DREJTORIA E KONTROLLIT TEKNIK

Drejtorja e Kontrollit Teknik është pjesë perberëse e drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe mbulon aktivitetin e kontrollit teknik dhe të të gjitha vlerësimeve teknike që u bëhen mjeteve rrugore me motor dhe mjeteve rrugore që tërhiqen nga mjete rrugore me motor, mbi bazën e kërkesave të ligjit nr. 8378 datë 22.07.1998, "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë" dhe të gjitha aktëve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

8.1 Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Teknik

Kryen funksionin e tij në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore si dhe detyrat e percaktuara në këtë rregullore.

1. Organizon, drejton dhe kontrollon punën për kontrollin teknik të mjeteve të vlerësimit teknik.
2. Propozon kriteret e përgjithshme të kryerjes së procedurave të kontrollit teknik vjetor dhe periodik të kontrollit fizik të mjeteve dhe procedurave të tjera që lidhen me to, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe merr masat përkatëse për zgjidhjen e problemeve të karakterit teknik që dalin në OKT.
3. Merr pjesë aktive në takimet pune të ndryshme me përfaqësues të institucioneve shtetërore për çështje që lidhen me objektin e veprimtarisë dhe kompetencat e Drejtorisë Teknike.
4. Në bashkëpunim me sektorin, zyrat dhe specialistët, harton programet vjetore, planin e masave tekniko-organizative dhe programe të tjera të veganta, dhe ndjek zbatimin e tyre.
5. Organizon analizat vjetore e mujore me punonjësit e organeve të linjës së drejtorisë si dhe organizon aktive e seminare të ndryshme me qëllim përmirësimin e metodave të organizimit të drejtimit dhe shkëmbimin e eksperiencës së përparuar.
6. Bashkërendon punën me drejtoritë e tjera brenda aparatit të D.P.Sh.T.Rr -se dhe në Ministrin për çështje e probleme të karakterit të përbashkët e koordinativ.
7. Ndjek problemet në lidhje me kualifikimin e specialistëve të drejtorisë e të sektorit, si dhe organizon e realizon testimin e tyre teknik profesional.
8. Përgatit, projekt urdhera, projekt udhëzime për përmirësimin e

- aktive ligjore e nenligjore, njoftime e informacione për analizat e ndryshme sipas materialeve që përgatitin specialistët e drejtorisë dhe të dhenave të drejtorive të tjera, në përputhje me detyrat që mbulon drejtoria.
9. Merr pjesë në studimet në shkallë drejtorie e ministrie dhe bashkëpunon me dikasterin dhe institucionet e tjera për hartimin e aktive ligjore dhe nenligjore.
10. Kontrollon punën për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në ambientet e QKT dhe shmangien e aksidentave në punë dhe kur konstaton shkelje merr masa deri në pezullim të shkaktarëve.
11. Raporton tek Drejtori i Përgjithshëm për realizimin e detyrave të vena dhe problemet që dalin, duke dhënë propozimet përkatëse për zgjidhjen e tyre dhe i propozon atij masa administrative, të parashikuara nga Kodi i Punës për punonjësit në varësi të tij.
12. Organizon punën për mirëmbajtjen dhe mirëmbajtjen e bazës materiale dhe pajisjeve që ka në përdorim Drejtoria.

Neni 9

Drejtoria e Lejeve të Drejtimit

Drejtorja e Lejeve të Drejtimit është pjesë përbërëse e DPShTRR dhe ka si detyrë pajisjen e detyruesve të mjeteve me leje drejtimi, licensimi e kontrolli mbi autoshtetësit në zbatim të ligjit 8378 "Kodi i Rrugës" i Republikës së Shqipërisë si dhe akte ligjore e nenligjore në zbatim të tij.

9.1 Drejtori i Drejtorisë së Lejeve të Drejtimit.

Kryen funksionin e tij në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore si dhe detyrat e parashikuara në këtë rregullore.

1. Organizon, drejton dhe kontrollon aktivitetin e linjes në Drejtorinë Rajonale, në përputhje me aktet normative në fuqi.
2. Ndihmon dhe kontrollon zbatimin e ligjshmërisë në tushen e funksionimit të autoshtetësive, të monitorimit të kualifikimit të drejtuesve të mjeteve rrugore për pajisjen e tyre me leje drejtimi.
3. Përgatit projekt-ligje, vendime, urdhëra dhe udhëzime si dhe studime dhe përgjithësimet për përmirësimin e gjendjes në tushen

- e linjes që drejton.
4. Studion gjendjen konkrete të ecurisë së punës dhe i propozon Drejtorit të Përgjithshëm për masat konkrete që duhen marrë.
5. Përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm për aktivitetin e veprimtarisë e Drejtorisë që mbulon.
6. Merr pjesë në grupe pune studimi dhe kontrolli të ngutur nga Drejtoria e Përgjithshme për probleme të ndryshme.
7. Harton skemën e procedurave për marrjen në testim të kandidatëve të leshimit të lejeve të drejtimit dhe merr masa për sistemin e arshivave të drejtuesve të mjeteve rrugore.
8. Koordinon veprimtarinë me Ministrinë e Transporteve dhe Telekomunikacionit si dhe me institucionet e tjera të shtetit për sektorin që drejton.
9. Thihet eksperiencën e përparuar botërore në tushen e përgatitjes dhe të marrjes në provim të kandidatëve për drejtues mjete dhe organizon punën për ta zbatuar në praktikë.
10. Organizon punën për mirëmbajtjen e nivelit shkencor dhe teknik-profesional të specialistëve dhe të personelit që ka në varësi.
11. Thërret në raport deri në 3 (tre) shëfja seksionesh të Drejtorisë Rajonale të linjes që drejton.
12. I propozon emeritësës përkatëse, në zbatim të Kodit të Punës masa disiplinore, për specialistët e punonjësit e linjes që drejton.
13. Organizon mirëmbajtjen dhe mirëmbajtjen e bazës materiale dhe pajisjeve që ka në përdorim drejtoria.

Neni 10

Drejtorja Regjistrimit të Mjeteve

Drejtorja e Regjistrimit të Mjeteve është pjesë përbërëse e DPShTRR. Detyra e saj është shërbimi ndaj subjekteve për regjistrimin e mjeteve, për ndërrimin e pronësive së tyre, pajisjen me targa në zbatim të Ligjit 8378 datë 22.07.1998, "Kodi i Rrugës" i Republikës së Shqipërisë si dhe aktet ligjore e nenligjore në zbatim të tij.

10.1 Drejtori i Drejtorisë së Regjistrimit të Mjeteve

Kryen funksionin e tij në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore si dhe detyrat e parashikuara në këtë rregullore.

1. Organizon, drejton dhe kontrollon punën për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore si dhe urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm për regjistrimin e mjeteve.
2. Përgatit projekt urdhëra, projektudhëzime për përmirësimin e akteve të regjistrimit të mjeteve dhe realizimin e procedurave për zbatimin e tyre.
3. Organizon kontrole temaike dhe probleme më për zbatimin e procedurave ligjore të regjistrimit të mjeteve.
4. Organizon takime dhe bën përgjithësim me personelin që merret me regjistrimin e mjeteve me synim kualifikimin dhe zbatimin e ligjshmërisë në këtë proces.
5. Propozon Drejtorit të Përgjithshëm masa administrative të parashikuara nga Kodi i Punës për punonjësit që punojnë në regjistrimin e mjeteve të cilët nuk zbatojnë procedurat ligjore dhe bëjnë thyerje të disiplinës në punë.
6. Informon dhe raporton përpara Drejtorit të Përgjithshëm për problemet që dalin dhe masat që duhen marrë për mbartëvajtjen e regjistrimit të mjeteve.
7. Organizon punën brenda Drejtorisë së Regjistrimit të Mjeteve, harton planin e punës mujore, kontrollon zbatimin e tij dhe organon analizat javore, mujore dhe vjetore.
8. Bën vlerësimet e punës mujore, vjetore për punonjësit që ka brenda drejtorisë.
9. Bashkërendon punën me drejtoritë e tjera brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor por edhe me drejtoritë e institucioneve të tjera që kanë detyrime ligjore në fushën e regjistrimit të mjeteve.
10. Bën shpërndarjen e korespondencës ditorë dhe siguron përgjigjet që bëhen nga specialistët sipas detyrave që kanë.
11. Organizon punën për mirëmbajtjen dhe mirëmbajtjen e bazës materiale dhe pajisjeve që ka në përdorim si Drejtori.

Neni 11

Sektori i Personelit dhe Shërbimeve

Sektori i Personelit dhe Shërbimeve është pjesë përbërëse e DPShT.Rr dhe ka si detyrë zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në marrëdhëniet e punës si dhe organizimin e shërbimit të brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

11.1 Përgjegjësi i Sektorit të Personelit dhe Shërbimeve.

Kryen funksionin e tij në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore si dhe detyrat e parashikuara në këtë rregullore.

1. Mban dosiet personale të punonjësve si dhe kujdeset që me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm, periodikisht të bëhet pasurimi i tyre.
2. Mban dhe kryen veprimet periodike në Regjistrin Themelitar të punonjësve Shqyrtor, analizon dhe ndjek kriteret e pranimit të specialistëve në aparatit D.P.Sh.T.Rr në përputhje me kërkesat organike të vendit të punës, llojin e specialitetit, eksperiencën dhe vjetërsinë në punë, nivelin e arsimit në përputhje me kriteret ligjore dhe nënligjore mbi punësimin.
3. Ndjek programet dhe evidencat nevojat për përgatitjen dhe kualifikimin e specialistëve brenda dhe jashtë vendit.
4. Merr të dhëna për vijueshmërinë dhe ecurinë e personelit që është në varësi të institucionit. Përpilon periodikisht (çdo pesëmbëdhjetë ditë) raportin përmbledhës që pasqyron paraqitjen në punë të punonjësve.
5. Përcakton për seçilin punonjës pagan sipas vendimit të Keshillit drejtues, klasën, vjetërsinë në punë, masën e shpërbimit për funksion apo vështirësinë në punë.
6. Evidencat dhe ju jep zgjidhje problemeve të ndryshme administrative.
7. Organizon dhe bashkërendon punën për paraqitjen e rregulloreve se brendeshme të institucionit.
8. Harton planin vjetor të lejeve të zakonshme dhe e zbaton pasi e miratohet titullari.
9. Ndjek problemet që kanë të bëjnë me të drejtat e punonjësve në fushën e marrëdhënieve të punës.
10. Përpilon dhe ndjek zbatimin e rregullave të përgjithshme të veprimtarisë në institucion për zbatimin e disiplinës në punë.
11. Lidh kontratat individuale dhe kolektive të punës me personelin në varësi të D.P.Sh.T.Rr.
12. Propozon masa administrative për punonjësit që bëjnë shkelje administrative dhe mirëmbajtjen e mirëmbajtjen e bazës materiale a pajisjet që ka në përdorim.

13. Propozon keshillit drejtues ndryshime ne Strukturat dhe organikat e punonjeseve

Neni 12 Drejtoria e Informacionit

Eshte pjese perberese e D.P.S.H.T.P.R dhe ka per detyre marjen e te dhenave dhe informatizimin e arkivit kombetar te mjeteve, regjistrin kombetar te drejtuesve te mjeteve si dhe administrimin dhe mirenjehjen e te gjitha njezimit informativ dhe te paisjeve qe e perbejne ate.

12.1 Drejtori Drejtorise Informatcionit

Kryen funksionin e tij ne perputhje me aktet ligjore nenligjore si dhe zbaton detyrat e parashikuara, ne kete rregullore dhe ato qe merr nga titullari. Pergatit projekt urdhëra, udhëzime e tjera qe kane te bejne me arkin dhe regjistrin kombetar si per gjendjen teknike te gjitha njezimit ne D.P.S.H.T.P.R dhe gjitha Drejtorite Rajonale. Me miratim te titullarit mban kontakte me organet qe kryejne sherbimet e policise rrugore, shporet dhe sigurimitet, qe kane lidhje me te dhenat, atetet e grumbullimit te informacionit.

12.2 Arkivi kombetar i mjeteve

Grumbullon te gjitha te dhenat ne lidhje me karakteristikat konstruktive dhe identifikuese me dhenien e lejaveqarkullimit dhe certifikates se pronese, me te gjitha proceset e mevonshme teknike juridike te mjetit, me aksidentet ku ka marre pjese mjeti. Ne arkiv duhet te shenohen gjithashtu, ngjyra origjinale e mjetit dhe cdo ndryshim i mevonshem i saj. Arkivi eshte plotesisht i informatizuar. Ai furnizohet dhe azhomohet me te dhenat ne perputhje te plote me kodin rrugor. Informon organet e parashikuara ne aktet ligjore me miratim te drejtorit te pergjithshem.

12.3 Regjistrin kombetar i drejtuesve te mjeteve

Merr dhe jep te dhenat me miratim te drejtorit te pergjithshem ne lidhje me proceduren e leshimit te lejeveqarkullimit si dhe te gjitha procedurat e mevonshme, si ato te rinovimit, kontrollit, pezullimit dhe heqjes

- se saj
shkeljet e kryera gjate drejtimit te nje mjeti te caktuar,
aksidentet qe jane verifikuar gjate qarkullimit dhe masat e marra.

Regjistrin kombetar duhet te informatizohet dhe te azhomohet ne dinamike.

12.4 Sektori Informatikes

Kujdeset dhe mirenjehjen te gjitha sistemin informatik ne D.P.S.H.T.P.R dhe ne te gjitha Drejtorite Rajonale. Eshte pjese perberese e Drejtorise Informatcionit. Raporton ne dinamike tek Drejtorin e Drejtorise per gjendjen teknike te njezimit informativ, shkaljen e amortizimit dhe problemet qe lidhen me funksionimin normal te tyre.

Neni 13 Drejtoria e Kontrollit Rrugor

Drejtoria e Kontrollit rrugor eshte pjese perberese e DPShTRR dhe ka si detyre kontrollin ne rruge per mjetet dhe Drejtuesit e tyre per kerkesat e Ligjit 8378 date 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", Ligjit 8308 date 18.03.1998 "Per Transportin Rrugor" dhe aktet ligjore dhe nenligjore ne zbatim te tyre.

13.1 Drejtorin e Drejtorise se Kontrollit Rrugor

Kryen funksionin e tij ne zbatim te aktet ligjore dhe nenligjore si dhe detyrat e percaktuara ne kete rregullore.

1. Drejtorin dhe organizon sherbimin e kontrollit rrugor ne shkalje drejtorie dhe merr masa per forcimin e disiplinës se zbatimit te ligjshmerise nga ana e subjekteve qe operojne ne fushen e transportit rrugor.
2. Pergatit projekt ligje, vendime, udhëzime e urdhëra per permesimin e aktet ligjore dhe nenligjore, njohime e informacione per punen e drejtorise.
3. Ushtron kontrollin ndaj kontrolloreve ne rruge, mbi zbatimin e ligjshmerise dhe per gjendjen e konstatuar informon Drejtorin e Pergjithshem te DPShTRR-se.
4. Verifikon zbatimin e ligjshmerise nga organet e kontrollit rrugor si dhe bazen juridike te perplimit te dokumenteve (gjohet,

- proces-verbalet) dhe u jep përgjigje ankesave të mundshme të subjekteve që i nënshtrohen kontrollit.
- Organizon punën për kontrollin e aktivitetit të shërbimit të kontrollit rrugor si dhe kontrollin e dokumentacionit të mjeteve të transportit rrugor në sektorin e kontrollit në zonë dhe drejtorinë rajonale që përbejnë objektin e veprimtarisë së Kontrollit Rrugor.
 - Bashkërendon punën me instancat e Policisë së Kontrollit Rrugor si dhe me institucionet e pushtetit vendor, për zbatimin e akteve ligjore dhe nenligjore në transportin rrugor.
 - Organizon analizat vjetore dhe mujore me punonjësit e Sektorit, haron programet e punës vjetore, planet e masave për zbatimin e tyre dhe plane të tjera të vecanta për seminarë dhe kurse.
 - Propozon masa administrative sipas Kodit të Punes për punonjësit që bëjnë shkelje administrative dhe miteadministrativon e mitemban bazën materiale e pajisjet që ka në ngarkim.

Neni 14

Sektori i Marrëdhënieve me Publikun

Sektori i Marrëdhënieve me Publikun është pjesë përbërëse e DPShTRR dhe ka për detyrë:

- Të njohë publikun e gjerë dhe vecanërisht subjektet shtetërore dhe private me veprimtarinë e DP SH T RR të përcaktuar në ligjin nr 8378 datë 22.07.1998, Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, VK M nr 343 datë 21.07.1999 për themelimin e DP SH T RR dhe Udhëzime të Ministrisë Transportit për Shërbimin në Transportin Rrugor, Statusin e Institucionit dhe Urdhërat e Udhëzimet që dalin herë pas here nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm dhe të sensibilizojë opinionin në zbatim të këtyre akteve.
- Të tërheq nga publiku vërejtjet, sugjerimet dhe mendimet për veprimtarinë e DP SH T RR në qendër dhe rajone dhe i raporton Drejtorit të Përgjithshëm.
- Propagandon veprimtarinë e DP SH T RR dhe Drejtorisë Rajonale në mediat vizive dhe të shkruar, përgjatë për të bërë herë pas here materiale propaganduese në dobi të tërheqjes të klientëve dhe përmirësimit të shërbimit ndaj tyre në zbatim të Kodit Rrugor.

14.1 Përgjegjësi i Sektorit

Funksionin e tij e kryen në zbatim të akteve ligjore dhe nenligjore dhe detyrave që përcaktohen në këtë rregullorë.

- Organizon, drejton dhe kontrollon punën brenda sektorit në zbatim të akteve ligjore dhe nenligjore dhe urdherave të DPShTRR.
- Haron programet e punës të sektorit dhe i miraton ato tek Drejtori i Përgjithshëm.
- Mban lidhje të vazhdueshme me organet e medias dhe sektorin e Marrëdhënieve me Publikun në Ministrinë e Transportit dhe institucione të tjera që kanë të marrëdhënie pune me DP SH T RR.
- Haron projekt vendime dhe projekt urdhëra për Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe ja jep për miratim Drejtorit të Përgjithshëm.
- Jep mendimin e tij për specialistet e sektorit dhe propozon masa disiplinore për punën e tyre në zbatim të Kodit të Punes dhe organizon punën për miteadministrativin dhe mitembajtjen e bazës materiale e pajisjeve që ka në përdorim Sektori.
- Raporton të Drejtorit i Përgjithshëm për zbatimin e detyrave dhe informon atë herë pas here për detyrat që dalin.
- Kryen trajnime me specialistet dhe Drejtorët e Drejtorisë Rajonale për sektorin e Marrëdhënieve me Publikun.
- Haron dhe paraqit në organet përkatëse botime të karakterit publik.

Neni 15

Sektori i Kontrollit Financiar

Sektori i Kontrollit Financiar është pjesë perberese e DPShTRr dhe ka për detyrë organizimin e kontrollëve të plotë, kontrollit me tërësi, kontrollëve të pjesëshëm dhe kontrollëve linear për zbatimin e aktëve ligjore dhe nenligjore të veprimtarisë së DPShTRr dhe Drejtorisë Rajonale. Në ushtrimin e kontrollit zbatohen kërkesat e VKM nr.217 datë 05.05.2000 "Për kontrollin financiar" si dhe metodikat përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Transporteve e Telekomunikacionit.

15.1 Përgjegjësi i Sektorit

Kryen funksionin e tij në zbatim të aktëve ligjore dhe nenligjore dhe detyrave të përcaktuara në këtë rregulltor.

1. Organizon, drejton dhe kontrollon punën për kryerjen e kontrollit revizionit ekonomik-financiar në Drejtorinë Rajonale të Sherbimit të Transportit Rrugor.
2. Harton programet vjetore të kontrollit revizionit ekonomik-financiar duke zbatuar afatet kohore për periudhën midis dy kontrollëve dhe e miraton ato tek Drejtori i Përgjithshëm.
3. Harton planet mujore të kontrollit dhe i miraton ato tek Drejtori i Përgjithshëm dhe organizon punën për zbatimin e tij.
4. Drejton punën për përmbushjen e të gjithë kërkesave ligjore gjatë kryerjes së kontrollit, zbaton afatet ligjore për dhenien e konkluzioneve dhe paraqet i në kohë titullarit propozimet për masa administrative, cëmtime e gjopa.
5. Bashkërendon punën me Drejtorinë e Sektorit të tjerë të DPShTRr për të ngritur grupe të përbashkëta kontrolli me synim që të bëhet një kontroll me i plotë e që mbulon të gjithë veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale, i paraqet keto grupe pune bashkë me programin përkatës tek DPShTRr.

Neni 16

Sektori Juridik dhe i Prokurimeve

Sektori Juridik dhe i Prokurimeve është në përberje të DPShTRr dhe ka si objekt të saj:

- Ndjek zbatimin e ligjshmërisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi që rregullon aktivitetin e institucionit.
- Drejton procedurat ligjore për prokurimin publik, në përputhje me nevojat e institucionit dhe kuadrin ligjor në fuqi.
- Ndjek, pagatit dhe përfaqëson në organet gjyqësore cështjet që lidhen me veprimtarinë e institucionit, duke bashkërenduar me drejtorinë dhe sektorët përkatës brenda aparatit të DPShTRr.
- Bashkërendon dhe ndihmon strukturat e tjera brenda aparatit të DPShTRr për pagatitjen e aktëve normative, sqaruesve, udhëzimeve, si dhe përgjigjet për bazueshmërinë e aktëve shkruese të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm.
- Drejton punën për njohjen e kuadrin ligjor me punonjësit e DPShTRr dhe Drejtorisë Rajonale, dhe testimin e këtyre njohurive.
- Harton dhe pagatit nga pikpamja juridike projekt-kontratat dhe marrëveshjet që lidh DPShTRr me subjekte të tjera, për cështje që lidhen me kryerjen e aktivitetit, duke bashkërenduar me strukturat e tjera brenda aparatit të DPShTRr.

16.1 Përgjegjësi i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve

Funksionin e tij e kryen në zbatim të aktëve ligjore dhe nenligjore si dhe detyrave të përcaktuara në këtë rregulltor.

1. Administron veprimtarinë e sektorit dhe ben shpërndarjen e detyrave dhe përgjegjësi në përputhje me funksionin organik të specialisteve që ka në vartësi.
2. Përplion informacionet përkatëse drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm mbi sigurinë e punës, programet mujore, vlerësimin e punës për çdo specialist të vartësisë.
3. Sigilon të gjitha aktet e nxjerra nga institucioni në zbatim të kuadrin ligjor në fuqi.
4. Bashkërendon me Sektorin e Personelit, pagatitjen e kontratave të punës, si dhe angazhohet në cështje të karakterit juridik mbi marrëdhëniet e punës.
5. Ndjek sigurinë e përfaqësimit të institucionit në procedurat gjyqësore dhe mban përgjegjësi për mbarevajtjen e këtyre procedurave.

6. Ndjek marrëdhëniet zyrtare si dhe korespondencën përkatëse midis DPShTRR dhe organit të Prokurorisë, me qëllim evidentimin e veprimave të kundraligjshme.
7. Angazhohet në përputhje me kompetencat përkatëse në veprimtari të përbashkëta me institucione të tjera, për çështje që lidhen me objektin e veprimtarisë.
8. Propozon masa administrative sipas Kodit të Punes për punonjësit që bëjnë shkelje administrative dhe miredministron punonjësit e bazen materiale e pajisjet që ka në ngarkim.

Neni 17

Te ndryshme për funksionimin e aparatit të DPShTRR.

E gjithë veprimtaria e aparatit të DPShTRR mbështetet në aktet ligjore dhe nenligjore si dhe në detyrat që përcaktohen në këto rregullore. Orari i punës dhe puna tej kohës normale dhe në ditët e pushimit, hyrjet dhe daljet në institucion të punonjësve e personave të jashtëm, orari i prfjes, levizjet e punonjësve jashtë institucionit, dërgimi i tyre me sherbim, levizja e automjeteve dhe organizimi i sherbimit për ruajtjen e institucionit, rregullohen me urdher të Drejtorit të Përgjithshëm të DPShTRR – së.

Neni 18

Drejtoria Rajonale të Sherbimit të Transportit Rrugor

Funksionet e tyre kryhen në zbatim të aktave ligjore dhe nenligjore, urdherave dhe udhëzimeve të Drejtorit të Përgjithshëm të DPShTRR dhe Rregullores së Brendshme që hartohet dhe miratohet për çdo Drejtori Rajonale nga Këshilli Drejtues.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Shpëtim CAMI

Tirane më 19.09.2003



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit

DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT RRUGOR
KESHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 16, datë 23.03.2004

Për

Miratimi e Rregulloreve së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme

Bazuar në Statutin e DPShTRR nën 9 pikat f, si dhe në propozimin e bërë nga Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme për hartimin e Rregulloreve së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme, Këshilli Drejtues në mbledhjen e tij të datës 23.03.2004,

Vendos:

1. Te miratohet Rregullorën e brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme.
 2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme, Sektori i Personelit dhe Sherbimet e kësaj, për zbatimin e kësaj vendimi.
- Ky vendim hyj në fuqi menjëherë.

SHPËTIM CAMI

KRYETARI I KESHILLIT DREJTUES

RREGULLORE e Drejtorisë së Regjistrimit

Neni 1

Qëllimi dhe detyrat

Drejtorja e Regjistrimit të Mjeteve është pjesë përbërëse e DPSh TR-së. Detyra e saj është kontrolli për zbatimin e ligjshmërisë në shërbimin ndaj subjekteve për regjistrimin e mjeteve rrugore, për ndryshimin e pronësisë mbi to, pajisjen me targa etj, në zbatim të ligjit 8378, datë 22.07.1998, (Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë) si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tij.

Neni 2

Drejtori i Drejtorisë së Regjistrimit të Mjeteve.

Kryen detyrat e miratuara në Rregulloren Brendëshme të DPSh TR-së, miratuar me shkresën e Ministrit të Transporteve dhe Telekomunikacioneve me Nr. 4463, datë 24.09.2003.

Neni 3

Specialist që mbulon regjistrimin për herë të parë të mjeteve rrugore.

1. Kërkon dhe mban përgjegjësi për zbatimin e legjislacionit, udhëzimeve dhe rregulloreve mbi regjistrimin e mjeteve për herë të parë.
2. Kërkon zbatimin e procedurave nga specialistët e sektorit të regjistrimit të mjeteve në Drejtorinë Rajonale.
3. Informon Drejtorin e Drejtorisë për problemet që dalin dhe propozon masa konkrete për përmirësimin e punës në këtë sektor.
4. Njihet me eksperiencat bashkëkohore për regjistrimin e mjeteve dhe propozon përmirësimet që duhen bërë në dokumentacionin dhe punën e sektorit të regjistrimit.
5. Propozon dhe përfaqëson materialet për trajnim të punonjësve të

këtij sektor.

Neni 4

Specialisti mbi procedurat për ndryshimet që kryhen mbi mjete dhe pronarët e tij.

1. Kërkon dhe mban përgjegjësi për zbatimin e legjislacionit, udhëzimeve dhe rregulloreve mbi procedurat për ndryshimet që kryhen mbi mjete dhe pronarët e tij.
2. Kërkon zbatimin e procedurave nga specialistët e sektorit të regjistrimit të mjeteve në Drejtorinë Rajonale.
3. Informon Drejtorin e Drejtorisë për problemet që dalin dhe propozon masa konkrete për përmirësimin e punës në këtë sektor.
4. Propozon dhe përfaqëson materialet për trajnim të punonjësve të këtij sektor.
5. Mbledh dhe përpunon informacionet që vijnë nga Drejtorinë Rajonale dhe informon Drejtorin e Drejtorisë.

Neni 5

Specialisti mbi konfirmimet doganore dhe korespondencat me institucionet e tjera.

1. Kërkon dhe mban përgjegjësi për zbatimin e legjislacionit, udhëzimeve dhe rregulloreve mbi.
2. Zbaton afatet kohore për kthimin e përgjigjeve për organet dhe institucionet e ndryshme.
3. Merr informacione të vazhdueshme nga Drejtorinë Rajonale për rastet e konstatimit të dokumentave të falsifikuara dhe mjeteve të vjedhura.
4. Përfaqëson informacionet për Drejtorin e Përgjithshëm, përfaqësit të dhëna për informacione të ndryshme që mund të kërkojnë nga institucione të tjera.

Neni 6

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Drejtues

RREGULLORE

e

Drejtorise se Lejeve te Drejtimit

Neni 1

Drejtori i Drejtorisë së Lejeve të Drejtimit

Kryen detyrat e përcaktuara sipas Rregullores së Brendshme të DPShTR-së, të miratuar me shkresë nr. 4463, datë 24. 09. 2003, nga Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit.

Neni 2

Specialisti i Autoshtollave

1. Ndihmon dhe kontrollon organet e bazës, për organizimin dhe funksionimin e autoshtollave duke ndërrë kur shkelen normat në këtë drejtim.
2. Kontrollon zbatimin e kriterëve të liqensimit të autoshtollave në Drejtorinë Rajonale sipas akteve në fuqi.
3. Verifikon në autoshtollat e liqensuara, kushtet, ambientet, pajisjet didaktike, realizimin e programeve teoriko - praktike, përshtatshmërinë e personelit mësimdhënës si dhe çdo gjëje që lidhet me këtë qëshije.
4. Ushtron kontrolle në tërësi, për të parë veprimtarinë praktike të stërvitjes së kandidatëve të autorizuar nga ana e instruktorëve.
5. Ushtron sondazhe për të verifikuar kandidatët e autorizuar.
6. Në bashkëpunim me Sektorin përkatës të Ministrisë së Shëndetësisë, ndjek ecurinë e komisionit mjekësor, për verifikimin e aftësive fizike dhe psikike të kandidatëve që kërkojnë të pajisen me leje drejtimi.
7. Mban evidencën e autoshtollave të liqensuara në shkallë Republike të detajuara sipas Drejtorive Rajonale dhe rrethëve.
8. Gjatë ndihmës dhe kontrollit në Drejtorinë Rajonale, gëzon kompetencat e specialistëve, të përcaktuara në nenin 3 dhe 4.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUQOR

KESHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 44. DATE 23.03.2004

Për

Miratimi i Rregullores së Brendshme të Drejtimit në Lejeve të Drejtimit

Bazuar në Statutin e DPShTRR nëni 3 pika f, si dhe në propozimin e bërë nga Drejtori i Drejtorisë së Lejeve të Drejtimit për hartimin e Rregullores së veprimtarisë, së Drejtorisë së Lejeve të Drejtimit, Keshilli Drejtues në mbledhjen e II) të datës 23.03.2004.

Vendosi:

1. Te miratqë, Rregulloren e brendshme të Drejtorisë së Lejeve të Drejtimit.
2. Ngarkohen Drejtorja e Lejeve të Drejtimit, Sektori i Personelit dhe Shërbimeve këtu, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim bryn në fuqi menjëherë.

SHPETIM CAMI

KRYETAR I KESHILLIT DREJTUES

Neni 3

Specialistët i monitorimit të procedurave të marrjes në provim të kandidatëve dhe të kryerjes së shërbimit ndaj qytetarëve, për pajisje me leje drejtimi

1. Ndihmon dhe kontrollon në mënyrë periodike komisionet e marrjes në prova në Drejtorinë Rajonale, për zbatimin e procedurave të marrjes në provim.
2. Kontrollon vlerësimin e kandidatëve që janë nënshtruar testimit nga ana e komisionit dhe ndërhyn kur konstaton se janë shkelur normat në fuqi.
3. Kontrollon zbatimin e atave kohore të kandidatëve që janë marrë në provim, në varësi të kategorisë së lejeve të drejtimit, në përputhje me normat e vendosura.
4. Kontrollon zbatimin e procedurave për lëshimin e lejeve të drejtimit të Certifikatave të Atësisë ose Formimit Profesional si dhe atë kohore të vendosura për kryerjen e shërbimeve ndaj qytetarëve, në Sektorin e Lejeve të Drejtimit në Drejtorinë Rajonale.
5. Kontrollon plotësimin, administrimin dhe sisteminin e dokumenteve të Sektorit të Lejeve të Drejtimit në Drejtorinë Rajonale, në përputhje me aktet normative në fuqi.
6. Ndihmon dhe kontrollon sisteminin dhe administrimin e dokumenteve të personave të atësuar për drejtues automjesh në Arkivat e Drejtorive Rajonale, e koordinon punën me Sektorin përkatës të Drejtorisë së Informacionit për kompjuterizimin e informacionit.
7. Mban, studjon dhe analizon të dhënat statistikore të Sektorit të Lejeve të Drejtimit, ndërhyn dhe merr masa për përmirësimin e gjendjes.
8. Administron dhe kontrollon zbatimin e grafikimit të marrjes në prova të kandidatëve të Drejtorive Rajonale.
9. Gjatë ndihmës dhe kontrollit në Drejtorinë Rajonale, gëzon kompetencat e specialistëve, të përcaktuara në nenet 2 dhe 4.

Neni 4

Specialistët i trajnimit të specializuar në transportin rrugor dhe i harimit të testeve

1. Përgatit programet dhe planifikon seminare, për trajnimin e specializuar të transportuesve që kërkojnë të pajisen me "Dëshmi të Atësisë ose Formimit Profesional" të parashikuar nga legjislacioni rrugor dhe akteve në zbatim të tij.
2. Merr masa për organizimin e seminareve në Qendërën e Trajnimit në Durrës, duke aktivizuar specialistë të kësaj fushe nga DPShTR-ja dhe institucione të tjera.
3. Harton në vijueshmëri testet, për kandidatët që kërkojnë të pajisen me leje drejtimi të të gjitha kategorive si dhe aplikantëve për "Dëshminë e Atësisë ose Formimit Profesional".
4. Shpërndan me regjim të repte testet, duke ruajtur sigurinë e tëshërtësirë e tyre, dhe matricat (çelësat e zgjidhjes) në Drejtorinë Rajonale, në përputhje me Urdhrat dhe Udhëzimet e Drejtorisë së Përgjithshme.
5. Kontrollon administrimin dhe përdorimin e testeve dhe të matricave të dërguara në Drejtorinë Rajonale sipas normave të vendosura nga Drejtoria e Përgjithshme.
6. Merr masa për zbatimin e procedurave të prodhimit të testeve në shpeshkronjën e DPShTR-së.
7. Gjatë ndihmës dhe kontrollit në Drejtorinë Rajonale, gëzon kompetencat e specialistëve të përcaktuara në nenet 2 dhe 3.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Keshilli Drejtues

RREGULLORE E DREJTORISE SE KONTROLLIT TEKNIK

Neni 1
Hyje

Drejtoria e Kontrollit Teknik është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që mbulon aktivitetin e kontrollit teknik dhe të gjitha vlerësimeve teknike që u bëhen mjeteve rrugore me motor dhe mjeteve rrugore, që tërhiqen nga mjetele rrugore me motor, mbi bazën e kërkesave të Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" dhe të gjitha aktve të tjera nenligjore, në zbatim të tij.

Neni 2

Drejtoria e Kontrollit Teknik përbëhet:

- 1- Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Teknik.
- 2- Specialist
- 3- Specialist për problemet administrative dhe shkencore.
- 4- Specialist për Q.K.T dhe homologimin
- 5- Specialist i procedurave të vlerësimit teknik të mjeteve dhe monitorimit të ndodhjeve të mjedisit.

Neni 3

Drejtori i Drejtorisë të Kontrollit Teknik kryen detyrat e tij në përputhje me përcaktimet në pikën 8.1 të nenit 8 të Rregullores të D.P.S.H.T.R.

Neni 4

Detyrat e specialisteve të Drejtorisë Teknike

4.1 Specialisti

Kontrollon aktivitetin e Qendrave të Kontrollit Teknik në drejtoritë rajonale gjatë procesit të kontrolleve të planifikuar që kryhen



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUJOR
KESHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 274, DATE 07.04.2004

Për

Miratimi i Rregullores së Shërbimeve të Drejtorisë së Kontrollit Teknik

Bazuar në Statutin e D.P.S.H.T.R. nën 9 pikat 1, si dhe në propozimin e bërë nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Teknik për hartimin e Rregullores së veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Teknik, Keshilli Drejtues në mbledhjen e tij të datës 07.04.2004,

Vendos:

1. Të miratohet Rregullori i brendshëm të Drejtorisë së Kontrollit Teknik.
2. Ngarkohen Drejtorja e Kontrollit Teknik, Sektori i Personelit dhe Shërbimeve këtu, për zbatimin e kësaj vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SHPEJTIM CAMI

KRYETARI I KESHILLIT DREJTUES

nga D.P.Sh.T.Rr-ja, në lidhje me:

- Zbatimin e akteve ligjore dhe nenligjore që administrojnë aktivitetin e kontrollit teknik (detyrimet që rrihetin nga Ligji nr.8378 date 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" si dhe V.K.M.-se, nr.153 date 07.04.2000, "Shqipërisë" për Zbatimin e Kodit Rrugor) kërkesat normative të Rregulloreve për Zbatimin e Kodit Rrugor nga Ministria e Transportit si manualat teknike të miratuara nga Drejtoria Përgjithshme dhe shkresave dhe porositë të dhëna nga Drejtoria Përgjithshme në përfundim të procesit të kontrollit teknik vjetor e periodik.
- Zbatimin e rregulloreve për përbushjen e kërkesave të vecanta në zbatim të nenëve 9, 32, 36 të Ligjit nr.8308 date 13.03.1998 "Për Transportin Rrugor" dhe udhëzimet përkatëse për mjetet që kërkojnë të liqensohen për transport mallrash e udhëtarësh brenda e jashtë vendit si dhe për automjetet e autoskollave.
- Koordinon punën me Sektorin e Invenstivimeve, pranë Drejtorisë Ekonomike si dhe ndjek në vazhdimësi ecurinë e investimeve që realizohen në QKT-të e Drejtorive Rajonale, në drejtim të detyrës e projektimit dhe në projektet në mbështetje të saj.
- Përpilon raportet përkatëse dhe ja paraqet, së bashku me problemet e konstatuara, Drejtoria të Drejtorisë së Kontrollit Teknik.
- Përgatit, në bashkërendim me punonjësit e tjerë të Drejtorisë së Kontrollit Teknik, programet vjetore të punës, programet mujore si dhe të gjitha planat e masave tekniko-organizative për zhvillimin e aktivitetit të kontrollit teknik të mjeteve rruge, dhe ja paraqet ato për miratim Drejtoria të Drejtorisë së Kontrollit Teknik.
- Përgatit në grup, të gjitha materialet e nevojshme, ndjek dhe drejton trajnimin tekniko-profesional të kontroloreve të Q.K.T.-ve, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.8378, date 22.07.1998 si dhe të Udhëzimit të Ministrisë të Transportit dhe Telekomunikacionit, Nr.746, date 28.12.1999.
- Zvendëson Drejtorin e Drejtorisë së Kontrollit Teknik, në çdo rast mungese të detyruar të tij, duke marrë gjithashtu pjesë në të gjitha mbledhjet, takimet apo përfaqësimet e ndryshme brenda ose jashtë Drejtorisë së Përgjithshme.
- Studion mundësitë, në bashkëpunim me punonjësit e tjerë të drejtorisë për kompletimin e QKT-ve me inventarin e nevojshëm

te pajisjeve të testimit teknik si dhe studion mundësitë e investimeve për QKT-të.

4.2 Specialist administrativ dhe shkencor

- Administron me anë të ndjekjes së vazhdueshme problematiken që rezultojnë nga korespondencat zyrtare të brendshme dhe të jashtme, përgatit përgjigjet dhe dërgesat përkatëse të tyre në destinacion.
 - Merr me studimin e dukurive të ndryshme që rezultojnë nga aplikimi i metodave të programuara, përgatit dhe organizon në grup, programet për kualifikimin e punonjësve të Q.K.T.-ve si dhe testimin e tyre në përputhje me ligjet dhe udhëzimet në fuqi.
 - Harton dhe përpilon testet teorike për provimin e kualifikuesve të specialistëve të Q.K.T.-ve, në zbatim të kërkesave të parashikuara nga aktet ligjore dhe nenligjore, duke pasqyruar në të përgjigje për njohurit e fituara në seminarin teorisë-praktike në lidhje me normat teknike të përfshira në Manualin "Kushte të Kontrollit Teknik" si dhe në "Rregulloren e Kërkesave të Përbërësve të KPP".
 - Mban lidhje me Drejtoria përkatëse të Ministrisë së Transporteve në lidhje me studimet e mundshme që do të organizohen në fushën e kontrollit teknik.
 - Organizon dhe ndjek ecurinë e aktivitetit të Q.K.T.-ve, nëpërmjet evidencimit të drejtpërdrejtë dhe me anë të evidencave dhe përgatit materialet për analizat e ndryshme në këtë sektor.
- #### 4.3 Specialist për aktivitetin të Q.K.T.-ve dhe homologimin
- Organizon dhe kontrollon pajisjen e punonjësve të QKT-ve me mjetet e nevojshme të kontrollit teknik të mjeteve sipas kërkesave të parashikuara në aktet ligjore dhe nenligjore dhe i raporton për këtë Drejtoria të Drejtorisë Teknike.
 - Organizon dhe kontrollon mirëmbajtjen dhe shpërzgjedhjen e aparatave të kontrollit teknik të mjeteve rruge duke mbajtur për këtë qëllim një ditar të plotë, si dhe njëjër përgjegjësit e nevojshme në rast se konstaton neglizhencë apo anomalitë duke përcaktuar edhe personat përgjegjës.

Organizon me Kryekontrollore të Q.K.T.-ve seminare në lidhje me njohjen e akteve ligjore dhe nenligjore që lidhen me sigurimin teknik në procesin e punës si dhe harton rregulloren e sigurimit teknik të cilën ja paraqet për miratim Drejtorit të Drejtorisë.

Ndjek në vazhdimësi plotësimin e kushteve të punës në procesin e kontrollit teknik të mjeteve në Q.K.T.-të e drejtorive rajonale si dhe kontrollon zbatimin e rregullores së sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë të punonjësve dhe propozon, kur e shihet e arsyeshme, paisjen e tyre me materialet e parashikuara me ligj.

Koordinon me drejtoritë rajonale dhe ndjek procedurat e homologimit dhe të ristampimit të numrit të identitetit të mjeteve në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8378, datë 22.07.1998, "Kodi i Rrugës" të Republikës së Shqipërisë, duke bashkëpunuar me Drejtorinë e Regjistrimit.

Ndjek, nëpërmjet kontrollit, procedurat e ndryshimeve konstruktive të aplikuar nga drejtoritë rajonale dhe i raporton Drejtorit të Drejtorisë Teknike, problemet që konstaton..

4.4 -Specialist për ndjekjen e procedurave të vlerësimit teknik të mjeteve dhe monitorimin e ndodhjeve të mjedisit.

Kontrollon aktivitetin dhe dokumentacionin e subjekteve që kërkojnë të liqensohen në fushën e transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve brenda dhe jashtë vendit, duke mbajtur kontakt të vazhdueshëm me Q.K.T.-të e Drejtorive Rajonale.

Organizon dhe kontrollon punën e komisioneve perkatese të vlerësimit teknik në përputhje me kërkesat e Udhëzimeve të Ministrisë së Transportit nr.142 datë 20.01.1998 dhe nr.1649 datë 16.08.1999, si dhe i raporton Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit Teknik mbi problemet që konstaton..

Mban në kontroll të vazhdueshëm gjendjen, përdorimin dhe mirëmbajtjen e aparaturave të kontrollit dhe të testimit të gazrave që çlirohen nga djegia e karburantëve në motorat e automjeteve, në përputhje me Ligjin nr.103, datë 31.03.2002 "Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë". Përpilon raportin përmirësues të rezultateve dhe kur kërkohet, ja paraqet Drejtorit të Drejtorisë.

Detyra të përgjithshme të specialistëve të Drejtorisë

Neni 5

Bejne plane mujore te punes ne zberthim te programit vjetor te Drejtorise, me afate te percaktuara dhe te miratuara nga Drejtori i Drejtorise.

Per kontrollin tematik dhe periodike te ushtruar ne OKT-te e drejtorive rajonale duhet te kene parasysh:

- Pas kontrollit te ushtruar, te lene detyra me shkrim per korrigjimin e mangesive te verejtura.
- Te perpiqejne informacionin me gjithë detyrat e lëna dhe t'ia paraqesin Drejtorit të Drejtorisë.
- Periodikisht te kontrollojne zbatimin e detyrave te lëna.
- Nga problematikat pas rikontrollit te japin mendime per zgjidhjen e tyre me masa konkret.
- Mbajne pergjegjesi per mosevidentimin e te metave te verejtura ndermjet dy kontroleve per te njejtin problem.

Neni 6

Kjo rregullore hyn ne fuqi pas miratimit nga Keshilli Drejtues

NENI 3: Drejtori i Drejtorisë

Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit rrugor kryen detyrat e tij në përputhje me parimet e pikës 13.1 të nenit 13, të Rregullores së Brendshme të DPSHTRR-se.

NENI 4: Specialist për kontrollin rrugor

- a - Kontrollon aktivitetin e shërbimit të kontrollit rrugor në sektorin rajonalë si dhe mbajtjen e dokumentacionit që pasqyron veprimtarinë e kontrollit në linjë.
- b - Organizon seminare dhe teste, kurse kualifikimi për inspektorët e kontrollit në rrugë dhe mërr pjesë në testimin e njohurive të tyre.
- c - Organizon kontrole periodike në sektorin e kontrollit rrugor, për të parë zbatimin e ligjshmërisë dhe disiplinës në punë.
- d - Administron grafiket e shërbimeve të kontroloreve në sektorin e kontrollit dhe ndjek zbatimin e tyre.
- e - Organizon kontrole direkte në rrugë, në bashkëpunim edhe me efektivin e shërbimit të sektoreve të kontrollit - me objekt zbatimin e ligjshmërisë.
- f - Verifikon ligjshmërinë e hartimit të proces verbalëve të hartuara nga inspektorët e kontrollit rrugor.

NENI 5 Specialist për statistiken

- a - Ndjek rezultatet mujore të arritura nga sektorët, përillon të dhënat statistikore mujore dhe vjetore dhe ben studimet dhe përgjithësimet mbi bazën e rezultateve të arritura,
- b - Ndjek realizimet ditore dhe javore të sektoreve dhe informon për rezultatet e arritura eporet,
- c - Ndjek dhe rakordon me drejtorinë ekonomike dhe sektorin e kontrollit rezultatet financiare mujore dhe vjetore të drejtorisë,
- d - Ndjek konsumin e karburantëve dhe shpenzimeve të tjera për ripartimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve.

- f - Mban dokumentacionin shkresor të drejtorisë dhe ndjek korespondencën e drejtorisë

NENI 6 Specialist i Komisioneve dhe Infrastruktura

- a - Ndjek veprimtarinë e komisioneve të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative dhe ndjek korespondencën me të deri në thellësi të shqyrtimit të çështjeve.
- b - Ndjek furnizimin e inspektorëve me infrastrukturën dhe bazën e nevojshme materiale.
- c - Ndjek rimiken e konsumit pranë drejtorive rajonale të proces verbalëve, biletave, fletë udhëtimeve dhe materialeve të tjera të nevojshme për qarkullim sipas ligjit të transportit dhe mërr masë se bashku me drejtorinë e prodhimit për plotësimin e nevojave të tyre.
